



RAPORT VJETOR

i Agjencisë Kosovare të Privatizimit

2019



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

RAPORT VJETOR

2019

I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT
PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PËRMBAJTJA

FJALA HYRËSE E KRYESUESIT TË BORDIT TË AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

1. PËRMBLEDHJE HYRËSE	7
2. KORNIZA LIGJORE.....	8
3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT.....	10
4. FUSHËVEPRIMI QË MBULON AGJENCIA.....	11
5. DEPARTAMENTI I SHITJES	13
6. NJËSIA E MONITORIMIT, KONTROLLËS DHE ADMINISTRIMIT DIREKT.....	14
7. DEPARTAMENTI I LIKUIDIMIT.....	17
8. DEPARTAMENTI I KOORDINIMIT RAJONAL.....	18
9. DEPARTAMENTI I LIGJOR	21
10. DEPARTAMENTI I MARKETINGUT, MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN DHE INVESTITORËT.....	22
11. DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE.....	23
12. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS.....	25
13. DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE BUXHETIT.....	25
14. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT.....	28
15. DEPARTAMENTI I NEGOCINIT DIREKT.....	29
16. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM.....	29
I. SHTOJCAT E RAPORTIT VJETOR TË AKP-së.....	31

FJALA HYRËSE E KRYESUESIT TË BORDIT TË AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Agjencia Kosovare e Privatizimit, si Agjenci e pavarur e themeluar nga Kuvendi i Kosovës, përbën një nga shtyllat themelore të strukturës ekonomike në vend. Mandati i saj është drejtpërdrejt i lidhur me ndërtimin e një ekonomie të lirë të tregut përmes transformimit të pronës shoqërore e cila duhet të fuqizoj sektorin privat, si bartës kryesor i zhvillimit ekonomik.

Agjencia gjatë vitit 2019 ka arritur që përmes rishikimit dhe plotësimit të infrastrukturës ligjore aty ku ka pas nevojë, si dhe masa të tjera të krijoj dhe implementoj strategji që kanë ndikuar në efikasitetin e procesit të transformimit të pronës shoqërore.

Angazhimi në përmbushjen e objektivave ka rezultuar në realizimin e planit të shitjes së aseteve në periudha mujore, shitjen me negociim direkt, shpërndarjen e mjeteve për kreditorët dhe shpërdarjen e 20% për punëtorët dhe vendosjen e ndërmarrjeve në likuidim. Agjencia poashtu gjatë këtij viti ka transferuar një shumë të konsiderueshme të mjeteve në buxhetin e Republikës së Kosovës sipas mandatit që ka.

Agjencia falënderon të gjitha institucionet në nivelin lokal dhe qendror për bashkëpunimin dhe mbështetjen e dhënë në përmbushjen e objektivave të përbashkëta dhe shpreson që ky bashkëpunim të vazhdojë dhe të rritet edhe më shumë në të ardhmen. Poshtu e falënderojmë Dhomën e Posaqme të Gjykatës Supreme për bashkëpunim profesional që kemi pasur gjatë gjithë kësaj kohe. Vazhdimi i bashkëpunimit me këta akter është jetik në përmbylljen e mandatit të Agjencisë.

Raporti që po ju paraqesim paraqet rezultatet e punës për vitin 2019. Si Agjenci jemi të përkushtuar të vazhdojmë angazhimin maksimal në përmbushjen e objektivave për përmbylljen e sukseshme të mandatit të Agjencisë në një periudhë optimale.

Sinqerisht,

Bajram Zejnullahu

Kryesues i Bordit të Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



1. PËRMBLEDHJE HYRËSE

Në këtë raport është paraqitur një përmbledhje e punës së AKP-së për periudhën 1 janar 2019 deri më 31 dhjetor 2019. Ky raport është rezultat i punës dhe aktivitetetve nga Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti, Departamentet dhe njesitë tjera organizative të AKP.

Pavarësisht sfidave, parametrat statistikor dhe rezultatet e punës për vitin 2019, janë tregues i rritjes së performancës dhe dinamikës në realizimin e mandatit ligjor të AKP.

Duke u bazuar në punën profesionale të 245 punonjësve të saj, të strukturuar në 10 Departamente në Selinë Qendrore dhe 5 Zyra Rajonale e 1 Zyre satelitore (Shterpcë), AKP përgjatë vitit 2019 ishte e fokusuar në:

- Administrimi e Ndërmarrjeve Shoqërore dhe Shitjen e aseteve të tyre;
- Pagesat për punëtorët e Ndërmarrjeve Shoqërore (20%);
- Shpërndarja e mjeteve ndaj kreditorëve për Ndërmarrjet Shoqërore;
- Menaxhimin e procesit të qiradhënies të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional me Komunitat dhe institucionet qendrore;
- Aktivitetet operative dhe administrative të AKP-së;
- Transferimin e mjeteve tepriçë apo fondeve të përkoshme në buxhetin e Kosovës.

Krahasuar me vitin paraprak, AKP shënoj rritje prej 128% të të hyrave, të cilat vijnë nga shitja e aseteve, pagesat e shpronësimeve dhe realizimi i kontratave mbi të drejtën e pronësisë banesore. Totali i të hyrave nga shitjet për vitin 2019 janë 41.345,259 milion Euro.

Shpërndarja e pagesave prej 20 % për punëtorët e Ndërmarrjeve Shoqërore, shënoi rritje prej 2.18 % krahasuar me vitin parapak. Ndërkaq shpërndarja totale nga kategoria e shpërndarjeve të 20 % për punëtorët, për vitin 2019 ishte në vlerën prej 7,122,367 milion euro. Numri i personave përfitues për këto shpërndarje ishte 9,437 punëtor.

Pagesat për kreditorët shënuan rritje prej 67 %. E shprehur në vlerë, shuma e shpërndarjeve për kreditorët për vitin 2019 ishte 3,906,238 milion euro.

Menaxhimi me asetet në qiradhënie, mbetet në nivel të njëjtë, me një rritje simbolike prej 1.4 % apo shprehur në vlerë monetare, të hyrat nga qiratë për vitin 2019 ishin në shumën prej 5,462,436 milion euro.

Përgjatë gjithë vitit 2019, AKP poashtu ishte e fokusuar në rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional si një nga sfidat permanente për AKP-në. Koordinimi i vazhdueshëm me Qeverinë në raport me ndryshimet ligjore për Trepçen ishte çështje primare për AKP, e pasuar me koordinimin e vazhdueshëm mbi vendimet e shpronësimeve dhe përpjekjet për realizimin e pagesave të shpronësimeve në llogari të punëtorëve.

Rritja e bashkëpunimit me Komunitat, është kruciale për AKP. Në funksion të rritjes së këtij bashkëpunimi janë realizuar mbi 30 vizita pune dhe takime me Kryetar të Komunitave, përfshirë katër komunitat në veri të Kosovës. Pavarësisht komunikimit minimal që këto katër komuna kanë pasur me AKP-në në të kaluarën, gjatë vitit 2019, AKP ka arritur që të thellojë bashkëpunimin duke shtuar dukshëm komunikimin në mënyrë që të arrihen objektivat e saj.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme mbetet institucion i rëndësishëm tepër të veçantë për AKP. Votimi i ligjit për Dhomen e Posaçme në Kuvend, dhe funksionalizimi i saj pas një periudhe pothuaj dy vjeqare me funksion minimal, ishte lehtësim për AKP-në. Shkëmbimi i informatave administrative me Dhomen e Posaçme, mbi kërkesat kreditorë, i mundësoi AKP-së realizimin e shpërndarjeve të pjesëshme për kreditorët.

Aktivitetet operative dhe administrative të AKP, përmes të cilave edhe u mundësuan të arriturat e lartëshënuara mund të përblidhen si në vijim:

- 399 Vendime të Bordit të Drejtorëve, mbi 900 vendime menaxheriale e administrative;
- Realizimi i 11 valëve të Shitjes të Aseteve me Likuidim;
- Dorëzimi i 308 kontratave të shitjes;
- Fillimi i likuidimit për 20 NSh si dhe vendimi për likuidimin e 28 NSh tjera, për të cilat data e fillimit të likuidimit do të jetë 26 shkurt 2020;
- Përzgjedhja e kontraktorit të jashtëm për Likuidimin e Ndërmarrjeve (OSHP- Ofruesi i Shërbimeve Profesionale);
- Shpallja e 22 listave fillestare, dhe 23 listave përfundimtare për 20%-shin e punëtorëve për 64 Ndërmarrje Shoqërore;
- Përfaqësimet gjyqësore dhe veprime procedurale lidhur me lëndët gjyqësore gjithësejt 2108 ;

- Nënshkrimi i Memorandumit me Ministrinë e Administratës Publike për fillimin e renovimit të objektit për zyrat e AKP-së.

Sidoqoftë, përkundër angazhimeve maksimale të AKP-së për përsheptimin e procesit të transformimit të pronës shoqërore, janë një numër i konsiderueshëm faktorëve të jashtëm që paraqesin sfidë për procesin në tërësi. Këto sfida mbeten edhe për vitin pasues, dhe si të tilla mund të përmbliidhen si në vijim:

- Numri jashtëzakonisht i madh i kontesteve gjyqësore (mbi 22 mijë në Dhomen e Posaçme dhe rreth 3 mijë lëndë në gjykata themelore) dhe vonesat kohore deri në vendim final;
- Mungesa e pagesave për shpronësimet nga Vendimet e Qeverisë dhe për pasoj mungesa e shpërndarjes së 20% për punëtorët;
- Rënia e ofertës për blerje nga investitorët për asetet më pak atraktive;
- Ndërtimet joligjore në pronat shoqërore-dinamika e trajtimit të tyre, vonon procesin e likuidimit të NSH-ve;
- Mungesa e zgjidhjes finale ligjore për objektet e Ndërmarrjeve Shoqërore në shfrytëzim nga institucionet publike (qiradhënie ose shpronësim);
- Mungesa e azhurnimeve kadastrale në komuna.

2. KORNIZA LIGJORE

RREGULLORET DHE PROCEDURAT E BRENDSHME TË AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

1. Ligji i AKP-së nr. 04/L-034, ndryshuar me Ligjin nr. 05/L-080 të datës 24 dhjetor 2015;
2. Akti themelues i AKP-së;
3. Statuti i Bordit të Drejtorëve të AKP-së;
4. Politikat Operacionale të AKP-së dhe Anekset e saj:
 - 4.1. Rregullat e tenderit në privatizim;
 - 4.2. Rregullat e tenderit në likuidim;
 - 4.3. Rregullat e Procedurës të Komisionit për shqyrtim të ankesave ndaj listave të punëtorëve.
5. Procedurat Financiare të AKP-së;

6. Udhëzuesi i Likuidimit me Anekset e tij:

6.1. Lista me Format/Formularët për Likuidim;

6.2. Udhëzuesi për Shqyrtimin e Kërkesave të Caktuara të Punës (marrëdhënia e punës);

6.3. Udhëzuesi për Shqyrtimin e Kërkesave Pronësore (të NSH-së) gjatë periudhës së transformimit;

6.4. Aneks i Udhëzuesit të Likuidimit për Procedimin e Kërkesave Kolektive në procedurën e likuidimit.

7. Rregullorja për kompensimin e anëtarëve të Bordit;

8. Udhëzuesi për procedurën e shpërndarjes së të hyrave nga 20%;

9. Udhëzuesi mbi procedurat e prokurimit për përdorim nga Ndërmarrjet Shoqërore;

10. Udhëzuesi mbi procedurat e prokurimit për përdorim nga Ndërmarrjet Shoqërore në likuidim;

11. Procedurat e brendshme të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve;

12. Procedurat Bankare të AKP-së;

13. Rregullorja Nr. 01/2012 mbi Ruajtjen e Integritetit të AKP-së;

14. Rregullorja për përdorimin e vulave zyrtare të Agjencisë dhe Autorizimi për lejimin e përdorimit të vulave zyrtare të Agjencisë nga Autoriteti i Likuidimit;

15. Statuti Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB);

16. Rregullorja për përcaktimin e mënyrave të kompensimit për menaxherët si dhe punëtorët tjerë të NSH-ve nën mandatin e Njesisë së Administrimit Direkt;

17. Rregullorja për procedurën e rekrutimit të Drejtorit Menaxhues, dy Zëvendës Drejtorëve Menaxhues dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve;

18. Rregullorja për zhvillimin e punonjësve dhe ngritje të kapaciteteve;

19. Rregullorja për procedurat dhe masat e nevojshme për sigurinë e personave që hyjnë dhe dalin në AKP;

20. Rregullorja e brendshme e Agjencisë për Vlerësim të Performancës së Menaxhmentit;

21. Politikat mbi pagesën e pjesshme për punëtorët;

22. Udhëzuesi i prokurimit për ndërmarrjen Trepça nën Administrimin e AKP-së;
23. Rregullorja e Shitjes së Ndërmarrjes Trepça në Administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
24. Rregullorja e Pagave për nëpunësit e Agjencisë;
25. Rregullorja e Personelit për nëpunësit e Agjencisë;
26. Rregullorja e Përdorimit të Veturave zyrtare të Agjencisë;
27. Rregullat e Procedurës për Shitjen e Banesave të NSh-ve;
28. Rregullat e Punës të Komisionit për ndërtime jo ligjore në pronat e ndërmarrjeve shoqërore;
29. Rregullorja për qiradhënien e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore;
30. Rregullorja për qiradhënien e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim;
31. Rregullat e Procedurës së Komisionit për shqyrtimin e listave fillestare të punëtorëve (KShLFP);
32. Vendimi për lirimin e aseteve të uzurpuara të NSh-ve dhe Udhëzuesi për lirimin e aseteve nga uzurpatorët;
33. Rregullorja për Procedurat e Njesisë së Kontrollit dhe Mbikëqyrjes gjatë Monitorimit të Ndërmarrjeve të Privatizuara me Spin Off Special dhe me Kushte;
34. Rregullorja mbi Procedurat e trajtimit të llogarive të arkëtueshme;
35. Udhëzuesi për Menaxhimin e Performancës së Personelit;
36. Udhëzuesi për Teknologjinë Informative;
37. Statuti i Komitetit të Auditimit;
38. Rregullorja e punës së Njesisë së Administrimit Direkt;
39. Rregullorja e re e Qiradhënies së aseteve të NSh-ve;
40. Udhëzuesi për Lirimin e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpuesit e Paligjshëm;
41. Rregullorja për monitorim të Trepçës;
42. Procedurat e Shitjes dhe Rregullat e Përgjithshme të Tenderit;
43. Rregullorja e Sekretarisë Ekzekutive të Bordit;
44. Rregullorja për qasje në dokumente zyrtare dhe klasifikim të informacionit;
45. Udhëzuesi për zyrtarët e rastit lidhur me pagesat e faturave për tatimin në pronë nga data e fillimit të likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim;
46. Udhëzimi Administrativ për Inicimin dhe Pagesat nga Buxheti i AKP-së;
47. Rregullore për shqyrtimin e aseteve me karakter specifik dhe shitja e tyre me negociim të drejtpërdrejtë;
48. Rregullore për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjenci;
49. Ndryshimi/plotësimi i Aktit Themelues të AKP-së;
50. Udhëzuesi për Menaxhimin dhe Funksionimin e Linjës së Posaçme Telefonike;
51. Plotësim ndryshimi i procedurave të shitjes dhe rregullave të tenderit;
52. Strategjia për media;
53. Amadamentimi i Rregullave të Tenderit;
54. Plotësim/ndryshimi i paragrafit 10.2.2. të nenit 10 të Rregullores për Zhvillimin e Punonjësve dhe Ngritje të Kapaciteteve;
55. Plotësim/ndryshimi i Rregullave të procedurës së punës së Komisionit për Shqyrtimin e Listave fillestare të Punëtorëve (KShLFP);
56. Plotësim/ndryshimi i Rregullores për Pagat e nëpunësve në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
57. Udhëzuesi për procedurat e parcelizimit të parcelave kadastrale në pronësi të Ndërmarrjeve Shoqërore.

MIRATIMI I RREGULLOREVE DHE PROCEDURAVE TË BRENDSHME SI DHE AMANDAMENTIMET GJATË VITIT 2019

1. Amadamentimi i Rregullores mbi Ruajtjen e Integritetit të AKP-së - 30 janar 2019 (Informatë: me këtë rast është shfuqizuar Rregullorja e kaluar).
2. Amadamentimi i Rregullores për qiradhënien e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore - 30 janar 2019 (Informatë: me këtë rast është shfuqizuar Rregullorja e kaluar).

3. Amadamentimi i Rregullores së Pagave - 30 janar 2019 (Informatë: me këtë rast Ri-vendoset pozita Zyrtar i Lartë për Bujqësi me gradë dhe hap 4-13 në Rregulloren e Pagave të nëpunësve të AKP-së).
4. Amandamenti i Rregullores për Trajtimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore me karakter specifik dhe Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës - 30 janar 2019 (Informatë: me këtë rast është amadamentuar Organogrami i Agjencisë, ashtu që është themeluar Njësia e Negocimit Direkt, si njësi kompetente që i raporton drejtpërdrejtë Drejtorit Menaxhues. Janë shuar Komisioni për Shqyrtimin e Aseteve me karakter specifik dhe Komisioni për Negocim direkt).
5. Amadamentimi i Rregullores së Pagave - 15 shkurt 2019 (Informatë: me këtë rast plotësohen/ndryshohen tabelat 6.2 dhe 6.3 të Rregullores për Pagat e nëpunësve të AKP-së).
6. Amandamentimi i Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës - 15 shkurt 2019 (Informatë: me këtë rast Njësia e Shkresave Gjyqësore kalon nga Departamenti i Administratës tek Departamenti Ligjor dhe për punën e saj i raporton drejtpërsëdrejti Drejtorit të Departamentit Ligjor - amadamentohen të gjitha nenet përkatëse në Rregullore dhe amadamentohet Organogrami i Agjencisë, ashtu që kjo njësi kalon nga Departamenti i Administratës tek Departamenti Ligjor).
7. Amandamentimi i Rregullores për kompensimin e Drejtorëve të Bordit - 25 prill 2019.
8. Rregullorja për Investime në Letra me Vlerë dhe Depozita Kohore - 25 prill 2019.
9. Plotësim ndryshimi i Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës - miratuar a) Krijohet pozita Koordinator në DKR dhe b) Rivendoset pozitave: Kryesues i Transportit dhe Kryesues i Zyrës së Protokollit - 25 prill 2019.
10. Aprovimi i Statutit të Komitetit të Auditimit - 27 qershor 2019.
11. Amandamentim i Rregullores së Komisionit të Banesave - 27 qershor 2019.
12. Amandamentimi i Rregullave të Tenderit dhe Procedurave të shitjes - 27 qershor 2019.
13. Amadamentimi i Rregullores së Pagave - 31 korrik 2019.
14. Amadamentimi i Rregullores së Pagave - Kërkesa e Njesisë së Auditimit për rritje të pagave - (Drejtori hapin/gradën 2-4, auditorët hapin/gardën 3-6) - 02 shtator 2019.
15. Draft Udhëzuesi për përcaktimin e kriterëve lidhur me asetet specifike qiradhënie - 02 shtator 2019.

16. Udhëzuesi për Parandalimin dhe Zgjidhjen e Konfliktit të Interesit - 26 nëntor 2019.

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

MISIONI

Agjencia është e autorizuar për administrimin, duke përfshirë shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e ndërmarrjeve dhe aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Për realizimin e këtij misioni, Agjencia mban dhe administron secilën ndërmarrje dhe aset (nën mandatin e saj) në mirëbesim dhe në të mirë të pronarëve dhe kreditorëve të tyre, si dhe bënë shitjen e tyre, transferon ose likuidon ndërmarrjet dhe asetet në përputhje me ligjin.

VIZIONI

Agjencia është e vendosur që pa vonesa të bëjë transformimin e pronës shoqërore krejt kjo me qëllim të zbatimit të mandatit të saj i cili buron nga Kuvendi i Kosovës. Rrjedhimisht AKP është e vendosur për të trajtuar me shpejtësi ndikimet pozitive për ekonominë e Kosovës si dhe nxitjen e investimeve në Ndërmarrjet Shoqërore, përmes autorizimeve të gjera publike administrative që i ka mbi këto ndërmarrje dhe asete, duke përfshirë, por pa u kufizuar, mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose aseteve tek investitorët privatë, ose likuidimin e tyre përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues.

KOMPETENCAT E AGJENCISË SIPAS LIGJIT

Agjencia Kosovare e Privatizimit është organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht autonome. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me Ligjin nr. 04/L-034, si dhe të padisë e të paditet në emër të saj.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar nga Kuvendi i Kosovës në korrik të vitit 2008 si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) që është themeluar dhe rregulluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 "Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit", dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë asete dhe përgjegjësi të Agjencisë.

Agjencia Kosovare e Privatizimit i raporton Kuvendit të Kosovës në baza vjetore. Gjatë periudhës raportuese, aktivitetet e përgjithshme të Agjencisë janë menaxhuar nga Menaxhmenti i kesaj Agjencie.

Në kuadër të strukturës organizative të Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë edhe departamentet dhe njësitë e veçanta si në vijim:

- Departamenti i Shitjes;
- Departamenti i Likuidimit;
- Departamenti i Koordinimit Rajonal;
- Departamenti Ligjor;
- Departamenti i Marketingut, Marrëdhënieve me Publikun dhe Investitorët;
- Departamenti i Financave dhe Buxhetit;
- Departamenti i Burimeve Njerëzore;
- Departamenti i Administratës;
- Departamenti i Prokurimit;
- Departamenti i Komisioneve Profesionale; dhe
- Njësia e Negocimit Direkt;
- Njësia e Auditimit të Brendshëm; dhe
- Njësia e Monitorimit Kontrollës dhe Administrimi Direkt.

4. FUSHËVEPRIMI QË MBULON AGJENCIA

Agjencia Kosovare e Privatizimit aktualisht ka nën administrim gjithsejt 590 Ndërmarrje. Ato ndahen si në vijim:

- **516 janë gjithsej** Ndërmarrje Shoqërore, Trepçës* dhe Ndërmarrjeve të Reja prej;
- **74 janë gjithsej** asete/njësive punuese në Kosovë, ku selitë e NSh-ve janë jashtë Kosovës¹

* Pas miratimit të Statutit të Trepça SHA nga Kuvendi i Kosovës më 3 shkurt 2019, NSh Trepça vendoset në likuidim si 1 (një) subjekt juridik, ndërsa numri i njësive biznesore të Trepçës që kanë mbetur nën mandat të AKP-së është 9 (nëntë).

Këto 590 ndërmarrje kanë statusin e mëposhtëm:

Numri i Ndërmarrjeve aktualisht nën administrimin e Agjencisë	590
Vendosur në likuidim	532
Numri i NSh-ve në likuidim të përmbyllura me vendim të Dhomës së Posaçme	(32)
Ende në proces të likuidimit	500
Kosovatransat dhe Ekonomitë Pyjore që nuk do të vendosen në likuidim	34
Nuk janë vendosur ende në likuidim*	60

* Në dhjetor të vitit 2019 është marrë vendimi për fillimin e likuidimit edhe për 28 NSh/Asete tjera, për të cilat data e fillimit të likuidimit do të jetë 26 shkurt 2020, ndërsa për 8 NSh/Asete tjera është marrë vendimi për fillimin e likuidimit në janar 2020 për të cilat data e fillimit të likuidimit do të jetë 3 mars 2020. Mbeten të vendosen në likuidim edhe 11 NSh/Asete.

BORDI I DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë ekzekutiv i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve i AKP-së takohet në baza të rregullta mujore në mënyrë që t'i kryej¹ funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas Ligjit. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendorë duke përfshirë një anëtarë të komunitetit jo-shumicë dhe një përfaqësues nga sindikatat e punëtorëve të cilët janë emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Mandati i Bordit të Drejtorëve është katër vjeçar për të gjithë anëtarët e Bordit. Kuvendi me datë 07 mars 2019 ka emëruar Kryesuesin e Bordit dhe një anëtar tjetër të Bordit për të kompletuar përbërjen e plotë të Bordit. Gjatë vitit 2019, deri në fund të këtij viti, Bordi ka mbajtur 16 mbledhje, ku janë marrë gjithsejt 399 vendime formale dhe shumë udhëzime për veprim për Menaxhmentin. Në vijim, në mënyrë përmbledhëse janë të paraqitura aktivitetet e Bordit për këtë periudhë:

1. Janë aprovuar shitjet nga valë të shitjeve të aseteve në likuidim (SHAL43A - SHAL 53);
2. Janë aprovuar për shpallje valët e shitjes së aseteve (SHAL 45 - SHAL 53) për shitje përmes tenderit publik;
3. Janë bërë shpërndarjet e përkohshme për kreditorët e Ndërmarrjeve Shoqërore;
4. Është aprovuar fillimi i likuidimit për 48 ndërmarrje/asete;
5. Janë bërë shpërndarjet për ish-punëtorët e Ndërmarrjeve Shoqërore nga 20% i shitjeve;
6. Janë aprovuar raporte të Komisionit për Shitjen e Banesave në Pronësi Shoqërore;
7. Janë aprovuar raporte Rekomanduese dhe Përfundimtare të Njesisë për Negocim Direkt;
8. Janë aprovuar qiradhënie të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore;
9. Janë aprovuar raporte për përcaktimin e statusit të Ndërmarrjeve Shoqërore;

1 Përbërja, procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit të Drejtorëve janë të paraqitura në nenet 12, 13, 14 dhe 15 të Ligjit nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (të ndryshuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 04/L-115).

10. Janë aprovuar dhe/ose amandamentuar akte nënligjore të Agjencisë, si:
- 10.1. Amadamentimi i Rregullores mbi Ruajtjen e Integritetit të AKP-së - 30 janar 2019 (Informatë: me këtë rast është shfuqizuar Rregullorja e kaluar);
 - 10.2. Amadamentimi i Rregullores për qiradhënien e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore - 30 janar 2019 (Informatë: me këtë rast është shfuqizuar Rregullorja e kaluar);
 - 10.3. Amadamentimi i Rregullores së Pagave - 30 janar 2019 (Informatë: me këtë rast Rivendoset pozita Zyrtar i Lartë për Bujqësi me gradë dhe hap 4-13 në Rregulloren e Pagave të nëpunësve të AKP-së);
 - 10.4. Amandamenti i Rregullores për Trajtimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore me karakter specifik dhe Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës -- 30 janar 2019 (Informatë: me këtë rast është amadamentuar Organogrami i Agjencisë, ashtu që është themeluar Njësia e Negocimit Direkt, si njësi kompetente që i raporton drejtpërdrejtë Drejtorit Menaxhues. Janë shuar Komisioni për Shqyrtimin e Aseteve me karakter specifik dhe Komisioni për Negocim direkt;
 - 10.5. Amadamentimi i Rregullores së Pagave - 15 shkurt 2019 (Informatë: me këtë rast plotësohen/ndryshohen tabelat 6.2 dhe 6.3 të Rregullores për Pagat e nëpunësve të AKP-së);
 - 10.6. Amandamentimi i Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës - 15 shkurt 2019 (Informatë: me këtë rast Njësia e Shkresave Gjyqësore kalon nga Departamenti i Administratës tek Departamenti Ligjor dhe për punën e saj i raporton drejtpërsëdrejti Drejtorit të Departamentit Ligjor - amadamentohen të gjitha nenet përkatëse në Rregullore dhe amadamentohet Organogrami i Agjencisë, ashtu që kjo njësi kalon nga Departamenti i Administratës tek Departamenti Ligjor;
 - 10.7. Amandamentimi i Rregullores për kompensimin e Drejtorëve të Bordit - 25 prill 2019;
 - 10.8. Rregullorja për Investime në Letra me Vlerë dhe Depozita Kohore - 25 prill 2019;
 - 10.9. Plotësim ndryshimi i Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës - miratuar:
 - a) Krijohet pozita Koordinator në DKR; dhe
 - b) Rivendoset pozitave: Kryesues i Transportit dhe Kryesues i Zyrës së Protokollit - 25 prill 2019.
- 10.10. Aprovimi i Statutit të Komitetit të Auditimit - 27 qershor 2019;
 - 10.11. Amandamentim i Rregullores se Komisionit të Banesave - 27 qershor 2019;
 - 10.12. Amandamentimi i Rregullave të Tenderit dhe Procedurave të shitjes - 27 qershor 2019;
 - 10.13. Amadamentimi i Rregullores së Pagave - 31 korrik 2019;
 - 10.14. Amadamentimi i Rregullores së Pagave - Kërkesa e Njesisë së Auditimit për rritje të pagave -(Drejtori hapin/gradën 2-4, auditorët hapin/gardën 3-6) - 02 shtator 2019;
 - 10.15. Draft Udhëzuesi për përcaktimin e kriterëve lidhur me asetet specifike qiradhënie - 02 shtator 2019; dhe
 - 10.16. Udhëzuesi për Parandalimin dhe Zgjidhjen e Konfliktit të Interesit - 26 nëntor 2019.
 - 11. Është aprovuar Marrëveshja e Mirëkuptimit me Ministrinë e Administratës Publike për pagesën e shpronësimit të: Tokës dhe ndërtesës së NSH "Banka e Lubjanës dhe një pjesë të Objektivit të NSH "Metal Holding. Poashtu është aprovuar Marrëveshja e Mirëkuptimit për ndërtesën e NSH Gërmia dhe tokës së NSH Silloga (KHT Kosova)
 - 12. Është aprovuar plani i punës për vitin 2019 dhe buxheti për vitin 2020 si dhe raporte tjera që u përcillen institucioneve qendrore sipas ligjit në fuqi;
 - 13. Gjatë vitit 2019 janë transferuar në Fondin e Konsolidar të Republikës së Kosovës gjithsej 150,000,005.84€ euro (2,206,255.18 € fonde të mbetura dhe 147,793,750.66 € fonde të përkohshme);
 - 14. Bordi i Drejtorëve ka zgjatur mandatin e dy Zëvendës Drejtorëve Shitje dhe Likuidim për 4 vite duke filluar nga 01.06.2019, sipas Ligjit në fuqi;
 - 15. Është aprovuar kërkesa e Bordit Mbikëqyrës të Trepçës Sh.A., datë 21 mars 2019, nr. Protokolli 2302 për transferimin e të gjitha llogarive bankare nga "Trepça - Ndërmarrje në Administrim të AKP" tek Trepça Sh.A.
 - 16. Janë larguar nga kompetencat dhe autoriteti administrativ i AKP-së 17 ndërmarrjet/subjektet juridike të "Kosovatrans";
 - 17. Është aprovuar transferimi i pronës me detajet e pronës: Parcelave kadastrale: 7576-3, 7780-3, 7583-0, 7584-4, 7582-0; Zona Kadastrale: Prishtinë; Komuna: Prishtinë; nga "NSH Auto Prishtina" në emër të Federatës së Futbollit të Kosovës në përputhje me Vendimin Përfundimtar

për Shpronësim nr. 07/90, të datës 19 shkurt 2019;

5. DEPARTAMENTI I SHITJES

18. Janë aprovuar termat e referencës për angazhimin e përfaqësuesit ligjor për arbitrazh në kontestin në mes të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe IMING D.O.O për Ndërmarrjen e re MiM Golesh;

19. Është aprovuar lejimi/pëlqimi për zhvillimin e projekteve të Komunave Istog, Deçan, Vushtrri, sipas kërkesave të tyre me për zhvillimin e projekteve investive për interes të përgjithshëm, me zotimin e këtyre Komunave që në momentin e vlerësimit të pronave ata do të paguajnë vlerën e 20% për punëtorët e kualifikuar si dhe për kërkesat kreditore nga procesi i likuidimit deri në shumën e përgjithshme të vlerësimit sipas nenit 6/A të Ligjit të AKP-së.

Një ndër objektivat kryesore të AKP-së është transformimi i pronës shoqërore përmes privatizimit. AKP gjatë transformimit përpiqet të shtoj vlerën e asetëve përmes metodave të shitjes, duke synuar gjithmonë vlerën më të lartë të mundshme që e ofron tregu pas një procesi transparent dhe konkurrues.

Gjatë vitit 2019, vetëm nga Departamenti i i Shitjeve, u arrit që të dorëzohet numër rekord i kontratave të blerësit, gjithsej 222 kontrata të shitjes (204 kontrata përmes shitjeve me tender, 18 kontrata nga shitjet me negociim)

Ashtu siç edhe ishte planifikuar u arrit që gjatë vitit 2019 të mbahen gjithsej 11 valë të shitjeve të asetëve në likuidim.

Shitja përmes Tenderit Publik/ Negocim Direkt	Nr. i Aseteve	Nr. i Ofertave të Pranuara	Gjithsej vlera e Ofertave Fituese	Gjithsej Vlera	Kontratat e realizuara
Negocim Direkt	18	18	127,216	127,216	18
SHAL23	1	3	322,000	322,000	1
SHAL34	1	3	76,759	76,759	1
SHAL40	2	19	841,777	841,777	2
SHAL41	8	31	996,403	996,403	8
SHAL42	14	36	1,320,956	1,320,956	14
SHAL43	13	31	547,454	547,454	13
SHAL43A	32	4	65,350	65,350	3
SHAL44	93	157	7,535,397	5,716,074	23
SHAL45	94	43	10,567,135	8,857,605	22
SHAL46	113	99	5,048,057	2,138,331	26
SHAL47	119	108	2,785,409	750,078	18
SHAL48	113	40	970,382	791,356	16
SHAL49	131	121	8,073,467	5,216,143	20
SHAL50	131	140	5,430,870	2,390,856	35
SHAL51	125	79	3,126,433	6,507	2
SHAL52	135	114	5,865,659	0	0
SHAL53	120	119	4,864,330	0	0
Gjithsej 11	1,206	1,024	58,565,054	30,164,865	222

6. NJËSIA E MONITORIMIT, KONTROLLËS DHE ADMINISTRIMIT DIREKT

NJMKAD merret me administrimin e drejtpërdrejt të ndërmarrjeve të cilat kanë vështirësi financiare dhe biznesore prandaj me qëllim të rritjes së kontrollit dhe efikasitetit të këto ndërmarrje Bordi i Drejtorëve i AKP-së ka vendosur për futjen e këtyre ndërmarrjeve nën masat e Administrim Direkt. Njësia për Monitorim, kontroll dhe Administrim Direkt gjithashtu ka për detyrë që për ndërmarrjet që nuk janë liruar nga marrëveshja e zotimeve të monitorojë dhe raportoj për gjendjen në këto ndërmarrje.

Detyrë e kësaj Njësie ndër të tjera është që për Ndërmarrjet aktive të cilat nuk janë në likuidim, të kontrolloj raportet financiare të tyre të cilat pranohen përmes zyrave Regjionale.

SPIN OFF-ET SPECIALE

Gjatë vitit 2019 AKP ka monitoruar vetëm një Ndërmarrje të privatizuar përmes metodës spin off special. Kjo Ndërmarrje e mbetur nën monitorim është Agrokosova Holding në Suharekë. Ndërmarrje për përpunimin e verës, e përbërë nga mëse 1200 hektarë vreshta të rrushit. Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 25 prill 2019 ka marr vendimin me numër BD-17/19 sipas së cilit vendim aprohet zgjatja e marrëveshjes së zotimeve për periudhën nga 1 janar 2015 deri më 5 prill 2017 dhe aprohet kërkesa e Blerësit për auditim “për periudhën prej 01.01.2015 deri 05.04.2017, periudhë kjo e pa mbuluar për shkak të mungesës së Bordit të Drejtorëve. Bazuar në këtë AKP ka angazhuar kompaninë audituese “Audit Group” për të audituar përmbushjen e zotimeve për periudhën nga 01.01.2015 deri 05.04.2017. Sipas kompanisë audituese, Blerësi ka raportuar investime kapitale në vlerë prej 3,237,620.32 Euro. Sipas raportit të kompanisë audituese nga vlera prej 3,237,620.32 € vetëm vlera prej 2,411,753.24 € plotësojnë kriteret të trajtohen si investime kapitale kurse vetëm vlera

Përshkrimi	Zotimi	Vlera/numri	%
Përmbushja e zotimeve për investime kapitale	8,600,000.00	7,378,005.82	85.79%
Përmbushja e zotimeve për punësim	3075	759	24.67%

prej 332,292.82 € janë pagesa të identifikuar dhe që lidhen me faturat e raportuara si investime kapitale dhe përfshijnë 10.29 % të vlerës së raportuar të investimeve apo 3.87 % të investimeve të zotuar nga ana e Blerësve ($332,292.82 / 8,600,000.00 = 3.87\%$).

Bazuar në raportet e auditimit për të gjitha periudhat Blerësi dhe Ndërmarrja ka këtë nivel të përmbushjes:

ADMINISTRIMI DIREKT

Administrimi direkt nënkupton marrjen nën kontroll direkte të Ndërmarrjeve duke përfshirë llogaritë bankare dhe asetet. Administrimi direkt është instrument i kontrollit të drejtpërdrejt të Ndërmarrjeve me qëllim të ruajtjes dhe rritjes së vlerës si dhe rritjen shanseve për një privatizim të suksesshëm.

NSH “Sharrprodhimi” Dragash

Kjo Ndërmarrje Shoqërore është vendosur nën Administrim Direkt me datën 31/10/2019 me vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së numër BD 124-61 kurse nga Administrimi Direkt është larguar dhe është futur në likuidim më datën 23/12/2019, po ashtu me vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së numër BD 127/65. Në ndërmarrje kanë qenë të angazhuar tre punëtor dhe të hyrat janë realizuar kryesisht nga lëshuarja e disa aseteve me qira. Të hyrat mujore nga qiraja kanë qenë 700 Euro në muaj.

Ndërmarrja e Re “MIM Golesh” Magure

Duke pasur parasysh vështirësitë financiare të Ndërmarrjes Bordi i Drejtorëve i AKP-së në vitin 2019 ka marr vendim për shitjen e disa materialeve të mbetura në ndërmarrje me tender publik. Janë hapur dhe vlerësuar oferta dhe me ofertuesin fitues është lidhur kontrata. Bartja e materialeve pritet të bëhet në gjysmën e parë të vitit 2020.

Në muajin dhjetor 2019 në Ndërmarrjen e Re “MIM Golesh” kanë qenë të angazhuar 43 punëtorë ku numri më i madh i punëtorëve është i angazhuar në ruajtjen e aseteve duke konsideruar faktin se hapësira e Ndërmarrjes është shumë e madhe 267 ha, ndërsa punëtorët tjerë janë të angazhuar në menaxhim dhe mirëmbajtje të aseteve të cilat janë shumë të rëndësishme për Ndërmarrjen, si dhe në administratë, kontabilitet etj.

Bordi i Drejtorëve të AKP-së, në mbledhjen e mbajtur me 23 nëntor 2018, ka miratuar Termat e Referencës për projektin “Zhvillimi Afarist i Minierës së Goleshit”, si projekt i financuar nga GIZ, qëllimi i të cilit është që të zhvillohet plani afarist për Goleshin, si aset me potencial të konsiderueshëm për tërheqje të investimeve, krijim të vendeve të punës, dhe krijim të hyrave. Ky projekt është rezultat i bashkëpunimit të Agjencisë me institucionet Gjermane, dhe vazhde e projektit paraprak “Studimi i Parafizibilitetit për materiet minerare në Kosovë”. Gjatë vitit 2019 “GIZ” ka kryer studimin e fizibilitetit i cili ishte punuar nga dy kompani kredibile në fushën e industrisë së minierave. Ky studim i Fizibilitetit është paraqitur para investitorëve potencial në Londër në vitin 2019, dhe si

rezultat disa kompani serioze kanë shprehur interesim për minierën e Goleshit.

NSH “Boksitet e Kosovës” Klinë

Gjendja në ndërmarrje është mjaftë e vështirë dhe të hyrat e vetme të cilat i realizon Ndërmarrja janë dhënia e aseteve me qira. Aktualisht Ndërmarrja ka katër asete të dhëna me qira – Zyra në Klinë, parkingun po ashtu në Klinë, Fabrikën e Llaçit në Volljak dhe Seperacionin në Volljak.

Të hyrat mujore nga dhënia e aseteve me qira janë në vlerë prej 6,500.00 Euro, kurse në ndërmarrje janë të punësuar 17 punëtor.

NSH “Ereniku Industria” Gjakovë

Të hyrat e vetme të cilat i realizon Ndërmarrja janë dhënia e aseteve me qira. Aktualisht Ndërmarrja ka tri asete të dhëna me qira. Të hyrat mujore nga dhënia aseteve me qira janë në vlerë prej 1,260.00 euro.

Në ndërmarrje janë të punësuar 4 punëtor prej të cilëve dy paguhen prej subvencioneve dhe dy nga të ardhurat e ndërmarrjes. Gjithashtu në ndërmarrje janë të angazhuar edhe 6 punëtor si ofrues të shërbimeve të cilët merren me ruajtjen e aseteve të ndërmarrjes.

NSH “Virginia” Gjakovë

Ndërmarrja nuk e zhvillon aktivitetin e saj primar por të hyrat e vetme të cilat i realizon Ndërmarrja janë dhënia e aseteve me qira.

Aktualisht Ndërmarrja ka tetëmbëdhjetë (18) kontrata të qirasë dhe të hyrat mujore janë afër 2512 Euro. Në ndërmarrje janë të punësuar 22 punëtorë prej të cilëve tre janë në Bordin e Përkohshëm Menaxhues të Ndërmarrjes.

NSH “Jatex” Gjakovë

Ndërmarrje nuk realizon të hyra nga aktiviteti primar por të hyrat kryesisht i ka nga dhënia e objekteve me qira në Kosovë dhe jashtë saj. Janë të dhëna me qira 32 lokale dhe vlera mujore e inkasimit të hyrave nga qiraja sillet rreth 13,770.00 Euro.

NSH “Metaliku” Gjakovë

Gjendja në këtë ndërmarrje është mjaftë e vështirë dhe pjesa dërmuese e aseteve janë të dëmtuara dhe kryesisht kemi objektet të cilat janë pa makineri dhe jo funksionale.

Pasi që deri në futjen e ndërmarrjes në Administrim Direkt, Ndërmarrja nuk ka pasur asnjë të hyrë të realizuar nga qiraja apo ndonjë aktivitet tjetër, AKP me kërkesë të Bordit të Përkohshëm Menaxhues dhe me qëllim të rritjes së të hyrave të ndërmarrjes gjatë vitit 2019 ka lëshuar disa objekte me qira ku vlera mujore e qirave ka qenë afër 3,800.00 Euro. Në ndërmarrje janë të angazhuar 6 punëtor prej të cilëve dy janë në Bord të Përkohshëm Menaxhues dhe 4 në ruajtjen e objekteve të ndërmarrjes.

NSH “Fabrika e Enëve” Gjakovë

Ndërmarrja deri në futjen në Administrim Direkt nuk ka realizuar asnjë të hyrë dhe nuk ka pasur asnjë të punësuar.

Pas futjes së ndërmarrjes në Administrim Direkt së bashku me Bordin e Përkohshëm Menaxhues janë identifikuar asetet që mund të jepen me qira dhe është bërë shpallja publike ku vlera mujore e të hyrave nga qiratë ka qenë afër 540.00 Euro. Në ndërmarrje janë të punësuar tre ofrues të shërbimeve si roje dhe tre anëtar të Bordit Menaxhues.

NSH “Iliria” Pejë

Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 30/31 mars 2017 ka marrë Vendim për vendosjen e NSH “Iliria” në Administrim Direkt të AKP-së. Duke pasur parasysh se gjatë vitit 2018 kemi pranuar vendimin nga Gjykata Supreme e Kosovës sipas së cilit vendim i njihet e drejta e pronës një Blerësi të saj i cili ka bërë blerjen e ndërmarrjes gjatë viteve të 90-ta dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit ka bërë ankesë në këtë vendim andaj deri në marrjen e vendimit nga Gjykata AKP nuk ka mundësi të adiministroj me ato prona.

Ndërmarrja aktualisht nuk inkason asnjë të hyrë nga qiraja dhe nuk mund të shfrytëzon objektet e saj deri në ndonjë vendim tjetër nga ana e Gjykatës Supreme.

NDËSHKIMET FINANCIARE PËR NDËRMARRJET E PRIVATIZUARA ME SPIN OF SPECIAL DHE ATYRE ME KUSHTE

Lidhur me Ndëshkimet Financiare të Spin offave special si dhe Ndërmarrjeve të privatizuara me kushte, ndëshkime këto të bartura për spin off-at special nga viti 2010, Bordi i Drejtorëve ka vendosur që Departamenti ligjor të ndërmerr hapat ligjor për inkasimin e tyre. Më poshtë paraqesim tabelën e ndëshkimeve financiare.

Për Ndërmarrjen Famipa, AKP ka proceduar me Propozim për Përmbarim dhe si rezultat Përmbaruesi Privat ka nxjerrë Urdhër Përmbarimor në vlerë prej 1,170,00.00 euro, ndërsa debitori ka parashtuar prapësim në Gjykatë ndaj urdhërit përmbarimor. Lënda është në Gjykatë.

Për Ndërmarrjen e Re “XIM Strezoc” Kamenicë si dhe “MiM Golesh” Magurë, kemi proceduar me Propozim për Përmbarim dhe Përmbaruesi Privat ka nxjerrë Urdhër Përmbarimor. Blerësi nuk është ankuar dhe urdhëri është bërë i plotfuqishëm. Megjithatë, problem paraqet selia e kompanisë/blerësit e cila është në Kroaci dhe bazuar në Ligjin e Procedurës Përmbarimore ekzekutimet nuk kanë zbatim jashtë teritorrit të Republikës së Kosovës.

Për Ndërmarrjen e Re “Grand Hotel” sh.p.k, AKP ka proceduar me Propozim për Përmbarim i cili është aprovuar nga Përmbaruesi i Privat duke nxjerrë Urdhër Përmbarimor. Blerësi ka parashtuar prapësim dhe lënda është në Gjykatë.

Duhet theksuar se për Ndërmarrjen Sharrcem në Han të Elezit, Bordi i Drejtorëve në përputhje me Kontratën për Shitblerjen e aksioneve kishte marrë vendim që kjo kompani të paguaj vlerën prej €9,441,768.83, e cila ishte konstatuar nga Auditorët e jashtëm të pavarur si vlerë e pa përmbushur nga vlera e zotuar për investim sipas kontratës e që ishte 35 milion euro. Sipas kontratës çdo mos përmbushje do të konsiderohet çmim shtesë të cilin blerësi/kompania duhet ta paguaj.

Lidhur me këtë vendim të Bordit të AKP, kompania Gjermane Sharr Betailangung GmbH, nga Hamburg Gjermani, ka paditur AKP-në në Arbitrazh. Aktualisht është duke u zhvilluar procedura e arbitrazhit e cila do të elaborohet tek pjesa e raportit për Departamentin Ligjor.

Ndërmarrja	Vlera e ndeshkimeve
Ndërmarrja e Re "Famipa"	€1,170,000.00
Ndërmarrja e Re XIM Strezoc	€4,465,785.56
Ndërmarrja e Re “Sharrcem”	€9,441,768.83
Ndërmarrja e Re “MiM Golesh”	€5,231,326.27
Ndërmarrja e Re Grand Hotel sh.p.k	€ 5,233,648.54

7. DEPARTAMENTI I LIKUIDIMIT

NSh-të të cilat kanë asete sipas shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 - Ofruesin e Shërbimeve Profesionale.

LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE

Gjatë vitit 2019, kanë filluar procedurat e likuidimit dhe janë emëruar Autoritetet e Likuidimit për 20 Ndërmarrje Shoqërore gjegjësisht asete. Sipas procedurave të parapara me Ligj, janë bërë publikimet e njoftimeve për kreditorët dhe pronarët e ndërmarrjeve në dy gazeta në Republikën e Kosovës, një në Serbi dhe një në Mal të Zi. Brenda afatit të paraparë ligjor për parashtrimin e kërkesave për këto ndërmarrje deri më 31 dhjetor 2019 nuk janë pranuar kërkesa kreditore në Zyrat Rajonale përkatëse të AKP-së.

Në total, nga fillimi i tërë procesit deri në datën e raportimit janë gjithsej 531 Ndërmarrje Shoqërore për të cilat kanë filluar procedurat e likuidimit. Këto Ndërmarrje Shoqërore në likuidim janë administruar nga Autoritetet e Likuidimit (OSHP me AKP-në) për

Gjatë periudhës raportuese me Akvtendime të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës është aprovuar mbyllja e likuidimit për 15 Ndërmarrje Shoqërore, për të njëjtat sipas kërkesave ligjore janë bërë njoftimet për institucionet lidhur me mbylljen e procesit të likuidimit.

Në muajin qershor 2019 ndërmjet AKP-së dhe OSHP-së (Curtis, Mallet-Prevost, Colt&Mosle LLP, Grant Thornton Consulting Doo dhe Grant Thornton LLC) është nënshkruar kontrata për likuidimin e Ndërmarrjeve Shoqërore/aseteve nën administrimin e AKP-së, e njëjta ka filluar me datë 1 korrik 2019 me kohëzgjatje prej 5 vitesh dhe ate deri më 30 qershor 2024. Si rezultat i nënshkrimit të kontratës së lartpërmenduar janë emëruar Autoritetet e Likuidimit nga personeli i OSHP-së dhe AKP-së, për të gjitha NSh-të në likuidim dhe që janë nën kompetencën e OSHP-së.

PËRSHKRIMI	JANAR-DHJETOR	TËRË PROCESI (deri më 31 dhjetor 2019)
Numri i NSh-ve në likuidim	20	531
Numri i kërkesave të parashtruara të kreditorëve	0	91,341
Numri i kërkesave të shqyrtuara	0	91,100
Numri i NSh-ve të mbyllura sipas aktvendimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK)	15	32
Numri i raporteve të shpërndarjes së parakohshme	1	176

Nga numri prej 91,341 të kërkesave kreditore, deri në datën e raportimit, për 91,100 janë lëshuar vendimet për parashtruesit e kërkesave kreditore nga Autoritetet e Likuidimit.

NJESIA PËR TRANZICIONIN E TREPÇËS

Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin e Trepçës me 30/10/16, dhe me hyrjen në fuqi të Ligjit, është ndërprerë administrimi i Trepçës nga AKP-ja. Megjithatë, themelimi i Trepça Sh.A. nuk është jetësuar deri në miratimin e statutit të Sh.A-së, nga Kuvendi i RKS me 03/02/19. Ndërmarrja "Trepça" Sh.A. nuk është regjistruar në ARBK deri në mars '19. Pas kësaj kanë filluar punët transitorie të NjTT deri në fund të vitit 2019, me renditjen si në vijim:

- Menjëherë pas regjistrimit të "Trepça" Sh.A., në mars '19, ka pasuar kërkesa e Bordit të "Trepça Sh.A." për transferim të llogarive bankare, e cila është proceduar nga NjTT në mbledhjen e Bordit i Drejtorëve të AKP, me 29/03/19, dhe e njëjta është miratuar. Llogaritë Bankare janë transferuar tek "Trepça" Sh.A.
- Më 13/08/2019, është bërë bartja me procesverbal, e të gjitha dokumenteve të Trepçës dhe rreth Trepçës, që ka poseduar NjTT, tek komisioni i emëruar nga "Trepça" Sh.A. për pranim të dokumenteve.
- NjTT në bashkëpunim me Njësine për asete jashtë vendit të AKP-së ka identifikuar listën preliminare të aseteve të Trepçës jashtë Kosovës, dhe ka kërkuar dokumente mbështetëse për pronësi: nga Trepça Sh.A., nga Arkivi Qendror i RKS, dhe nga MZHe, duke kërkuar identifikimin dhe dorëzimin e çfarëdo dokumentacioni eventual që dëshmon pronësinë e këtyre aseteve jashtë Kosovës, si prona të Trepçës.
- NjTT në vazhdimësi ka ndihmuar Departamentin Ligjor në përfaqësimin gjyqësor për rastet e njësive të Trepçës që janë ende në administrim të AKP-së (gjithësej dhjetë njësi të ish NSh Trepça, bazuar në Ligj të Trepçës). Nga gjysma e dytë e vitit 2019, NjTT ka bërë verifikimin e pronave të këtyre njësive, në përgatitje të plotësimit të dokumentacionit për procesin e ardhshëm që pritët të vijon - pas shpalljes së likuidimit dhe privatizimit.
- Bazuar në përvojën nga e kaluara në sektorin minerar, NjTT ka iniciuar propozim projektin për studim të MIM Goleshit, meqë është njësi nën administrim të AKP-së. Propozim projekti ka siguruar financimin nga Qeveria Gjermane. Në cilësi të iniciuesit dhe koordinuesit për këtë projekt, gjatë vitit 2019, NjTT është angazhuar në përkrahjen e realizimit të punëve operative të ekspertëve të angazhuar ndërkombëtar që kanë filluar studimin e Goleshit në vitin 2018, dhe e kanë finalizuar dhe dorëzuar në AKP, në dhjetor të vitit 2019.

8. DEPARTAMENTI I KOORDINIMIT RAJONAL

Departamenti i Koordinimit Rajonal bënë mbikëqyrjen dhe Koordinimin e punës së Zyrave Rajonale të AKP-së. AKP-ja ka pesë Zyra Rajonale (ZR) në Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjiilan dhe Mitrovicë që përfshijnë të gjithë territorin e Kosovës dhe zyrën satelitore në Shtërpçë, të cilat përgjegjësi kryesore kanë grumbullimin e informatave lidhur me NSh-të në rajonet përkatëse si dhe implementimin e privatizimit, likuidimit dhe aktivitetet e qeverisjes korporative.

PËRGATITJA E ASETEVE PËR SHITJE

Gjatë vitit 2019, Zyrat Rajonale kanë përgatitur për shitje **1274 asete** të shpërndara në 11 valë të shitjeve përmes Likuidimit. Ky numër pasqyron numrin më të lartë të aseteve të ofruara për shitje ndonjëherë nga AKP përgjatë 1 viti.

Numri i aseteve që janë tërhequr nga shitja është 29, si pasojë e vendimeve gjyqësore apo vendimeve nga Qeveria.

ADMINISTRIMI I ASETEVE

Asetet e mbetura (të pashitura) me të cilat ende administron AKP-ja janë gjithsej **2,231**, ndërsa asetet jashtë Kosovës janë **163 asete** të Ndërmarrjeve Shoqërore pa i përfshirë asetet e Trepçës. Gjithsesi, ky numër mund të ndryshojë në periudhat pasuese, varësisht nga ndërrimi i statuseve të NSh-ve apo identifikimit të aseteve të NSh-ve përkatëse.

RAPORTI PËRMbledhës I Aseteve të Pa shitura Brenda Kosovës

Tabela 1 - Numri i asetëve të pashitura sipas kategorisë dhe rajonit

1	2	3	4=sum(1:3)	=4/total				Brenda dhe jashtë Kosovës
Rajoni	Asetet tjera	Tokat bujqësore	Tokat tjera	Gjithsej		Rajoni	Gjithsej jashtë Kosovës	Gjithsej
Prishtina	240	228	56	524	23%	Prishtina	61	585
Peja	211	260	110	581	26%	Peja	57	638
Prizren	106	393	12	511	22%	Prizren	24	535
Gjilan	41	180	27	248	11%	Gjilan	12	260
Mitrovica	201	180	29	410	18%	Mitrovica	9	419
Gjithsej	799	1241	234	2274	100%	Gjithsej	163	2437

Table 2 - Numri i asetëve të pashitura jashtë Kosovës

Asetet jashtë Republikës së Kosovës:

Shteti	Numri i asetëve	%
Bosna dhe Hercegovina	15	9%
Kroaci	5	3%
Mali i Zi	35	21%
Maqedoni	8	5%
Serbi	99	61%
Slloveni	1	1%
Gjithsej	163	

KHIMI I PRONAVE NË PRONËSI TË NDËRMARRJEVE SHOQËROREGjatë vitit 2019 është arritur që në bazë të vendimeve të gjykatës të kthej 113,372 m² në emër NSh-ve:

- NSh Ereniku Pordhimitaria Primare, parcela nr. 4444/2 dhe 4445/2 ZK Gjakovë, jashtë qytetit në sipërfaqe 7893 m², Aktgjykimi i Gjykatës së apelit përmes së cilit ka refuzuar ankesën e të akuzuarit dhe ka vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë. Gjithashtu vlen të ceket që shkalla e parë ka marr vendim në favor të AKP-së lidhur me padinë e ushtruar ndaj Komunës së Pejës për bartje të pronës në emër të KK Pejës;
- Morava e Binçës - ngastra kadastrale P-70403013-00044-0 në vendin e quajtur "Gllama", me sipërfaqe prej 6938 m², Zona Kadastrale Gjilan, është kthyer në pronësi të NSh-së me Aktgjykimin A.nr.2052/15 të datës 10.09.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë;
- NSh Gërmia, tokë në Bardhosh (kundër Albi Mall) - Ngastra 492, ZK Nëntë Jugoviqët, Prishtinë, sipërfaqe prej 2,814m²;
- Banka e Lubjanës me Vendime Gjykatë (Kundër Bankës Kreditore) me sipërfaqe prej 700m²;
- NSh Ratar tokat Bujqësore në Çagllavicë, parcelat 1397/1 me sipërfaqe 16,994 m² dhe 1397/2 me sipërfaqe 22,788 m²;
- KB Besa në Dumosh, ngastrat 176, 251, 272, 274, 284, 285, 386, 410, 786, 812, 946 me sipërfaqet e përgjithshme 55.245 m², me vendim të AKK-së në favor të NSh-së mirëpo ZKK Podujevë nuk e ka rikthyer gjendjen e mëparshme ende.

IDENTIFIKIMI I ASETEVE TË REJA

Vetëm këtë vit kemi identifikuar dhe kemi vënë nën administrim të AKP-së **5 asete** të reja, që më herët nuk i kishim në regjistër të Agjencisë.

IDENTIFIKIMI I ASETEVE ME PENGESA PËR SHITJE

Gjatë këtij viti, në sistemin e menaxhimit të aseteve ku janë të identifikuar asetet e mbetura, për secilin aset është bërë identifikimi i problemeve dhe përmbledhja është paraqitur si në vijim:

Rajoni	Prishtinë	Pejë	Prizren	Gjilan	Mitrovicë	Gjithsej	
Vendim të Qeverisë	6	41	17	38	67	169	7.9%
Masë të Përkoshme	41	29	11	10	3	94	4.4%
Opinioni I DHPGJS	3	-	10	5	5	23	1.1%
Mungesë e dokumentacionit	1	6	1	31	30	69	3.2%
Tranzicion	54	22	11	-	8	95	4.4%
Parcelim	4	72	-	73	40	189	8.8%
KNI	57	89	18	45	38	247	11.6%
Problem Pronësor/Kadastral	192	170	50	64	202	678	31.7%
Heqje Dorë	31	57	151	36	20	295	13.8%
Komesacion	2	32	22	6	31	93	4.4%
Kulturë mal	-	48	-	18	9	75	3.5%
Trashëgimi Kulturore	1	-	23	1	1	26	1.2%
Mosbashkëpunim me Komuna (lëshimi i certifikatave)	-	-	-	17	67	84	3.9%
Gjithsej	392	566	314	344	521	2,137	100.0%

MENAXHIMI I ASETVE NË QIRADHËNIE

Edhe gjatë kësaj periudhe, pjesë thelbësore e strategjisë, ka qenë edhe menaxhimi i aseteve përmes qiradhënies. Të dhënat e të hyrave nga qiradhënia janë si në vijim:

- Qiraja e inkasuar për NSh-të në likuidim prej **EUR 3,787,605**
- Qiraja e inkasuar për NSh-të në tranzicion prej **EUR 1,674,831**

Përkundër faktit se të hyrat nga qiraja të NSh Pallati i Rinisë, aseteve të Rilindjes dhe asetet të cilat kanë qenë me qira por janë shitur, vlen të theksohet se inkasimi i qirave për vitin 2019 ka qenë mjaftë i lartë.

Gjatë këtij viti janë dërguar në përmbarrim gjithsej 122 raste të qiramarrëseve që kanë qenë pagues të parregullt.

Gjthashtu gjatë vitit 2019, zyret rajonale kanë përgatitur dhe kanë marr aprovim nga kryesuesit e AL-ve dhe Menaxhmentit, dhe Bordi i Drejtorëve për qiradhënie të pronave të NSh-ve në përputhje me Rregulloren e Qiradhënies, dhe janë bërë shpalljet për qiradhënie për **74 asete në total** prej tyre më 21 mars 2019 ku janë përfshirë gjithsej 30 asete në likuidim dhe 6 asete në tranzicion, më 31 maj 2019 ku janë përfshi 21 asete, më 12 gusht 2019 ku janë përfshirë 3 asete në tranzicion dhe më 09 nëntor 2019 ku janë përfshirë 14 asete në tranzicion dhe likuidim.

AKTIVITETE TJERA

- Janë identifikuar të gjitha asetet sipas vendimit të Qeverisë për kthim të pronave dhe pronësi të Komunave që gjithsej përfshin **731 asete**, prej tyre nga Qeveria janë anuluar **31 asete**.
- Është azhurnuar lista me Vendime të Shpronësimeve që përfshin gjithësej janë 978 asete, dhe ky numër pritet të rritet pasi që po vazhdohet të merren vendime për shpronësim na baza të rregullta.
- Gjatë këtij viti janë përgatitur BB për **20 NSh** që iu janë nënshtruar procedurave të likuidimit.

9. DEPARTAMENTI LIGJOR

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2019 ka përfunduar ligjërisht Agjencinë në të gjitha kontestet e ngritura lidhur me AKP-në dhe Ndërmarrjet nën Administrim të AKP-së, si dhe ka ofruar udhëzime dhe monitorimin e pajtueshmërisë ligjore të shërbimeve të Agjencisë.

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2019 ka zhvilluar aktivitetet si në vijim:

- Hartimin e draft akteve nënligjore nga fushëveprimtaria e Agjencisë;
- Ka siguruar që vendimet dhe aktet ligjore e nënligjore të Agjencisë të jenë në pajtueshmëri me Kushtetutën e Kosovës dhe me legjislacionin në fuqi në Kosovë;
- Përgatitjen e akteve nënligjore në përputhje me ligjin dhe korrigjimet përkatëse ligjore;
- Shqyrtimin ligjor të 222 kontratave të shitjes;
- Dhënien e këshillave dhe analizave ligjore lidhur me veprimtarinë e Agjencisë;

Departamenti Ligjor në suaza të fushëveprimit të tij gjatë vitit 2019 është marrë me një numër të madh të lëndëve gjyqësore të cilat në formë statistikore do të paraqiten më poshtë:

- Janë pranuar gjithsej 1239 lëndë të reja Gjyqësore;
- Janë ndërmarr gjithsej 2108 veprime procedurale në lëndë Gjyqësore. Veprimet procedurale nënkuptojnë: Ankesa, përgjigje në padi, padi, kundërpadi, masa të përkohshme, përgjigje në urdhëra gjyqësor etj.

Departamenti Ligjor në vitin 2019 është angazhuar në dy arbitrazhe ndërkombëtare ku AKP paraqitet në cilësinë e palës së paditur, andaj përgjatë vitit ka qenë një angazhim i madh në mbrojtje ligjore në këto dy konteste të cilat për shkak të rëndësisë që kanë do të elaborohen më poshtë në rubrikë të vecantë.

Departamenti ligjor po ashtu ka qenë i angazhuar për mbrojtje ligjore të aseteve jashtë vendit dhe lidhur me to ka zhvilluar aktivitetet si në vijim:

- Për herë të parë është vendosur komunikim me Odën e Avokatëve të Bosnje Hercegovinës si dhe me Agjencinë e Privatizimit për kantonin e Sarajevës;
- Gjatë vitit 2019 AKP kishte autorizuar një person me shtetësi Maqedonase për të identifikuar asetet e Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat gjinden në Maqedoninë Veriore. Si rrjedhojë për herë të parë janë identifikuar gjithsej 3 asete në Maqedoninë Veriore.

- Gjatë vitit 2019 ka pasur interesim të investitorëve për të blerë asetet e Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat gjenden në Mal të Zi. Përveç investitorëve individual për këto asete janë interesuar edhe Oda Ekonomike Britaneze në Kosovë;

ARBITRAZHET

Përveç aktiviteteve të rregullta në përfaqësime Departamenti Ligjor ka qenë i angazhuar edhe në dy konteste ndërkombëtare të arbitrazhit.

Në rastin e parë AKP-ja është e paditur nga kompania Gjermane Sharr Betailangung GmbH e cila është pronare e Ndërmarrjes Sharrcem në Han të Elezit (Fabrika e Cimentos) e privatizuar në vitin 2010. Kjo kompani ka paditur AKP-në për vendimin e lëshuar nga Bordi i Drejtorëve me të cilin vendim blerësi/kompania detyrohet të paguaj vlerën prej 9.4 milion euro si cmim shtesë, ngase kompania nuk e kishte përmbushur zotimin sipas kontratës për investimin e shumës prej 35 milion euro, dhe bazuar në Kontratën për shitblerjen e aksioneve si masë penalizimi AKP-ja ka shqiptuar vendim për pagesën e pjesës së mos përmbushjes në vlerë prej 9.4 milion, vlerë kjo e përcaktuar nga Auditori i jashtëm i pavarur. Lidhur me këtë rast Departamenti Ligjor kishte përgatitur përgjigjen dhe kundërshtimin në njoftimin për arbitrazh si dhe ka zhvilluar procedurat e angazhimit të kompanisë ligjore ndërkombëtare për mbrojtje ligjore në Gjykatën permanente të Arbitrazhit në Hagë.

Firma ligjore e angazhuar është nga SHBA, një kompani e njohur globalisht e cila ka filluar të merret me rastin në mënyrë intensive, duke hartuar strategjinë mbrojtëse para tribunalit të Arbitrazhit. Vlenë të theksohet se Autoriteti i caktuar për të udhëhequr këtë procedurë të arbitrazhit është Gjykata Permanente e Arbitrazhit në Hagë.

Rasti i dytë i arbitrazhit ka të bëjë me Ndërmarrjen Miniera e Goleshit. Në këtë rast paditëse është kompania Kroatë IMING D.O.O e cila ka paditur AKP-në për kompensim të Investimeve si dhe për fitim të humbur në vlerë prej 18 milion euro lidhur me Minierën dhe Industrinë e Magnezit "MiM Golesh". Duhet theksuar se AKP në vitin 2014 kishte marrë vendim për tërheqjen e aksioneve të Ndërmarrjes së re Miniera dhe Industria e Magnezit "MiM Golesh" Magure. Vendimi ishte bazuar në dështimin e blerësit/kompanisë kroate në përmbushjen e zotimeve kontraktuale për investim dhe punësim. Ky vendim i AKP-së ishte konsideruar si i ligjshëm nga Dhoma e Posacme e Gjyktës Supreme në të dyja shkallët.

AKP-ja në përgjigjen e saj në padi fillimisht ka kundërshtuar Jurisdikcionin e Tribunalit të Arbitrazhit për faktin se kjo çështje është Gjykuar në merita në Dhomën e Posacme të Gjykatës Supreme, dhe me këtë shqyrtim gjyqësor është absorbuar e drejta e palës për gjykim të çështjes edhe në Arbitrazh.

Po ashtu është kontestuar edhe vlera e kërkuar në emër të kompensimit të dëmit dhe fitimit të humbur. Përgjigja në Padi ka qenë voluminoze ngase për bazë janë marrë edhe praktikë botërore se si janë zgjidhur rastet e tilla, dhe janë përdorur argumentet juridike për të drejtën e AKP-së në këtë çështje, si dhe kontestimin e bazës juridike për fitim të humbur.

Në fund të vitit 2019 AKP ka shpallur tenderin publik për angazhimin e kompanisë ligjore me eksperiencë në konteste të arbitrazhit, për të përfaqësuar AKP-në në këtë procedurë të arbitrazhit.

10. DEPARTAMENTI I MARKETINGUT, MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN DHE INVESTITORËT

Shtylla kryesore e angazhimit të Departamentit të Marketingut, Marrëdhënieve me Publikun dhe Investitorë gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, në përputhje me rolin që ka, ka qenë sigurimi i përkrahjes së plotë në promovimin e punës së Agjencisë. Pasi që njëra nga funksionet primare është e lidhur ngushtë me shitjen si proces, njëkohësisht është siguruar përkrahje e plotë për të gjitha shitjet e realizuara nga Agjencia si dhe është punuar në drejtim të menaxhimit të raporteve të mira me investitorët potencial.

Aktivitetet e realizuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, janë të grupuara në përputhje me objektivat e cekura në planin e punës për vitin 2019:

Përkrahja e plotë në shpallje të Shitjeve të Aseteve

Praktikat e deritanishme të informimit publik janë aplikuar përmes aktiviteteve mbështetëse për shpalljen e shitjeve, në drejtim të implementimit të strategjisë së marketingut masiv në kombinim me aktivitete të marketingut direkt, për çdo Shitje të Aseteve që është shpallur (SHAL43A, SHAL44, SHAL45, SHAL46, SHAL47, SHAL48, SHAL49, SHAL50, SHAL51, SHAL52 dhe SHAL3). Në krahasim me praktikë të deritanishme ka pasur rritje të prezencës në media, duke rritur numrin e TV për transmetim të TV reklamës në 6 kanale televizive dhe 28 portale të kontraktuara ku janë bërë njoftimet e nevojshme, në funksion të përmbushjes së qëllimit për ngritje të vizibilitetit dhe shpërndarjes sa më masive të informatës tek të gjitha palët e interesit.

Ngritja e vizibilitetit dhe promovimit të procesit të privatizimit

Marrë parasysh trendet dhe zhvillimet e fundit në marketingun digjital, Agjencia ka rritur prezencën në media sociale, ku gjatë periudhës raportuese janë bërë 200 postime në rrjetet sociale që krahasuar

me vitin e kaluar (92) këtë vit është dyfishuar numri i postimeve. Gjatë periudhës raportuese kemi pas interesim për informata në rrjete sociale nga 89 palë rrjedhimisht 89 përgjigje janë adresuar përmes këtij kanali të komunikimit, ndërkaq ka pranuar dhe adresuar rreth 119 pyetje dhe kërkesa në emailin zyrtar të AKP-së info@pak-ks.org.

Këtë vit Agjencia ka realizuar fushata që kanë pas për fokus rritjen e numrit të investitorëve rrjedhimisht edhe interesit të tyre. Gjatë periudhës janar - dhjetor 2019 Agjencia ka zhvilluar dhe implementuar tetë (8) fushata në rrjete sociale, dyfish më shumë krahas vitit të kaluar e cila ka rezultuar me rritje të shtrirjes. Në mars të këtij viti Agjencia ka realizuar fushatën promovuese të shitjeve të aseteve në rrjetet sociale e cila ka arritur shtrirjen prej rreth 20,000 përdoruesve e cila ka rezultuar me rritjen e numrit të ndjekësve në 5,132 ndjekës. Me po të njëjtin fokus, me qëllim të përfshirjes së diasporës shqiptare, në përpunje me objektivat e zyrës për informim për përpilim dhe publikim të artikujve sponsorizues, Agjencia ka publikuar artikullin me titull: “AKP-ja fton mërgimtarët të blejnë prona në Kosovë”. Ky artikull është publikuar në shumicën e portaleve informuese në Kosovë dhe i njëjti është sponsorizuar në korrik të këtij viti duke arritur shtrirjen prej rreth 14,000 përdoruesve. Me ndryshimin e rregullave të tenderit për procesin e aplikimit në privatizim Agjencia ka realizuar edhe fushatë vetëdijësuese për këto ndryshime e cila ka arrit shtrirje prej rreth 25.000 përdoruesve. Në total këto dhe fushatat tjera kanë arritur shtrirje prej përrreth 280,000 përdoruesve.

raportet dhe rregulloret e AKP-së, rezultatet dhe vendimet për shitjet e Aseteve, si dhe informatave të tjera të rëndësishme.

Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve të ofruara dhe pasurimi i bazës së të dhënave të investitorëve

Njësia e Marketingut dhe Marrëdhënie me Investitorë ka vazhduar të mbetet pika primare e komunikimit me investitorët potencial vendor dhe ndërkombëtar, duke u përgjigjur kërkesave dhe ofruar udhëzime dhe këshillime rreth procesit të privatizimit dhe pjesëmarrjes në tenderët e shpallur, përfshirë koordinimin e hulumtimit paraprak dhe sigurimin e materialeve tenderuese (Rregullat e Tenderit, Memorandume Informimi etj.).

- Janë ofruar këshillime rreth procedurave të shitjes dhe udhëzime rreth përgatitjes së ofertave.
- Rreth nivelit të interesimit për asetet e përfshira në Shitjen e Aseteve gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2019 janë dhënë rreth 1,200 dosje të tenderit, me ç’rast palët kanë nënshkruar marrëveshjen për ruajtjen e sekretit afarist, kanë pranuar dosjet e tenderit dhe sipas kërkesës është bërë edhe koordinimi për vizita në terren.

Për qëllime marketingu në vazhdimësi bëhet popullimi i databazës me të dhëna të investitorëve potencial, të cilët njoftohen në vazhdimësi mbi shpalljet e Shitjeve të Aseteve përmes e-mailit dhe SMS shërbimit.

Ngritja e transparencës dhe nivelit të informimit

Me qëllim të krijimit të një pasqyre më të qartë të gjendjes së aseteve të pa shitura që janë në administrim të Agjencisë, deri më tani janë shfrytëzuar fotografi të rastit të bëra gjatë procesit të përgatitjes së aseteve për shitje dhe ortofotot/fotografite e nxjerra nga gjeoportali. Me zhvillimin e teknologjisë po ofrohen mundësi të reja për pasqyrimin sa më të saktë të pronave dhe njëra ndër këto mundësi ofrohet përmes incizimeve me dron prandaj gjatë vitit 2019 është inicuar projekti “Regjistrimi i aseteve”, ku është paraparë që portfolio e aseteve të pashitura të Agjencisë të plotësohet me gjendjen reale të këtyre aseteve përmes videove të realizuara me incizime përmes dronit dhe fotografive 360°. Fillimisht është bërë selektimi i një grupi të aseteve, sipas kritereve të caktuara, që konsiston në total rreth 760 asete. Finalizimi i këtij projekti pritet të bëhet gjatë vitit 2020.

Në shërbim të ngritjes së transparencës dhe nivelit të informimit, ueb faqja e AKP-së është azhuruar dhe populluar me informata të sakta dhe në kohë reale me të gjitha informatat publike në lidhje me procesin e privatizimit në Kosovë. Kjo përfshin lansimin e Shitjes së Aseteve, listat preliminare dhe finale të punëtoreve për shpërndarjen e 20%, raportet përfundimtare të likuidimit, komunikatave për media,

11. DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE

Gjatë periudhës raportuese (1 janar - 31 dhjetor 2019) në Departamentin e Burimeve Njerëzore janë zhvilluar aktivitetet si në vijim:

REKRUTIMET:

Gjatë kësaj periudhe, DBNJ ka udhëhequr me procedurat e rekrutimit për tridhjetë e një (31) procese të rekrutimit (15 rekrutime të jashtme, 16 rekrutime të brendshme) prej të cilave:

- Dy (2) procese janë pezulluar pas pezullimit të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik nga Gjykata Kushtetuese;
- Dy (2) procese janë rishpallur;

DORËHEQJE: Për arsye personale tre (3) punonjës kanë ofruar dorëheqje.

TRANSFERET: Njëmbëdhjetë (11) punonjës janë transferuar në mënyrë të përkohshme dhe tre (3) punonjës janë transferuar në mënyrë të përhershme.

PEZULLIM I DAKORDUAR: Gjashtë (6) punonjësve u është lejuar pezullimi i dakorduar i marrëdhënies së punës sipas Ligjit në fuqi.

PENSIONIM: Një (1) punonjës është pensionuar me rastin e përmbushjes së moshës 65 vjeçare;

PUSHIM LEHONIE: Bazuar në Ligjin aktual në fuqi, 6 (gjashtë) zyrtarë kanë shfrytëzuar pushimin e lehonisë.

USHTRUES DETYRE: Gjatë vitit 2019, 27 (njëzeteshtatë) zyrtar janë caktuar ushtrues detyre

në periudha të ndryshme. Arsyet dhe nevojat për caktim të pozitës ushtrues detyre kryesisht kanë të bëjnë me zëvendësimin e pozitave të mbetura të paplotësuara pas pezullimit të dakorduar të pozitave dhe krijimit të pozitave të reja sipas strukturës së re organizative.

TË TJERA:

- Janë realizuar gjithsej njëmbëdhjetë (11) trajnime me ç'rast nga këto trajnim kanë përfituar 30 punonjës;
- Si rrjedhojë e ndryshimeve në strukturën organizative të AKP-së, DBNJ është kujdesur për kryerjen e të gjitha procedurave për funksionalizimin e njësisë me Negocim Direkt si dhe kryerjen e të gjitha procedurave që ndërlidhen me transferin e Njësisë së Shkresave Gjyqësore nga Departamenti i Administratës në Departamentin Ligjor;
- Është iniciuar procesi i vlerësimit të performancës për periudhën janar - dhjetor 2019, caktimi i objektivave për periudhën janar dhjetor 2020 si dhe Plani i trajnimit për vitin 2020 për të gjithë punonjësit e AKP-së;

12. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Njësia e Protokollit: Gjate kësaj periudhe, në këtë njësi janë pranuar/dërguar dhe proceduar dokumentet si në vijim:

- Të regjistruara në sistem hyrje/dalje janë **11901 shkresa** nga të cilat:
- Dokumente dhe shkresa hyrëse **5812**;
- Dokumente dhe shkresa dalëse janë regjistruar **6089**;
- Shkresa të Dhomës së Posaçme të identifikuar për Autoritetin e Likuidimit **1208**.

Njësia e Teknologjisë Informative:

Viti 2019 është karakterizuar me një stabilitet të qëndrueshëm të sistemit. Njësia e TI-së ka ndërmarr shumë masa parandaluese të cilat kanë rezultuar në shërbime kualitative të pandërprera dhe ndër më kryesoret mund të cekën pikat në vijim:

- Instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve të reja (ndërrimi i kompjuterëve, printerëve skanerëve të vjetër) nga procesi i prokurimit të vitit të kaluar (50 kompjuterë të rinj, printerë e pajisje tjera);
- Përmirësim i sistemit operativ të klientëve (Upgrade) nga Microsoft Windows 7 në Microsoft Windows 10, si dhe përmirësim i aplikacionit Microsoft Office 2007 në Microsoft Office 2013 i më shumë se 150 kompjuterëve;
- Përmirësim i sistemit operativ të serverëve (Upgrade) nga Microsoft Windows 2008 R2 në Microsoft Windows 2012 R2;
- Përmirësimi i shpejtësisë së komunikimit në rrjet përmes instalimit të dy Switch-ave 50 portesh të rinj, objektiv ky i përmbushur, i caktuar nga viti paraprak;
- Instalimi dhe konfigurimi i serverëve të rinj në zyrat rajonale.

Njësia e Arkivit:

- Dokumentacioni i skanuar, regjistruar dhe arkivuar për Departamentin e Shitjes, me 1009 oferta të shitjes;
- 2062 regjistratorë të regjistruar dhe arkivuar të Departamenteve të ndryshme të AKP-së;
- Futja e të dhënave në softuerin e Arkivit për 1062 regjistratorët e skanuar, regjistruar dhe arkivuar;
- Arkivimi i 184 kontratave të shitjes përmes Likuidimit;

Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme:

Gjatë këtij viti, në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike dhe kompaninë projektuese, kemi përgatitur projektin për adaptimin dhe e një pjese të Anexit të Objektit Rilindja për të akomoduar stafin e Selisë Qendrore dhe Zyrës Rajonale të Prishtinës, projekt i cili në fund të vitit filloi zyrtarisht punimet. Po ashtu, kemi punuar në projektin e lëvizjes së zyrës dhe arkives së ZR Gjilan; Janë protokolluar 742 fatura, të cilat janë përcjellë në Departamentin e Financave, prej tyre janë futur në SIMFK 738 Raporte; Kemi iniciuar 18 deklarata të nevojave pas analizave dhe hulumtimeve dhe kërkesave për nevoja të ndryshme të AKP-së;

Njësia e Transportit:

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur 886 kërkesa për shërbime të rregullta të transportit dhe 1155 shërbime-kërkesa urgjente, të cilat janë mbuluar.

13. DEPARTAMENTI I FINANCE DHE BUXHETIT

Tabelat e paraqitura më poshtë janë një ekstrat i raporteve që janë marrë nga pasqyrat financiare për Buxhetin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Fondeve në Mirëbesim. Pasqyrat financiare së bashku me shënimet shpjeguese janë në shtojcën e këtij raporti. Pasqyrat financiare për Buxhetin e AKP-së të dorëzuar në Ministrinë e Financave janë sipas formatit të përcaktuar me rregulloren në fuqi të Ministrisë së Financave. Ndërsa pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim janë në pajtim me rregulloren e Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

FINANCIMI I AKTIVITETEVE OPERATIVE DHE ADMINISTRATIVE TE AKP-së

Aktivitetet operative dhe administrative të AKP-së, financohen nga të hyrat e dedikuara të realizuara nga 5% e shitjeve të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore. Për më tepër shih nenin 21 të Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Përshkrimi	Renditja	Buxheti Original (Ligji Nr. 06/L-133)	Buxheti i Rishikuar Gjysmëvjetor (nuk ka pasur)	Buxheti i aprovuar për periudhën deri më 31 Dhjetor 2019	Pagesat	%	%
		a	b	c	d	e=d/a	f=d/c
Gjithsej	1+2	8,276,049	-	7,473,049	6,975,898	84%	93%
Pagat dhe mëditjet		5,394,049	-	5,394,049	5,225,577	97%	97%
Mallrat dhe Shërbimet		2,714,000	-	1,911,000	1,624,097	60%	85%
Shpenzimet Komunale		98,000	-	98,000	63,598	65%	65%
Subvencione dhe Transferet		40,000	-	40,000	39,996	100%	100%
Investimet Kapitale		30,000	-	30,000	22,630	75%	75%
Të hyrat e dedikuara 2019	1	2,000,000	-	2,000,000	2,000,000	100%	100%
Pagat dhe mëditjet		2,000,000	-	2,000,000	2,000,000	100%	100%
Granti i Përgjithshëm 2019	2	6,276,049		5,473,049	4,975,898	79%	91%
Pagat dhe mëditjet		3,394,049		3,394,049	3,225,577	95%	95%
Mallrat dhe Shërbimet		2,714,000		1,911,000	1,624,097	60%	85%
Shpenzimet Komunale		98,000		98,000	63,598	65%	65%
Subvencione dhe Transferet		40,000		40,000	39,996	100%	100%
Investimet Kapitale		30,000		30,000	22,630	75%	75%

	2003 DERI MË 31 DHJETOR 2018	PERIUDHA 1 JANAR 31 DHJETOR 2019	2003 DERI MË 31 DHJETOR 2019
PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE			
<u>Të hyrat nga shitjet</u>	715,306,649	41,345,259	756,651,908
<u>Të hyrat nga qiraja</u>	38,832,654	5,462,436	44,295,090
<u>Interesi i fituar</u>	34,844,700	-	34,844,700
<u>Tarifa për pjesëmarrjen në tenderat e shitjes dhe konfiskimet e BID depozitave</u>	8,319,864	464,400	8,784,264
<u>BID depozitat e ofertuevse</u>	843,200	1,903,289	2,746,489
<u>Të hyra të tjera</u>	7,263,974	88,124	7,352,098
<u>Kapitali themeltar i Agjencisë</u>	1,013,200	-	1,013,200
GJITHSEJ PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE	806,424,241	49,263,508	855,687,749
PAGESAT/SHPËRNDARJA NGA LLOGARITË			
<u>20% i punëtorëve transferuar në BSPK</u>	126,227,784	7,122,367	133,350,151
<u>Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoriteti i Likuidimit)</u>	16,000,930	136,309	16,137,239
<u>Mallra dhe shërbime</u>	16,323,064	1,562,728	17,885,792
<u>Shërbime publike</u>	2,406,373	231,239	2,637,612
<u>Tatimet</u>	6,134,291	932,654	7,066,945
<u>Taksa/depozita të Gjykatave dhe vendimet e gjykatave/përmbaruesve</u>	2,515,922	8,605	2,524,527
<u>Transferimi i mjeteve 5% për mbulimin e aktiviteteve të AKP-së</u>	44,741,706	1,036,241	45,777,947
<u>Shpenzimet tjera</u>	787,190	18,563	805,753
<u>Pagesat ndaj kreditorëve të NSh-ve</u>	26,454,012	1,168,818	27,622,830
<u>Fondet transferuar Buxhetit të Kosovës</u>	176,717,033	150,001,970	326,719,003
GJITHSEJ PAGESAT/SHPËRNDARJA	418,308,305	162,219,494	580,527,799
Gjendja në llogaritë bankare	31 Dhjetor 2018	2019 Hyrje/Dalje	31 Dhjetor 2019
BILANCI I PRANIMEVE DHE PAGESAVE	388,115,937	(112,955,986)	275,159,950

13. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT

Në Departamentin e Prokurimit gjatë periudhës janar-dhjetor 2019 janë nënshkruar 72 kontrata duke përdorur të gjitha procedurat e prokurimit të parapara me ligj.

Me poshtë gjeni ndarjen e kontratave sipas kategorive:

- **Kontratë për shërbime** - janë realizuar gjithsej **50**;
- **Kontratë për furnizime** - janë realizuar gjithsej **22**.

14. DEPARTAMENTI I KOMISIONEVE PROFESIONALE

Më poshtë në formë tabelare do të shpalosen të dhënat për vitin 2019 në formë të vlerave monetare të shpërndarjeve për 20% të punëtorëve si dhe të dhënat e veprimeve procedurave të ndërmarrja në kuadër të Komisioneve Profesionale.

Përshkrimi	Janar - Dhjetor 2019
Numri i Listave Fillestare	22
Numri i Listave Finale	23
Numri i përfitueseve të 20%	9,437
Vlera e përfituar	€7,122,367
Numri i vendimeve të DhPGJJK	33
Numri i ankesave të shqyrtuara	522
Ankesa të aprovuara	209
Kontrata për shitjen e banesave të nënshkruara	14
KPS - të të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve	7

- Numri i listave fillestare, nënkupton momentin kur një Ndermarrje ka shitje të asetve apo shpronësim të asetve, për atë Ndermarrje AKP në bashkëpunim me BSPK-në, përgatit listat fillestare me emra të ish punëtorëve të kualifikuar, duke u bazuar në Rregulloren nr. 2003/13 (me ndryshime). Në vitin 2019 kemi pasur gjithsej 22 lista fillestare të Ndërmarrjeve Shoqërore.

- Numri i listave finale, nënkupton aprovimin final të listës nga ana e Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, sipas propozimeve nga Departamenti i Komisioneve Profesionale, lista finale përgatitet në harmoni me rregulloren 2003/13, ku fillimisht lista fillestare publikohet në gazetën vendore dhe rajonale (Serbi dhe Mal të Zi), më pas në rast se ka ankesa apo kundërshtime ndaj listës fillestare, Agjencia/DKP shqyrton ankesat e palëve dhe i propozon BD të miratohen propozim ndryshimet e listës fillestare, ku më pas, palët e pa kënaqura ndaj vendimeve të Agjencisë, kanë të drejtë ankese në Dhomen e Posaçme. Në vitin 2019 kemi pasur gjithsej 23 lista finale (një e bartuar nga viti 2018).

- Numri i përfitueseve të 20% apo numri i punëtorëve të ish Ndermarrjeve Shoqërore që kanë përfituar apo kanë pranuar mjete financiare nga shitja e asetve/ndërmarrjeve është 9437 punëtor.

- Vlera e përfituar për punëtorët e lartëcekur (9437) është €7,122,367.00

- Numri i vendimeve të DhPGJJK, nënkupton vendimet që janë marrur nga Dhoma e Posaçme GJSK lidhur me ankesat e punëtorëve të NSH-ve, e në këtë rast për vitin 2019 kemi 33 vendime të plotfuqishme nga Dhoma lidhur me listat e punëtorëve të 20% (ankesat janë për mos përfshirje në listë, por dhe rastet kur personat në listë janë kundërshtuar nga palët e treta).

- Numri i ankesave të shqyrtuara, nënkupton ankesat e shqyrtuara nga Departamenti i Komisioneve Profesionale ndaj Listës Fillestare e cila është e sqaruar në pikën 2. Në vitin 2019 janë shqyrtuar 522 ankesa.

- Ankesa të aprovuara, nënkupton se nga 522 ankesa të shqyrtuara nga DKP janë propozuar për aprovim 209 dhe janë miratuar nga Bordi i Drejtorëve të Agjencisë sipas propozimit të DKP-se.

KPS të aprovuar nga Bordi Drejtorëve nënkupton numrin e kërkesave për përcaktimin e statusit të Ndërmarrjeve Shoqërore. Ekzistojnë disa Ndërmarrje të cilat nuk e kanë ende të përcaktuar statusin juridik nga i cili varet edhe juridiksioni i AKP-së mbi ato Ndërmarrje.

15. NJËSIA E NEGOCIMIT DIREKT

Në fillim të vitit 2019, AKP-ja ka aprovuar ndryshimin e rregullores për shitjen e aseteve specifike të ndërmarrjeve shoqërore, përmes Negocimit Direkt. Pos tjerash në kuadër të ndryshimeve të aprovuara është edhe shkrirja e dy komisioneve, të cilat paraprakisht kanë vepruar ndaras, por në një njësi të vetme të quajtur, Njësia e Negocimit Direkt (NND).

Me aprovimin e rregullores për njësinë respektive, ne ueb faqe të Agjencisë së Privatizimit janë publikuar rregullat dhe formularët për paraqitje të kërkesave nga palët e interesuara. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2019 përveç kërkesave të regjistruara në vitet paraprake janë pranuar edhe shumë kërkesa të reja.

Për t'i ndjekur procedurat e parapara me rregullore deri tek përmbyllja e shitjeve, janë angazhuar një numër i konsiderueshëm i ekspertëve të gjeodezisë dhe të vlerësimit të pronave të paluajtshme. Pas shqyrtimit të lëndëve, kërkesat e palëve janë prezantuar në Bordin e Drejtorëve përmes raporteve rekomanduese, respektivisht raporteve përfundimtare.

Numri i kontratave të dorëzuara deri në fund të vitit 2019, arrinë shifrën 84, ndërsa numri i shitjeve të aprovuara është në procedurë të pagesës ose draftimit të kontratës.

Më poshtë janë të paraqitur në formë tabelare treguesit statistikor:

Nr.	Treguesit [veprimet]	Numri i përgjith.
1	TË REGJISTRUARA Numri i përgjithshëm i kërkesave të regjistruara	1,598
2	TË SHQYRTUARA Numri i kërkesave/Raporteve Referuese, të shqyrtuara (nga NND dhe Komisioni për shqyrtimin e aseteve me karakter specifik)	482
3	TË APROVUARA Numri i kërkesave të miratuara në BiD (Raportet Rekomanduese - Baza juridike e negocimit)	222
4	TË APROVUARA Numri i Rasteve (Kërkesave) të miratuara në Bord (Raportet Përfundimtare- Aprovimi i shitjes)	132
5	Numri i Kontratave të dorëzuara	86
8	Numri i Rasteve (Kërkesave) të refuzuara në BiD	4
9	Numri i Rasteve (Kërkesave) të refuzuara në NND	174

16. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM (NJAB)

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) me sukses ka arritur që të përmbushë planin e vet të punës për periudhën janar-dhjetor 2019, duke i ofruar Menaxhmentit rekomandime konkrete.

Aktivitetet audituese të realizuara për vitin 2019:

- Auditimi i Departamentit të Financave dhe Buxhetit i finalizuar në muajin janar 2019;
- Auditimi i Njesisë së Monitorimit, Kontrollit dhe Administrimit Direkt i finalizuar në muajin prill 2019;

- Auditimi i Departamentit Ligjor i finalizuar në muajin qershor 2019;
- Auditimi i Departamentit të Burimeve Njerëzore i finalizuar në muajin qershor 2019;
- Auditimi i Departamentit të Shitjes i finalizuar në muajin tetor 2019;
- Auditimi i Departamentit të Koordinimit Rajonal (DKR) dhe Zyrat Rajonale i finalizuar në muajin dhjetor 2019;
- Auditimi i Departamentit të Prokurimit i finalizuar në muajin dhjetor 2019;


Aktivitete tjera të Njesisë së Auditimit:

- **Mbajtja e takimeve të Komitetit të Auditimit:** Gjatë periudhës raportuese Komiteti i Auditimit ka mbajtur katër takime, ku janë diskutuar raportet mbi aktivitetet e NjAB-it për periudhën janar-tetor 2019, janë aprovuar Strategjia e NjAB 2020-2020, si dhe plani i punës së NjAB për vitin 2020, ka pasur diskutime mbi draft-raportet dhe raportet finale të auditimit të ZKA-së, diskutime mbi përcjelljen e implementimit të rekomandimeve të NjAB-it nga Menaxhmenti, si dhe janë diskutuar çështje tjera që ndërlidhen me kontrollin e brendshëm të Agjencisë;
- **Përgatitja e raporteve mbi aktivitetet e NjAB-it për Njësine Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm (NjQHAB):** Duke iu referuar kërkesave ligjore, në muajin janar, NjAB ka përgatitur dhe dorëzuar tek NjQHAB-ja raportet mbi aktivitetet e saj për vitin 2018. Po ashtu gjatë periudhës raportuese NjAB-ja ka bërë raportimin mbi aktivitetet e kryera për periudhën janar-qershor 2019;
- **Përgatitja e planit të punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2020:** Gjatë periudhës raportuese është përgatitur Plani i punës së NjAB-it për vitin 2020, së bashku me strategjinë e NjAB për periudhën 2020-2022. Këto dokumente, sipas procedurave janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve;
- **Hartimi i regjistrit të rrezikut të AKP-së për vitin 2019:** Gjatë periudhës raportuese është azhurnuar regjistri i rrezikut të Agjencisë dhe i njëjti është harmonizuar me objektivat e AKP-së për vitin 2019;
- **Auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) për AKP-në dhe Fondet në Mirëbesim nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA):** Gjatë periudhës raportuese, Ekipi i Auditimit të ZKA-së ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare të AKP-së dhe Fondeve në Mirëbesim, për vitin 2018. Në muajin Qershor, nga ZKA-ja kemi pranuar raportet finale të auditimit të PVF-ve të Fondeve në Mirëbesim dhe AKP-së për vitin 2017. Po ashtu, gjatë periudhës raportuese (gjatë periudhës tetor-dhjetor), Ekipi i Auditimit të ZKA-së ka kryer auditimet e ndërmjetme të PVF-ve të AKP-së dhe Fondeve në Mirëbesim për vitin 2019. ZKA-ja në fund të këtyre auditimeve të ndërmjetme nuk ka lëshuar ndonjë memo të auditimit;
- **Përgatitja e Planit të veprimit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2018:** Duke iu referuar kërkesave ligjore, pas pranimit të raporteve të auditimit nga ZKA-ja, në bashkëpunim me Menaxhmentin është përgatitur Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2018. Ky plan, konform procedurave është dorëzuar tek ZKA-ja brenda afateve të përcaktuara ligjore. Po ashtu, duke iu referuar kërkesave ligjore, në fund të muajit shtator, AKP-ja ka përgatitur raportet periodike mbi adresimin e rekomandimeve të ZKA-së. Këto raporte, sipas procedurës janë përcjellë tek Auditori i Përgjithshëm.

I. SHTOJCAT E RAPORTIT VJETOR 2019

1. Organogrami i AKP;
2. Lista e Ndërmarrjeve të likuiduara;
3. Pjesa tekstuale e Raportit financiar sipas formatit të Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Kosovës;
4. Pjesa tabelare e Raportit financiar sipas formatit të Komisionit për Buxhet dhe Financave të Kuvendit të Kosovës;
5. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Vjetor të Agjencisë;
6. Pasqyrat Financiare të Fondeve në mirëbesim;

versioni:
25 Prill 2019



2. LISTA E NDËRMARRJEVE NËN LIKUIDUARA

Nr.	ID e NSh-së	Emri i NSh-së	Selia e NSh-së apo asetit në Kosovë [Komuna]	Rajoni AKP	A është NSh (selia në Kosovë) apo aset (selia jashtë Kosovës)	Data e vendosjes në likuidim	Data e pranimit të vendimit të DHP për mbyllje të NSh-së	Numri i vendimit të DHP për mbyllje të NSh-së
1	GJI019	K.B "Perlepnica"	Gjilan	Gjilan	NSH	24 shkurt 2014	27 Maj 2019	C-IV-19-0004
2	GJI054	N.P.SH.T." Metalografika"	Ferizaj	Gjilan	NSH	8 Mars 2007	30 Janar 2019	C-IV-18-0074
3	GJI108	N.Sh.T "Fertrans"	Ferizaj	Gjilan	NSH	17 Tetor 2007	30 Janar 2019	C-IV-18-0079
4	GJI151	Vet Station- Ferizaj/ Uroševac	Ferizaj	Gjilan	NSH	19 Shkurt 2007	30 Janar 2019	C-IV-18-0072
5	GJI154	Cinema Gjilan	Ferizaj	Gjilan	NSH	09 Tetor 2007	30 Janar 2019	C-IV-18-0081
6	GJI156	Universiteti i Punetoreve/Cinema - Ferizaj	Ferizaj	Gjilan	NSH	04 Qershor 2007	30 Janar 2019	C-IV-18-0082
7	GJI169	Partizan, Babush	Ferizaj	Gjilan	NSH	09 Shtator 2013	30 Janar 2019	C-IV-18-0094
8	MIT032	Stacioni i Veterinës Skenderaj	Skenderaj	Mitrovica	NSH	09 Gusht 2010	30 Janar 2019	C-IV-18-0070
9	PEJ010	Fabrika e ushqimit të kafshëve Klinapremix	Klinë	Peja	NSH	14 Maj 2007	30 Janar 2019	C-IV-18-0083
10	PEJ011	Fabrika e Farës Dardania	Klinë	Peja	NSH	14 Maj 2007	30 Janar 2019	C-IV-18-0071
11	PEJ012	Fabrika e Kërpudhave Shampinjoni i Kosovës	Klinë	Peja	NSH	31 Dhejtor 2010	30 Janar 2019	C-IV-18-0080
12	PEJ184	NT Petrans Pejë/Pec	Pejë	Peja	NSH	15 Mars 2010	30 Janar 2019	C-IV-18-0078
13	PRN013	KB ORLLAN	Podujevë	Prishtina	NSH	28 Shkurt 2007	30 Janar 2019	C-IV-18-0075
14	PRN059	KOSOVA CONTROL	Prishtinë	Prishtina	NSH	15 Janar 2007	30 Janar 2019	C-IV-18-0077
15	PRZ072	KB Mushtisht-Mushtisht (Suhareka)	Suharekë	Prizren	NSH	31 Dhjetor 2010	30 Janar 2019	C-IV-18-0073

3. PJESA TEKSTUALE E RAPORTIT FINANCIAR SIPAS FORMATIT TË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA TË KUVENDIT TË KOSOVËS;

RAPORTI NARRATIV VJETOR FINANCIAR PËR VITIN 2019



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Vula pranuese e Njesisë për
Propozime dhe Parashtresa

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

-Raporti Financiar për vitin 2019-

Kodi i Organizatës Buxhetore: 239

Informatat kontaktuese:

Zyrtari Kryesor Administrativ: Valon Tolaj, Drejtor Menaxhues, Rr. Agim Ramadani Nr. 23, 10000 Prishtinë , Tel, 038 500 400 E-mail:valon.tolaj@pak-ks.org

Zyrtari Kryesor Financiar: Adem Selishta, Drejtor i Financave dhe Buxhetit, Rr. Agim Ramadani Nr. 23, 10000 Prishtinë , Tel, 038 500 400, E-mail: adem.selishta@pak-ks.org

Data: 24.02.2020

1) Hyrje: Ju lutem paraqitni në formë tekstuale një përmbledhje të zhvillimeve kryesore në buxhetin e organizatës suaj. Të mos kalohet hapësira e ofruar më poshtë!

Buxheti fillestar i AKP-së për vitin 2019 i aprovuar nga Kuvendi në total është EUR 8,276,049 dhe për financim është paraparë që shuma prej EUR 2,000,000 të financohet nga të hyrat e dedikuara të AKP-së, ndërsa pjesa tjetër nga Granti Qeveritar.

Buxheti përfundimtar i AKP-së për vitin fiskal 2019 është gjithsej EUR 7,473,049, ndërsa shpenzimi i buxhetit është 93%. Teprica e buxhetit të pa shpenzuar është EUR 497,151.

Teprica e buxhetit të pashpenzuar kryesisht i dedikohet linjave të mëposhtme:

1. Shpenzimet për informim publik.
2. Shërbime kontraktuese tjera
3. Shërbime te ndryshme intelektuale / këshillëdhënëse si dhe Shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës.
4. Derivate dhe lëndë djegëse.
5. Mirëmbajtja e ndërtesave, mobileve dhe pajisjeve.
6. Aktivitete vështrore kadastrale.
7. Sigurimi dhe mbrojtja e aseteve të NSH-ve.
8. Shpenzimi i buxhetit është i bazuar në buxhetin përfundimtar deri me 31 Dhjetor 2019.

2) Përmbledhje për të hyrat dhe kategoritë e veçanta të shpenzimeve:

(Ju lutem paraqitni shkurtimisht ndryshimet kryesore për sa i përket vlerave të parashikuara dhe atyre aktuale për secilën kategori Të mos kalohet hapësira e ofruar më poshtë)

a) Të hyrat:

Buxheti përfundimtar i AKP-së (pas kursimeve buxhetore nga Qeveria) për vitin fiskal 2019 është gjithsej EUR 7,473,049 dhe është financuar nga 2 (dy) burime:

1. Të Hyrat e Dedikuara (pjesërisht pagat e AKP-së), shuma EUR 2,000,000.
2. Fondi i Përgjithshëm Qeveritar (shpenzimet operative), shuma EUR 5,473,049.

Përgjatë vitit 2019, AKP gjatë implementimit të buxhetit ka identifikuar kursime brenda programeve buxhetore për të cilat është njoftuar Ministria e Financave dhe njëkohësisht është kërkuar që mjetet e kursyera të reduktohen nga buxheti i AKP-së.

Gjithsej shuma e kursimeve të aprovuara sipas Vendimeve të Qeverisë është EUR 803,000.00.

1. Riorganizimi dhe administrimi i Nsh-ve, kursimi EUR 350,000

(Vendimi i Qeverisë 02/113, i datës 05.11.2019)

2. Auditimi (23100), kursimi EUR 53,000

(Vendimi i Qeverisë 02/113, i datës 05.11.2019)

3. Administrata Qendrore, shuma e kursimit EUR 400,000, për marrëveshjen e mirëkuptimit mes MAP dhe AKP, lidhur me renovimin objektin të rilindjes për zyrat e AKP-së.

(Vendimi i Qeverisë 03/115, i datës 17.12.2019)

b) Pagat dhe mëditjet:

(Ju lutem të bashkëngjitet organogrami i organizatës suaj si aneks i këtij raporti financiar dhe plotësoni tabelën shtesë lidhur me strukturën e pagesës në pikën 4 g) të këtij raporti.)

Numri i punëtorëve të aprovuar sipas Ligjit të buxhetit për vitin 2019 është gjithsej 258 zyrtarë, ndërsa numri aktual i punëtorëve në fund të periudhës 2019 ka qenë 247 zyrtarë.

Pagat dhe mëditjet e zyrtareve të AKP-së sipas listës së pagave procedohen përmes Divizionit të Pagave në kuadër të Departamentit të Thesarit të Ministrisë së Financave. AKP dërgon listat e punëtorëve (stafit të saj) për periudhat përkatëse në këtë Divizion dhe nga i cili procedohen pagesat në llogaritë përkatëse të punëtorëve të AKP-së. Pagesat për kontributin e punëdhënësit dhe tatimin në burim realizohen direkt në Administratën Tatimore të Kosovës.

Pagesat për kompensimin e Anëtareve të Bordit të AKP-së, Tatimet dhe Kontributet e këtyre pagesave nga fillimi i vitit 2019 janë realizuar nga kodi ekonomik punëtorët me kontratë jo në listën e pagave (11400), duke përfshirë këtu edhe pagesën për një nëpunës të AKP-së që është pensionuar gjatë vitit 2019.

Realizimi i buxhetit në këtë kategori është gjithsej 97%.

C) Mallra dhe Shërbime:

Buxheti i aprovuar fillestar nga Granti Qeveritar (GQ) për kategorinë “Mallra dhe Shërbime” ka qenë EUR 2,714,000. Fondet e aprovuara në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime kanë qenë të destinuara për:

- Ofrimin sa më të mirë të shërbimeve teknike dhe logjistike të duhura dhe me kohë në mënyrë që të arrihen objektivat e parapara të Agjencisë sipas Ligjit.
- Mbulimin e shpenzimeve të procesit të privatizimit dhe Likuidimit.
- Për të mbështetur në aspektin ligjor procesin e privatizimit dhe likuidimit.
- Për mbulimin e shpenzimeve për ofrues të shërbimeve.
- Për të mbështetur aktivitetet pas definimit të statusit përfundimtar të Trepçës.

Ndryshimet buxhetore në këtë kategori janë rrjedhojë e kursimeve buxhetore të aprovuara nga Qeveria në shumë prej EUR 803,000.

Buxheti përfundimtar më 31 dhjetor 2019 për kategorinë mallra dhe shërbime është EUR 1,911,000.

Realizimi i buxhetit në këtë kategori është gjithsej 85%.

d) Shpenzime komunale:

Për periudhën raportuese, buxheti i aprovuar për shërbime komunale është EUR 98,000.00, dhe është financuar nga Granti Qeveritar (GQ). Pagesat e shërbimeve publike përfshijnë të gjitha pagesat e bëra për zyrën Qendrore dhe zyrat regjionale të AKP-së.

Si arsye me e theksuar e mos shpenzimit të buxhetit sipas planifikimit ka qenë:

Rryma – Mjetet nuk janë shpenzuar në tërësi për arsye të ndryshimit të tarifave nga ana e Rregullatorit për energji ku tarifat janë të njëjta për të gjithë konsumatorët që do të thotë se nuk ka prag, dhe si konsumator të mëdhenjtë nuk kemi pasur ngarkesa shtesë.

Realizimi përfundimtar i buxhetit në këtë kategori është gjithsej 65%.

e) Investimet kapitale:

Për periudhën raportuese, buxheti i aprovuar për shpenzime kapitale është EUR 30,000.00, dhe është financuar nga Granti Qeveritar (GQ).

Mjetet kanë qenë të destinuara për projektin “blerja e pajisjeve brenda shpenzimeve kapitale (Pajisje të Teknologjisë Informative)”.

Projekti është realizuar në vlerë prej EUR 22,630. Mbetja e buxhetit prej EUR 7,370.00 është rezultat i pranimi të ofertave më të ulëta se sa planifikimi fillestar.

Realizimi përfundimtar i buxhetit në këtë kategori është gjithsej 75%.

f) Subvencionet dhe Transferet:

Për periudhën raportuese, buxheti i aprovuar për subvencione dhe transfere është EUR 40,000.00, dhe është financuar nga Granti Qeveritar (GQ).

Mjetet procedohen në formë të Subvencione për entitetet publike dhe janë të dedikuara për të mbështetur funksionin e Menaxhimit të Ndërmarrjeve Shoqërore që janë në Administrim Direkt të AKP-së me qëllim të ruajtjes dhe rritjes së vlerës së këtyre Ndërmarrjeve para privatizimit.

Mjetet nga Subvencionet shfrytëzohen për pagesën e menaxhmentit dhe drejtorëve të bordeve menaxhuese të Ndërmarrjeve në Administrim Direkt, të cilat nuk kanë mundësi për ti bërë pagesat nga mjetet që realizojnë ndërmarrjet.

Realizimi përfundimtar i buxhetit në këtë kategori është gjithsej 100%.

3) Përmbledhje:

(Ju lutem paraqitni shkurtimisht vërejtjet përfundimtare lidhur me buxhetin e institucionit tuaj apo pikëpamjet për zhvillimin në të ardhmen)

Realizimi përfundimtar i buxhetit të vitit 2019 është gjithsej 93%.

Arsyet lidhur me mos shpenzimin e buxhetit sipas planifikimit janë të shpalosura në pasqyrat financiare të shënimit shpjeguese , faqe 15.

Agjencia sa i përket buxhetit të vitit 2019, të aprovuar fillestar dhe atij përfundimtar nuk ka pasur vërejtje.

Kërkesa buxhetore për vitin 2020, e dërguar në Ministrinë e Financave për aprovim është gjithsej EUR 8,851,850 dhe në mungesë të mjeteve nga tarifa e të Hyrave të Dedikuara është kërkuar të financohet vetëm nga Granti Qeveritar.

4. PJESA TABELARE E RAPORTIT FINANCIAR SIPAS FORMATIT TË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCE TË KUVENTIT TË KOSOVËS (SHTOJCË);

Agjencia Kosovare e Privatizimit

PJESA TABELARE E RAPORTIT FINANCIAR SIPAS FORMATIT TË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCE

4) TABELAT

a) Të hyrat:

Kodi ekonomik	Emri i kategorisë ekonomike	Të hyrat e planifikuara/ parashikuara për vitin 2019	Të hyrat vetanake të bartura nga viti 2018	Të hyrat aktuale në vitin 2019
1	2	3	4	5
11000	Pagat dhe meditet	5,394,049	-	5,394,049
13000	Mallrat dhe Shërbimet	2,714,000	-	1,911,000
13200	Shërbimet publike	98,000	-	98,000
21000	Transferet dhe Subvencionet	40,000	-	40,000
1	13620	Jonit DPH	N/A	N/A	12	Shpenzime te perfaqesimit per AKPh muajin Dhjetor 2019	383.50	Fatura per pagese eshte pranuar ne 13 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ 28	Janar
2	13000	O4Online	9 Janar 2020	01/20.		Sherbime marketingu per SHAL 53	200.00	Fatura ende nuk ka ardhur per kete sherbim	Privatizimi	P5	Janar
3	13470	Ab Associates	8 Janar 2020	01-01-20		Pajse per zerim dhe perkthim simultan	620.00	Fatura per pagese eshte pranuar ne 8 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ 13	Janar
4	13230	Ambienti	31 Dhjetor 2019	196778		Sherbimet e mbeturinave per ZR Peje per muajin Dhjetor 2019	16.70	Faturat ende nuk kane ardhur per kete sherbim	Administrata Qendrore	AQ 4	Janar
5	13000	Arbresh.info	N/A	N/A		Sherbime marketingu per SHAL50	850.00	Fatura ende nuk ka ardhur per kete sherbim	Privatizimi	P5	Janar
6	14040	ART HOUSE	3 Janar 2020	AH0001		Sherbimet e shfrytezimit te fotokopjeve	1,157.17	Fatura per pages eshte pranuar me 15 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ 24	Janar
7	13440	Bajram Morina	26 Dhjetor 2019	Shitja 53		Kompenzimi per komisionin e hapjes se Ofrtave shitja 53	100.00	Fatura per pagese eshte pranuar ne fund te periudhes Dhjetor 2019	Administrata Qendrore	AQ 11	Janar
8	13000	Blic media	27 Dhjetor 2019	972		Sherbime marketingu per SHAL 53	500.00	Fatura eshte pranuar pas mbylljes se vitit fiskal	Privatizimi	P5	Janar
9	13000	Bota Sot	06 Janar 2020	09/2020		Publikimi SHA53 dt. 24.12.2019	120.00	Fatura ka ardhur pas mbylljes s; vitit fiskal 2020 eshte pranuar me dt.14.01.2020	Privatizimi	P5	Janar
10	13460	BSPK	N/A	NA		Kompenzimi shpenzimeve per BSPK-së për përgatitjen e listave të punëtorëve të NSH-ve Dhjetor 2019	4,158.92	Ende nuk kemi pranuar kërkesën për pagesë (faturën) për këtë kompenzim.	Likuidimi	L2	Janar
11	13230	EcoHigjiena	13 Janar 2020	2313764		Sherbimet e mbeturinave per ZR ne Gjilan per muajin Dhjetor 2019	12.08	Fatura per pagese eshte pranuar ne 13 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ 4	Janar
12	14050	Elekrika	13 Janar 2020	005-20		Servisi dhe mirembajtja e Gjeneratorve Dhjetor 2019	1,261.00	Fatura per pagese eshte pranuar ne 13 Janar 2021	Administrata Qendrore	AQ 23	Janar
13	14050	Elekrika	4 Nentor 2019	278-19		Servisi dhe mirembajtja e Gjeneratorve Nentor	77.50	Fatura eshte paguar vetem shumja prej 1,700 EUR, ndersa pjesa prej 77.50 nuk ka pasur zotim	Administrata Qendrore	AQ 23	Janar
14	13000	Epoka e Re	26 Dhjetor 2019	1103/19		Publikimi SHA53 dt. 24.12.2019	130.00	Fatura ka ardhur pas mbylljes s; vitit fiskal 2019	Privatizimi	P5	Janar
15	13000	Fakteplus	30 Dhjetor 2019	155-2019		Sherbime marketingu per SHAL 53	300.00	Fatura eshte pranuar pas mbylljes se vitit fiskal	Privatizimi	P5	Janar
16	13000	First Media Group - Kosova Sot	N/A	N/A		Shpallja SHA45 (4*1/1)	680.00	Fatura ende nuk ka ardhur per kete sherbim	Privatizimi	P5	Janar
17	13000	Gazetaexpress	26 Dhjetor 2019	794		Sherbime marketingu per SHAL 53	1,500.00	Fatura ka ardhur pas mbylljes s; vitit fiskal 2020 eshte pranuar ne dt.15.01.2020	Privatizimi	P5	Janar
18	13000	GazetaMetro	16-Jan-20	43810		Sherbime marketingu per SHAL 53	625.00	Fatura ende nuk ka ardhur per kete sherbim	Privatizimi	P5	Janar
19	13460	Global Consulting GC- DA	09 Janar 2020	5329		Angazhimi i kompanis se jashtme per perkthime zyrtare te AKP-s	784.10	Fatura per pagese eshte pranuar ne 13 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ 14	Janar
20	14010	Guri SHPK	NA	NA		Laria e veturave te AKPs Dhjetor 2019	50.00	Faturat ende nuk kane ardhur per kete sherbim	Administrata Qendrore	AQ 22	Janar

Gjendja e Faturave të paguara (shënimi shpjegues nr. 17)
Për periudhën e përfunduar deri më 31. Dhjetor 2019

Nr. rëndor	Furnitori		Data e fatures	Numri i fatures	Qelimi	Shuma	Arsyeja e mospages gjate periudhës raportuese	Vija Buxhetore	Nr. Nenvija buxhetore	Pritet te paguhet ne muajin
	Kodi ekonomik	Nderrmarija								
21	13220	Hidrodrini	31.Dhjetor 2019	PE 191236946, PE191236942	Sherbimet e ujit per ZR Peje per muajin Dhjetor 2019	13.00	Fatura per pagese eshte pranuar me 20 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ 3	Janar
22	13220	Hidromorava	31.Dhjetor 2019	1858539	Sherbimet e ujit per ZR Gjilan per muajin Dhjetor 2019	4.69	Faturat ende nuk kane ardhur per kete shterbim	Administrata Qendrore	AQ 3	Janar
23	13000	IMK	15 Janar 2020	43831	Perpunimi i TV reklamave dhe Emetime i Radio reklamave ne 5 radio lokale dhe 3 nacionale	1,050.00	fatura ka ardhur me dt.14.01.2019 mirepo eshte nje gabim teknik i cili ka mbetur te permiresohet dhe te sillket serish	Privatizimi	P5	Janar
24	13000	Indeksonline	27.Dhjetor 2019	23-12-219	Sherbime marketingu per SHAL 53	660.00	Fatura eshte pranuar pas mbylljes se vitit fiskal	Privatizimi	P5	Janar
25	14040	Inovatvi	5 Janar 2020	20010202	Mirenbaljia e softëerit per njesine e Zyres se protokollit Dhjetor 2019	194.70	Fatura per pagese eshte pranuar me 13 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ 24	Janar
26	14040	Inovatvi	5 Janar 2020	20010201	Mirenbaljia e softëerit per Burimeve Njerzore Dhjetor 2019	194.70	Fatura per pagese eshte pranuar me 13 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ 24	Janar
27	13000	Insajderi	N/A	N/A	Sherbime marketingu per SHAL 53	800.00	Fatura ende nuk ka ardhur per kete shterbim	Privatizimi	P5	Janar
28	13620	Kafe Vending Illy	10 Janar 2020	201-81-1164	Shpenzime te perfaqesimit Zyrja Bordit te Drejtorve	159.00	Fatura per pagese eshte pranuar me 10 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ 28	Janar
29	13620	Kafe Vending Illy	8 Janar 2020	201-81-1158 ,1157	Shpenzime te perfaqesimit Zyrja e Drejtorit Menaxhues	174.00	Fatura per pagese eshte pranuar me 8 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ 28	Janar
30	13000	Kaliko.com (Internws Kosova)	31.Dhjetor 2019	IK2019-217	Sherbime marketingu per SHAL 53	500.00	Fatura ka ardhur pas mbylljes s; vitit fiskal 2020 eshte pranuar me dt.14.01.2020	Privatizimi	P5	Janar
31	13210	KESCO Mitrovica	26 Dhjetor 2019	8991285	Sherbimet e rymes per muajin Dhjetor 2019	383.31	Fatura per pagese eshte pranuar ne fund te periudhes Dhjetor 2019	Administrata Qendrore	AQ2	Janar
32	13210	KESCO Peja	30.Dhjetor 2019	11342950	Sherbimet e rymes per muajin Dhjetor 2019	103.85	Fatura per pagese eshte pranuar ne fund te periudhes Dhjetor 2019	Administrata Qendrore	AQ2	Janar
33	13210	KESCO Peja	30.Dhjetor 2019	11342952	Sherbimet e rymes per muajin Dhjetor 2019	4.54	Fatura per pagese eshte pranuar ne fund te periudhes Dhjetor 2019	Administrata Qendrore	AQ2	Janar
34	13210	KESCO Peja	30.Dhjetor 2019	11342949	Sherbimet e rymes per muajin Dhjetor 2019	209.62	Fatura per pagese eshte pranuar ne fund te periudhes Dhjetor 2019	Administrata Qendrore	AQ2	Janar
35	13210	KESCO Prishtine	24.Dhjetor 2019	25863111	Shpenzimet e rymes Dhjetor 2019 Zyra Qendrore e AKP-s	2,993.27	Fatura per pagese eshte pranuar me 14 Janar 2010	Administrata Qendrore	AQ 2	Janar
36	13210	KESCO Gjilan	1 Janar 2020	10453849	Sherbimet e rymes per muajin Dhjetor 2019	524.22	Fatura per pagese eshte pranuar ne 1 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ2	Janar
37	13210	KESCO Prizren	23.Dhjetor 2019	14987199	Sherbimet e rymes per muajin Dhjetor 2019	104.21	Fatura per pagese eshte pranuar ne fund te periudhes Dhjetor 2019	Administrata Qendrore	AQ2	Janar
38	13210	KESCO Prizren	23.Dhjetor 2019	14983184	Sherbimet e rymes per muajin Dhjetor 2019	31.48	Fatura per pagese eshte pranuar ne fund te periudhes Dhjetor 2019	Administrata Qendrore	AQ2	Janar
39	13210	KESCO Prizren	23.Dhjetor 2019	14983185	Sherbimet e rymes per muajin Dhjetor 2019	7.94	Fatura per pagese eshte pranuar ne fund te periudhes Dhjetor 2019	Administrata Qendrore	AQ2	Janar
40	13000	Klan Kosova	31.Dhjetor 2019	123119001-1	Emetimi i TV Reklamave deri me 24.12.2019	840.00	Fatura ka ardhur pas mbylljes s; vitit fiskal 2020 eshte pranuar me dt.14.01.2020	Privatizimi	P5	Janar
41	13000	Koha Ditore	30.Dhjetor 2019	1367	Publikimi SHAL53 dt.24.12.2019	115.00	Fatura ka ardhur pas mbylljes s; vitit fiskal 2020 eshte pranuar me dt.14.01.2020	Privatizimi	P5	Janar

Gjendja e Faturave të pagapara (shënimi shpjegues nr. 17)
Për periudhën e përfunduar deri më 31. Dhjetor 2019

Nr. rëndor	Kodi ekonomik	Furnitori		Data e fatures	Numri i fatures	Qelimi	Shuma	Arsyeja e mospagesës gjatë periudhës raportuese	Vija Buxhetore	Nr. Nenvija buxhetore	Pritet të paguhet në muajin
		Nderrmarrja									
42	13000	Kosova Press		9 Janar 2020	20-SHY04-001-9	Transmetimi Direkt SHAS53 (26.12.2019)	350.00	Fatura ende nuk ka ardhur për këtë shërbim	Privatizimi	P5	Janar
43	13000	Kosovalive360 / Socialive		30 Dhjetor 2019	2019/66	Sherbime marketingu per SHAL 53	150.00	Fatura ende nuk ka ardhur per kete shërbim	Privatizimi	P5	Janar
44	13230	KRM Ekoregjioni		31 Dhjetor 2019	PZ 19123785	Sherbimet e mbeturinave per ZR Prizren per muajin Dhjetor 2019	21.46	Fatura per pagese eshte pranuar ne fund te periudhes Dhjetor 2019	Administrata Qendrore	AQ4	Janar
45	13220	KRU Hidroregjioni Jugor		06 Janar 2020	4077969	Sherbimet e kanalizimit dhe ujit per ZR Prizren per muajin Dhjetor 2019	130.34	Fatura per pagese eshte pranuar ne 6 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ3	Janar
46	13000	KTV		7 Janar 2020	43845	Emetimi TV Reklames deri me 24.12.2019	756.00	Fatura ka ardhur pas mbylljes s; vitit fiskal 2020 eshte pranuar me dt.14.01.2020	Privatizimi	P5	Janar
47	13220	KUR Mitrovica		1 Janar 2020	F1203679	Sherbimet e kanalizimit dhe ujit per ZR Mitrovices per muajin Dhjetor 2019	16.68	Fatura per pagese eshte pranuar ne 1 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ3	Janar
48	13220	KUR Prishtina -ZR Regjionale		13 Dhjetor 2019	B87570839039986T	Sherbimet e kanalizimit dhe ujit per ZR Prishtines per muajin Dhjetor 2019	30.67	Fatura per pagese eshte pranuar ne fund te periudhes Dhjetor 2019	Administrata Qendrore	AQ3	Janar
49	13000	Lajmi.net		30 Dhjetor 2019	800	Sherbime marketingu per SHAL 53	700.00	Fatura eshte pranuar pas mbylljes se vitit fiskal	Privatizimi	P5	Janar
50	13460	Mahr Durguti		N/A	NA	Ofrues te shërbimeve për Sekretarin Ekzekutiv të Bordit të Drejtoreve	535.45	Nuk kemi pranuar kërkesën për pagesë (faturën) për këtë shërbim, meqense nuk është mbyllë periudha ujëmuajore e faturimit.	Likuidimi	L1	Janar
51	13460	Mercom Company		6 Janar 2020	MR 20-01-020	Marrja me qira e veturave per AKP-n Dhjetor 2019	1,493.88	Fatura per pagese eshte pranuar ne 13 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ26	Janar
52	14310	Mezeria Adal shpk		N/A	NA	Shpenzimet te drekes zyrtare	79.70	Faturat ende nuk kane ardhur per kete shërbim	Administrata Qendrore	AQ 28	Janar
53	14150	Palma SH.P.K.		N/A	NA	Qira për shfrytëzimin e hapësirave për arkivë të Zyrës Regjionale të AKP-së në Gllan	3,000.00	Nuk kane pasur kontrate për kryerjen e shërbimeve, si dhe kërkesa për pagesë ka ardhur në Janar 2020	Likuidimi	L4	Janar
54	13230	Pastrimi		31 Dhjetor 2019	971702	Sherbimet e mbeturinave per ZQ Prishtine per muajin Dhjetor 2020	210.39	Fatura per pages eshte pranuar me 21 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ 4	Janar
55	13000	Periskopi		27 Dhjetor 2019	181/19	Sherbime marketingu per SHAL53	500.00	Fatura eshte pranuar pas mbylljes se vitit fiskal	Privatizimi	P5	Janar
56	13780	Petrol Company		31 Dhjetor 2019	4324-19	Shpenzimet e derivateve per vetura	2,956.49	Fatura per pages eshte pranu ar me 14 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ 18	Janar
57	13720	Petrol Company		31 Dhjetor 2019	4143-19	Shpenzimet e derivateve per Ngrohja Qendrore	7,454.57	Fatura per pages eshte pranuar me 13 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ 18	Janar
58	13720	Petrol Company		31 Dhjetor 2019	4144-19	Shpenzimet e derivateve per Ngrohja Qendrore	3,217.80	Fatura per pages eshte pranuar me 13 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ 18	Janar
59	13460	Policia e Kosoves		15 Janar 2020	004770	Sigurimi fizik per hapsirat e AKP-s Dhjetor 2019	19,928.00	Fatura per pagese eshte pranuar ne 21 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ 13	Janar
60	13330	Posta e Kosoves		N/A	NA	Sherbime Postare Dhjetor 2019	200.00	Faturat ende nuk kane ardhur per kete shërbim	Administrata Qendrore	AQ 9	Janar
61	13000	Radio Kosova e Lire		13 Janar 2020	29/20	Sherbime marketingu per SHAL49	400.00	Fatura eshte pranuar pas mbylljes se vitit fiskal	Privatizimi	P5	Janar
62	13000	Reporter.net		N/A	N/A	Sherbime marketingu per SHAL50 & 52	700.00	Faturat ende nuk kane ardhur per kete shërbim	Privatizimi	P5	Janar

Gjendja e Faturave të pagapara (shënimi shpjegues nr. 17)
Për periudhën e përfunduar deri më 31. Dhjetor 2019

Nr. rendor	Kodi ekonomik	Furnitori		Data e fatures	Numri i fatures	Qelimi	Shuma	Arsyeja e mospages gjate periudhës raportuese	Vija Buxhetore	Nr. Nenvija buxhetore	Pritet te paguhet ne muajin
		Ndermarria									
63	13610	Rilindja		31 Dhjetor 2019	3217	Furnizimi me shypin ditor Dhjetor 2019	45.60	Fatura per pages eshte pranuar me 13 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ 17	Janar
64	13000	RokumTV		N/A	N/A	Sherbime marketingu per SHAL 53	250.00	Fatura ende nuk ka ardhur per kete sherbim	Privatizimi	P5	Janar
65	13000	RTK		7 Janar 2020	1005911	Emetim ITV Reklames deri me 24.12.2019	588.00	Fatura ka ardhur pas mbylljes s; vitit fiskal 2020 eshte pranuar me dt.14.01.2020	Privatizimi	P5	Janar
66	13000	RTV21		26 Dhjetor 2019	R19-0057	Emetim ITV Reklames deri me 24.12.2019	840.00	Fatura ka ardhur pas mbylljes se vitit fiskal 2021	Privatizimi	P5	Janar
67	14310	Seasons by otium		23 Dhjetor 2019	19-SHV03-001-4212	Dreke zyrtare	243.40	Nuk ka pasur Zotim te mjeteteve	Administrata Qendrore	AQ 28	Janar
68	13000	T7		26 Dhjetor 2019	461	Emetim ITV Reklames deri me 24.12.2019	840.00	Fatura ka ardhur pas mbylljes s; vitit fiskal 2020 eshte pranuar me dt.14.01.2020	Privatizimi	P5	Janar
69	13000	Telegrafi		N/A	N/A	Sherbime marketingu per SHAL51, 52 & 53	2,400.00	Faturat ende nuk kane ardhur per kete sherbim	Privatizimi	P5	Janar
70	13000	TV Dukagjini		30 Dhjetor 2019	TV-301	Emetim ITV Reklames deri me 24.12.2019	840.00	Fatura ka ardhur pas mbylljes s; vitit fiskal 2020 eshte pranuar me dt.14.01.2020	Privatizimi	P5	Janar
71	13310	VALA		6 Janar 2020	190215087924-1980	Sherbimet e internetit Dhjetor 2019	1,272.50	Fatura per pages eshte pranuar me 14 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ 7	Janar
72	13320	VALA		6 Janar 2020	090201029031-1981	Shpenzimet e telefonis mobile te AKP-s	3,920.68	Fatura per pages eshte pranuar me 14 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ 8	Janar
73	13250	VALA fikse		6 Janar 2020	550020236-1980	Shpenzimet e telefonis fikse AKP	593.53	Fatura per pages eshte pranuar me 14 Janar 2020	Administrata Qendrore	AQ 5	Janar
74	13000	Veriu Info		27 Dhjetor 2019	060/2019	Sherbime marketingu per SHAL 53	350.00	Fatura eshte pranuar pas mbylljes se vitit fiskal	Privatizimi	P5	Janar
75	13460	Visar Tahiri		N/A	NA	Ofruet te sherbimeve per Departamentin Ligjor	286.36	Ende nuk kane pranuar kërkesën për pagesë (faturën) për këtë kompenzim.	Likuidimi	L1	Janar
76	13000	Zeri		30 Dhjetor 2019	19-210-001-1226	Publikimi SHA53 dt. 24.12.2019	130.00	Fatura ka ardhur pas mbylljes s; vitit fiskal 2020 eshte pranuar me dt.14.01.2020	Privatizimi	P5	Janar
77	14230	Dan Graf		9 Nentor 2019	82/19	Shpenzime per informimin publik	1,634.00	Vonesë për shkak të shqyrtimit të dokumentacionit përcjellës	Likuidimi	L5	Janar
78	13210	KESCO Peja		25 Shtator 2019	10573880	Sherbimet e ryms per muajin Janar 2019	110.18	Fatura per pagese eshte pranuar ne fund te periudhes Dhjetor 2019	Administrata Qendrore	AQ2	Janar
79	13000	New-Co Grand Hotel		10 Tetor 2019	0286-19	Takimi me gazetarë	386.00	Nuk ka pasur Zotim te mjeteteve	Administrata Qendrore	AQ 21	Janar
80	13310	Vala		4 Shtator 2019	190215087924/1952	Sherbimet e internetit Gusht 2019	2,024.97	Nuk ka pasur Zotim te mjeteteve	Administrata Qendrore	AQ 7	Janar
81	13310	Vala		4 Dhjetor 2019	190215087924/1977	Sherbimet e internetit Nentor 2019	1,272.50	Nuk ka pasur Zotim te mjeteteve	Administrata Qendrore	AQ 7	Janar
82	13000	Periskopi		25 Nentor 2019	167/19	Publikime SHA 52	150.00	Fatura e ka shume totale 500 EUR, por zotimi i mjeteve ka qen vetem 350 EUR dmth nga kjo fature shuma e mbetur obligim eshte 150 EUR	Privatizimi	P5	Janar



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

PASQYRAT FINANCIARE
FONDET NË MIRËBESIM
PËR PERIUDHËN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2019

TABELA E PËRMBAJTJES

PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE TË FONDEVE NË MIRËBESIM.....	7
GJENDJA E LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM	8
HYRJE NË SHËNIMET SHPJEGUESE	11
TË HYRAT DHE PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE	13
2. TË HYRAT NGA SHITJA	13
3. TË HYRAT E REALIZUARA NGA QIRATË.....	16
4. INTERESI I FITUAR	19
5. TË HYRAT NGA TARIFA DHE KONFISKIMET E BID DEPOZITAVE NË TENDERËT E SHITJES	20
6. BID DEPOZITAT PËR PJESËMARRJE NË TENDER	20
7. TË HYRA TJERA	21
8. KAPITALI THEMELTAR I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	22
SHPENZIMET/SHPËRNDARJA	23
9. 20% I PUNËTORËVE TË TRANSFERUARA NË BSPK.....	23
10. OFRUESI I SHËRBIEMEVE PROFESIONALE (OSHP)	24
11. MALLRA DHE SHËRBIME	26
12. SHPENZIME KOMUNALE	30
13. TATIMET	31
14. VENDIMET E GJYKATAVE/PËRMBARUESVE	32
15. TRANSFERIMI I MJETEVE 5% PËR MBULIMIN E AKTIVITETEVE TË AKP-së.....	33

16. SHPENZIME TJERA	34
17. PAGESAT NDAJ KREDITORËVE TË NSH-ve NË LIKUIDIM... ..	35
18. FONDET TRANSFERUAR BUXHETIT TË KOSOVËS.....	37
LLOGARITË E ARKËTUESHME	38
19. NDËSHKIMET NDAJ NSH-ve ME SPIN-OFF SPECIAL	39
20. LLOGARITË E ARKËTUESHME NGA SHITJA E ASETEVE	40
21. LLOGARITË E ARKËTUESHME NGA SHPRONËSIMI I ASETEVE	42
22. LLOGARITË E ARKËTUESHME PËR QIRATË DHE TË HYRAT TË TJERA	43
LLOGARITË E PAGUESHME DHE DETYRIMET KONTIGJENTE	46
23. LLOGARITË E PAGUESHME	46
24. DETYRIMET KONTIGJENTE	49
PAGESAT E REALIZUARA NGA TARIFA ADMINISTRATIVE.....	53
TRANSFERET BRENDA LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM NË BQK DHE GJENDJA NË BANKAT KOMERCIALE	54
TRANSFERET BRENDA LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM.....	54
LLOGARITË BANKARE TË TJERA NË BANKAT KOMERCIALE	54
GJENDJA E FONDEVE TË LIKUIDIMIT TË NSH-ve	55
LLOJET E LLOGARIVE BANKARE	58
PLANI I VEPRIMIT PËR ADRESIMIN E REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM.....	60

PASQYRAT FINANCIARE 2019

- PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE TË FONDEVE NË MIRËBESIM
- GJENDJA E LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2019

Përshkrimi

Shënimi shpjegues	31 dhjetor 2018	1 janar 31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2019
----------------------	--------------------	-------------------------------	--------------------

PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE

Të hyrat nga shitja e aseteve	2	715,306,649	41,345,259	756,651,908
Të hyrat nga qiraja	3	38,832,654	5,462,436	44,295,090
Interesi i fituar	4	34,844,700	-	34,844,700
Të hyrat nga tarifa dhe konfiskimet e Bid Depozitave në tenderët e shitjes	5	8,319,864	464,400	8,784,264
Bid depozitat për Pjesëmarrje në Tender	6	843,200	1,903,289	2,746,489
Të hyra tjera	7	7,263,974	88,124	7,352,098
Kapitali themeltar i Agjencisë Kosovare të Privatizimit	8	1,013,200	-	1,013,200
Gjithsej pranimet		806,424,241	49,263,508	855,687,749

PAGESAT/SHPËRNDARJA NGA LLOGARITË

20% i punëtorëve transferuar në BSPK	9	126,227,784	7,122,367	133,350,151
Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoritetet e Likuidimit)	10	16,000,930	136,309	16,137,239
Mallra dhe shërbime	11	16,323,064	1,562,728	17,885,792
Shpenzimet komunale	12	2,406,373	231,239	2,637,612
Tatimet	13	6,134,291	932,654	7,066,945
Vendimet e gjykatave/përmbauesve (depozita dhe taksa)	14	2,515,922	8,605	2,524,527
Transferimi i mjeteve 5% për mbulimin e aktiviteteve të AKP-së	15	44,741,706	1,036,241	45,777,947
Të tjera	16	787,190	18,563	805,753
Pagesat ndaj kreditorëve të NSH-së	17	26,454,012	1,168,818	27,622,830
Fondet transferuar Buxhetit të Kosovës	18	176,717,033	150,001,970	326,719,003
Gjithsej pagesat/shpërndarja		418,308,305	162,219,494	580,527,799

BILANCI I PRANIMEVE DHE PAGESAVE	388,115,937	(112,955,986)	275,159,950
---	--------------------	----------------------	--------------------

GJENDJA E LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2019

Llojet e llogarive bankare	2003 deri		2003 deri		2003 deri	
	31 DHJETOR	2019	31 DHJETOR	2018	31 DHJETOR	2017
Privatizim		6,901,421	8,664,975	8,986,889		
Likuidim		238,206,525	357,793,521	432,327,447		
Para të NSh-ve në mirëbesim		7,487,992	6,385,213	5,325,079		
Komercializim		-	-	-		
Llogaritë e parave në mirëbesim për punëtorët		12,615,698	13,208,013	15,400,400		
Depozita nga tenderët e privatizimit		-	-	-		
Tarifa për Dorëzimin e Tenderit në Privatizim		-	-	-		
Depozita nga tenderët e shitjeve me Likuidim		2,752,875	850,336	2,039,421		
Tarifa e dorëzimit të ofertave në likuidim		42,100	14,083	14,989		
Depozitat e Komisionit të Rishikimit të Likuidimit		25	25	25		
Kapitali themeltar i AKP-së		1,048,861	1,048,861	1,109,549		
Fondi rezervë i AKP-së		40,619	-	-		
Donator		8,463	8,463	8,463		
Tarifa administrative e AKP-së		667,075	142,447	6,086,620		
Depozitat Kohor		-	-	-		
Të hyrat nga shpronësimet		5,388,296	-	-		
GJITHSEJ		275,159,950	388,115,937	471,298,882		

1 janar 31 dhjetor 2019	1 janar 31 dhjetor 2018	1 janar 31 dhjetor 2017
(1,763,554)	(321,914)	(695,907)
(119,586,996)	(74,533,925)	20,862,742
1,102,778	1,060,135	308,945
-	-	(3,667,287)
(592,315)	(2,192,388)	(5,721,598)
-	-	-
-	-	-
1,902,539	(1,189,086)	1,437,262
28,017	(906)	(50,111)
-	-	-
-	(60,688)	-
40,619	-	(1,000,000)
-	-	-
524,629	(5,944,173)	(1,136,517)
-	-	-
-	-	-
(112,955,986)	(83,182,945)	10,337,529

Llogaritë bankare të paraqitura më lartë janë llogari bankare që janë hapur në Bankën Qendrore të Kosovës dhe administrohen nga Agjencia Kosova e Privatizimit.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

PËR PASQYRAT FINANCIARE 2019

HYRJE NË SHËNIMET SHPJEGUESE

BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik. Në përputhje me SNKSP, këto pasqyra janë prezantuar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Gjithashtu, këto pasqyra financiare i përmbushin obligimet raportuese që dalin nga "Rregullorja e Kornizës Raportuese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim" e aprovuar nga Bordi i Drejtorëve më 23 Shkurt 2011.

Llogaritë e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme dhe detyrimet kontingjente paraqiten vetëm si shpalosje në pasqyrat financiare të Fondeve në Mirëbesim.

Të gjitha të dhënat financiare të pranimeve dhe pagesave që janë paraqitur në këto shënime janë nga llogaritë bankare të NSh-ve që Agjencia menaxhon dhe administron në Bankën Qendrore të Kosovës. Të dhënat nuk paraqesin rezultate të NSh-ve që kanë pasur apo kanë aktualisht menaxhmentin aktiv, të cilët kanë menaxhuar apo administruar me llogaritë bankare të NSh-ve më parë në bankat komerciale.

SUBJEKTI RAPORTUES

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji Nr. 03/L-067) që ka hyrë në fuqi me 1 korrik 2008 e ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-034 që ka hyrë në fuqi më 21 shtator 2011 dhe ndryshim/plotësimet të Ligjit nr. 04/L-115 të datës 7 shtator 2012, të Ligjit nr. 05/L-080 të datës 24 dhjetor 2015 dhe ligjit nr. 06/L-023 të datës 3 maj 2018.

Në pajtim me Ligjin mbi themelimin e AKP-së, aktiviteti i AKP-së është privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSh) nëpërmjet metodave të "spin off-it", qiradhënie, administrimi, ristrukturimi dhe likuidimi i Ndërmarrjeve Shoqërore.

Agjencia Kosovare e Privatizimit, menaxhon Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë dhe i mban këto Ndërmarrje në Mirëbesim. AKP është e ngarkuar me "ruajtjen dhe rritjen" e vlerës së NSh-ve dhe aseteve të tyre brenda dhe jashtë Kosovës.

Periudha raportuese për pasqyrat financiare është prej 1 janar deri më 31 dhjetor 2019. Në këto pasqyra financiare janë paraqitur edhe raportet që paraqesin të dhënat financiare nga data 1 korrik 2003 deri më 31 dhjetor 2019.

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve mban mbledhje të rregullta mujore në mënyrë që t'i kryej funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas Ligjit.

Bordi i Drejtorëve emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendor sipas nenit 8 të Ligjit nr. 06/L -023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080.

Kuvendi ka emëruar 6 anëtarët e rinj e Bordit më datën **31 maj 2018**, të cilët kanë mandat 4 vjeçar në përputhje me nenin 9 të Ligjit nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080.

Kryesuesi dhe një anëtar i Bordit të Drejtorëve të AKP-së është emëruar nga Kuvendi i Kosovës më datën 7 mars 2019.

Agjencia Kosovare e Privatizimit në baza vjetore i raporton Kuvendit të Republikës të Kosovës sipas formatit të raportimit për Agjencitë e Pavarura. Raporti vjetor paraqet të gjitha detajet e aktivitetëve dhe informatave financiare dhe jo financiare për vitin fiskal 2019.

RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE PËRMES LLOGARIVE TË AKP-SË

AKP-ja menaxhon dhe i kontrollon shpenzimet dhe të hyrat përmes llogarive në mirëbesim të hapura në Bankën Qendrore të Kosovës. AKP-ja bën transferin e pagesave pasi të jetë bërë autorizimi kolektiv i urdhër-transferëve bankare sipas Procedurave Bankare të AKP-së të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve.

VALUTA RAPORTUESE

Valuta raportuese është Euro (€). Të gjitha vlerat në pasqyrat financiare janë paraqitur në vlera aktuale e jo në mijëra ('000), përveç nëse është cekur ndryshe në raportin përkatës.


DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare të fondeve në mirëbesim janë autorizuar për lëshim më datën 30 Janar 2020 nga: Valon Tolaj, Drejtor Menaxhues dhe Adem Selishta, Drejtor i Financave dhe Buxhetit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

TË HYRAT DHE PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE

2. TË HYRAT NGA SHITJA

PËRSHKRIMI	2019 vs			
	VITI 2019	VITI 2018	VITI 2017	2018 2017
Shitja e aseteve	32,248,248	16,791,835	31,050,073	92% 4%
Pagesat e shpronësimeve	6,182,063	924,338	0.00	569% 0%
Shitjet me Negocim Direkt	2,907,634	412,945	0.00	604% 0%
E drejta në pronësi banesore	7,314	9,606	37,794	(24%) (81%)
GUJITHSEJ	41,345,259	18,138,724	31,087,867	128% 33%




Në tabelën në anën e majtë, paraqiten bilancet e hyrjeve/daljeve në llogaritë bankare të NSH’ve përkatëse për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2019.

- Shitjet e aseteve** – janë pagesat e pranuar gjatë viti fiskal lidhur me asetet e tenderuar gjatë valëve të privatizimit.
- Pagesat e shpronësimeve** - janë pagesat e pranuar për asetet që janë shpronësuar dhe atyre që janë në proces nga ana e Qeverisë së Kosovës.
- Shitjet e aseteve përmes metodës të negocimit direkt** - në përputhje me paragrafin 1.4 të nenit 18 të shtojcës të Ligjit bazik nr. 04/L-034 dhe rregullores për “Shqyrtimin e Aseteve me Karakter Specifik dhe Shitja e tyre me Negocim Direkt” AKP-ja ka filluar procesin e shitjes përmes kësaj metode. Këto rregulla përcaktojnë të drejtat dhe obligimet se si kategorizohen asetet si “asete me karakter specifik” dhe procedurat lidhur me aplikimin e atyre që kanë të drejtën për blerjen e aseteve me karakter specifik.

Nga pagesat e pranuar në vlerën prej EUR 2,907,634, vlera e kontratave të nënshkruara është EUR 2,822,018.62.

- Të hyra nga bartja e së drejtës banesore** janë pagesat nga bartja e të drejtës banesore të Ndërmarrjeve Shoqërore. Këto pagesa realizohen në përputhje me Ligjin nr. 04/L-061 për Shitjen e Banesave dhe Ligjin nr. 04/L-247 për plotësim ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-061.

2.1. SHITJET E ASETEVE



Raporti i vlerës të kontratave të nënshkruara në tre vitet e fundit dhe pagesave të realizuar ndër-vite për këto kontrata

KONTRATA TË NËNSHKRUARA	2019	2018	2017
Pranimet gjatë vitit 2015	-	-	162,251
Pranimet gjatë vitit 2016	-	-	78,048
Pranimet gjatë vitit 2017	57,000	4,076,902	26,612,531
Pranimet gjatë vitit 2018	1,261,900	15,149,501	-
Pranimet gjatë vitit 2019	28,845,965	-	-
GJITHSEJ	30,164,865	19,226,403	26,852,830

Në grafikonin në anën e majtë janë paraqitur të dhënat dhe krahasimet për tre vitet e fundit sa i përket pagesave të pranuar, vlera e të cilave janë nënshkruar kontratat brenda atij viti.

Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2019 është EUR 30,164,865.54 të gjithsej 222 aseteve të shitura. **Pagesat e pranuar** nga shitjet e bëra të aseteve për të cilat janë nënshkruar kontratat në vitin 2019 janë si më poshtë:

- 57,000 në vitin 2017;
- 1,261,900 në vitin 2018; dhe
- 28,845,965 në vitin 2019

Gjithsesi, në tabelën në anën e majtë janë prezantuar procesi i realizimit të shitjeve dhe pagesave për vitet 2019, 2018 dhe 2017. Lidhur me nënshkrimin e kontratave në vitin 2017, kemi të hyra (pagesa) të pranuar që i përkasin shitjeve që kanë ndodhur gjatë periudhës 2015 dhe 2016, këto shitje kanë pasur masë të përkohshme nga gjykata në atë periudhë.

Bordi i Drejtorëve të AKP-së e bënë aprovimin e çdo valë të shitjeve.

2.2. PAGESAT TË REALIZUARA NGA QEVERIA PËR SHPRONËSIMIN E ASETETEVE

Ndërmarrjet Shoqërore	PAGESA	Komente
NSh Auto Prishtina	179,996	Sipas marrëveshjes me Federatën e Futbollit të Kosovës është paguar shuma e 20% e vlerës totale të shpronësimit prej EUR 899,980. Pagesa është kryer dhe sipas marrëveshjes me pagesën e 20% janë përfunduar obligimet.
NSh Bujqësia Fushë-Kosovë	26,455	Sipas marrëveshjes në total shuma për pagesë është EUR 133.662.10 dhe e cila është 20% e vlerës totale të shpronësimit. Pagesa prej EUR 26,455 është e fundit, meqenëse shuma prej EUR 107,207 është paguar në vitin 2018. Shpronësimi ka të bëjë në lidhje me stadiumin në Komunën e Obiliqit.
NSh IMN Kosova	4,837,468	Sipas marrëveshjes me komunën e Prishtinës është paguar shuma e 20% e vlerës, shuma e rezervuar për pagesa ndaj kreditorëve dhe tarifa administrative. Gjithsesi duhet theksuar se ende nuk kemi një vendim final për shpronësimin nga Qeveria.
NSh Gërmia	880,973	Për pronën "Shtëpia e Mallrave", drunjtë pyjor dhe frutor si dhe tokat përkatëse që ndërlidhen me ndërtesën e NSH Germa. Sipas marrëveshjes, pagesa vetëm për 20% e punëtorëve nga vlera e shpronësuar është pranuar.
NSh Bujqësia Fushë-Kosovë	257,171	Sipas marrëveshjes, KUR PRISHTINA ka paguar shumën për shpronësimin e asetit për ndërtimin e fabrikës të ujit në "Shkabaj". a) EUR 244,128.20 apo 20% e shumës totale të shpronësimit prej EUR 1,220,641 të vitit 2012; dhe b) EUR 13,042.50 apo 20% e shumës totale të shpronësimit prej EUR 65,212.50 të vitit 2017.
GJITHSEJ	6,182,063	

L/A e
vitit 2018

3. TË HYRAT E REALIZUARA NGA QIRATË

PËRSHKRIMI	VITI 2019	VITI 2018	VITI 2017	2019 vs		2003 deri 31 dhjetor 2019
				2018	2017	
Qiratë në llogaritë e NSh-ve në tranzicion	1,674,831	1,609,116	1,265,776	4.08%	32.32%	15,187,644
Qiratë në llogaritë e NSh-ve në likuidim	3,787,605	4,660,898	5,262,421	(18.74)%	(28.03)%	24,086,128
Qiratë nga komercializimi	0.00	0.00	0.00	0.00%	0.00%	5,021,318
GJITHSEJ	5,462,436	6,270,014	6,528,197	(12.88)%	(16.33)%	44,295,090
NSh Pallati						
	0.00	(883,679)	(1,572,808)			
GJITHSEJ PA NSh PALLATI	5,462,436	5,386,335	4,955,389	1.41%	10.23%	

Rënie e inkasimit kundrejt vitit 2018 dhe vitit 2017, është vetëm për arsye të NSh Pallatit të Rinisë dhe Sporteve, i cili nga muaji shtator 2018 me vendim të Kuvendit të Kosovës, është kaluar nën-kompetencën e Komunës së Prishtinës. Krahasim i drejtë i performancës për tre vitet e fundit do të ishte po që se nuk llogarisim të hyrat nga NSh Pallati sepse ato të hyra janë shfrytëzuar vetëm për të mbuluar shpenzimet operative dhe administrative. Rrjedhimisht, krahasimi pa NSh Pallati, të hyrat nga qiraja të vitit 2019 kundrejt vitit 2018 do të kishim një rritje të hyrave prej **1.41%** dhe kundrejt vitit 2017, do të kishim një rritje prej **10.23%**.

Andaj, edhe pse gjatë vitit 2019 kemi pasur të nënshkruar 222 kontrata nga shitja e aseteve (zvogëlim të aseteve) dhe janë bartur blerësve, AKP-ja ka arritur që të realizoj të hyra nga qiraja në vlerën prej EUR 5.4 milion.

Në përgjithësi, dhënia e aseteve me qira për këto NSh janë: lokalet, toka bujqësore, pikat e shitjes të derivateve, depot dhe të tjera.

- **Qiratë e NSh-ve në tranzicion** janë për periudhën para se NSh të hyjë në likuidim
- **Qiratë në llogaritë e NSh-ve në likuidim** janë gjatë periudhës për NSh-të për të cilat janë në proces të likuidimit; dhe
- **Qiratë nga NSh e komercializuar** - Në këtë pozicion janë të paraqitura bilanci e pranimeve për kontratat e periudhës sa NSh ka qenë e komercializuar dhe të nënshkruara gjatë vitit 2000 nga UNMIK. Vlera e tërësishme e inkasimeve, nga viti 2003 deri në datën raportuese është EUR 5,021,319. Nga data 16 qershor 2012, AKP-ja nuk ka realizuar qira përmes metodës të komercializimit, sepse këto asete të NSh-ve ose janë shitur ose janë në proces të likuidimit.

3.1. QIRAJA E INKASUAR PËR NDËRMARRJET SHOQËRORE NË LIKUIDIM

PËRSHKRIMI	2019 vs 2018				2019 vs 2017			
	2019	2018	2017	% 2018	2019	2017	% 2017	
*Grand Hoteli	609,277	486,223	425,509	25.31%	43.19%			
*Pallati i Rinisë	0.00	883,679	1,572,808	(100)%	(100)%			
Tregu – Prishtinë	890,102	860,467	845,568	3.44%	5.27%			
ABC Genci	48,242	152,531	178,922	(68.37)%	(73.04)%			
NSh Lux	166,102	110,090	69,343	50.88%	139.54%			
NSh Rilindja Grafike	243,921	343,956	275,610	(29.08)%	(11.50)%			
NSh Rilindja Tregt. Librare	106,292	120,343	125,637	(11.68)%	(15.40)%			
NSh Urata	318,949	84,618	95,316	276.93%	234.62%			
NSh Banksos	106,561	76,633	112,207	39.05%	(5.03)%			
NSh Auto Prishtina	105,836	117,831	116,711	(10.18)%	(9.32)%			
NSh tjera në likuidim	1,192,323	1,424,527	1,444,790	(16.30)%	(17.47)%			
GJITHSEJ	3,787,605	4,660,898	5,262,421	(18.74)%	(28.03)%			

Ashtu siç është pasqyruar në shënimet e mësipërme si dhe në largimi i NSh Pallati nga administrimi i AKP-së, ka ndikuar në zvogëlimin e të hyrave të qirasë në raport me vitet paraprake. Sipas Ligjit, kjo ndërmarrje tani është Ndërmarrje Publike dhe nga data 11 shtator 2018 është nën kompetencën e Komunës të Prishtinës.

Disa prej NSh've që kanë ndryshim të madh kundrejt vitit 2018



Komente lidhur me NSh me vlera të mëdha të inkasimit të qirasë


- **Grand Hotel** - inkasim i borxhit të viteve të kaluara me çka ka rezultuar edhe në uljen e llogarive të arkëtueshme. Shih edhe llogaritë e arkëtueshme.
- **Urata** - pagesa prej EUR 233,041 e borxhit të vjetër të qirasë. Kjo shumë është paguar nga qiramarrësi si kusht për negocim të marrëveshjes të shitjes të asetet me negocim direkt
- **Lux** - Rritja e inkasimeve të qirave në krahasim me vitin 2018 është si rezultat i inkasimeve të borxheve të viteve paraprake dhe marrëveshjeve të reja me qiramarrës gjatë vitit 2019.
- **Banksos** – Inkasimi është më i lartë në vitin 2019 sepse kemi më shumë qiramarrës dhe atë me vlera të larta të qirasë.
- **ABC Genci**; Rënia e inkasimeve ka ardhur për shkak se qiramarrësit kanë mbetur prapa me pagesa. Gjatë vitit 2020 janë nisur ndërmarrja veprimeve ligjore për inkasim të borxhit kundrejt këtyre qiramarrësve dhe largim nga lokalet përkatëse. Shih edhe llogaritë e arkëtueshme.
- **Rilindja Grafike** - Rënia e inkasimit është për shkak se qiramarrësit kanë mbetur mbrapa me pagesa. Janë marrë hapat nga AL dhe Zyra Regionale për inkasim. Shih llogaritë e arkëtueshme.

3.2. QIRAJA E INKASUAR PËR NDËRMARRJET SHOQËRORE NË TRANZICION

PËRSHKRIMI	2019 vs		
	2019	2018	2017
NSh Jugopetrol	701,984	650,616	457,121
NSh Virxhinia	32,757	30,187	112
NSh Treska	13,680	13,680	22,510
NSh Ina Trgovina	835,484	835,624	656,957
Invest Banka	0.00	1,073	51,522
RTP	53,305	64,376	62,771
NSh Metaliku	15,013	3,119	0.00
NSh tjera në tranzicion	22,608	10,441	14,783
GJITHSEJ	1,674,831	1,609,116	1,265,776
	4.08%		32.32%

Të hyrat nga qiraja e inkasuar nga NSh në tranzicion të paraqitur në tabelën në të majtë, kundrejt vitit 2018, kemi pasur një inkasim më të kënaqshëm. Mirëpo krahasuar me vitin 2017 ka pasur performancë më të mirë si rrjedhojë e monitorimit të pagesave dhe rritjes të qiradhënies (kontrata të reja) në një diferencë në EUR 409,055.

Disa prej NSh've që kanë ndryshim të madhë kundrejt vitit 2018



Komente lidhur me NSh me vlera të mëdha të inkasimit të qirasë

- **Invest Banka** – Kjo ndërmarrje ka hyrë në likuidim me datë 12 shkurt 2018 dhe të gjitha mjetet/aktivitetet realizohen nëpërmjet llogarisë bankare në likuidim. Gjatë vitit 2018 në llogari të likuidimit janë inkasuar EUR 11,807.
- **Jugopetroll** - arsyjeja e inkasimit më të lartë në vitin 2019 është për shkak të borxheve të mëdha që i kanë pasur qiramarrësit dhe kanë bërë shlyerjen e tyre në vitin 2019.
- **Metaliku** - Ndryshimi prej 381.34% ndërmjet vitit 2018 dhe 2019 është për shkak se në tremujorin e fundit të vitit 2018, për këtë NSh është hapur llogari bankare në BQK. Rrjedhimisht nga kjo periudhë është filluar inkasimi i qirave në këtë llogari të cilën direkt e administron AKP.
- **Radio Televizioni i Prishtinës** - arsyjeja e inkasimit më të lartë në vitin 2019 është për shkak të borxheve të mëdha që i kanë pasur qiramarrësit dhe kanë bërë shlyerjen e tyre në vitin 2019.

4. INTERESI I FITUAR

Të hyrat nga interesi janë:

- interesi i fituar nga llogaritë rrjedhëse në Bankën Qendrore të Kosovës. Për informatën e juaj, nga Korrik 2012, norma e aplikuar e interesit nga BQK është **zero %**;
- interesi bankar i fituar nga afatizimi për periudhat nga 1 muaj deri në 12 muaj i një pjese të mjeteve nga llogaritë bankare të fondeve në mirëbesim. Nga Korriku i vitit 2015 nuk ka të hyra nga interesi.

Gjithsej interesi i përgjithshëm i fituar nga viti 2003 deri në datën raportuese është **EUR 34,844,700** në të gjitha llogaritë bankare të hapura në BQK. **Për vitin fiskal 2019, nuk ka pasur të hyra nga interesi për shkak të normave të cilat nuk janë pozitive.**

Sipas nenit 19B të ligjit nr. 06/L -023 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/l-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/l-115 dhe me ligjin nr. 05/l-080 është paraparë që fondet tepricë, fondet e mbetura dhe fondet

e përkohshme, të gjitha të ardhurat e mbledhura nga Agjencia si rezultat i aktiviteteve të saj sipas këtij Ligji dhe të cilat mbahen në mirëbesim mund të investohen në instrumentet në vijim:

- Llogari rrjedhëse që paguan interes apo depozitë të afatizuar në Bankën Qendrore të Kosovës; dhe
- Letra me vlerë të borxhit të emetuara nga ndonjë autoritet publik i Republikës së Kosovës ose të garantuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

5. TË HYRAT NGA TARIFA DHE KONFISKIMET E BID DEPOZITAVE NË TENDERËT E SHITJES

PËRSHKRIMI	SHUMA
Gjendja më 1 janar 2019	8,319,864
Tarifa për pjesëmarrje në tender	338,400
Kthimet e tarifës administrative/anulim tenderi apo raste tjera	(4,500)
*Konfiskimin e BID depozitave të ofertesve	140,500
Kthim i BID depozitit të konfiskuar me parë	(10,000)
Gjithsej të hyrat gjatë vitit në llogari për AKP	464,400
Gjendja më 31 dhjetor 2019	8,784,264

*Një BID depozitë prej EUR 6,000 është konfiskuar në vitin 2020. Rrjedhimisht vlera totale e konfiskimeve është EUR 146,500

Janë të hyra të realizuara për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Këto të hyra përfshijnë të hyra nga tarifat për paraqitjen e tenderëve dhe **konfiskimin e BID depozitave të ofertesve, të cilët nuk i kanë përmbushur kushtet e pagesës**. Këto të hyra inkasohen në llogaritë bankare, të cilat AKP, më përpara i ka hapur për qëllime të mbarëvajtjes të aktiviteteve operacionale dhe procedurale. Llogaritë janë si më poshtë:

- Tarifa për dorëzimin e ofertave të privatizimit;
- Tarifa për dorëzimin e ofertave të likuidimit; dhe
- Fondi Rezervë i AKP-së;

Këto të hyra janë inkasimet në llogari bankare të tarifës për dorëzimin e ofertave të likuidimit por që nuk janë alokuar në tërësi në llogari të tarifës administrative për shkak të mbylljes të vitit fiskal dhe nevojës për likuiditet bankar në këto llogari. Në ndërlidhje shih dhe shënimin nr. 15

6. BID DEPOZITAT PËR PJESËMARRJE NË TENDER

PËRSHKRIMI	SHUMA
Gjendja më 1 janar 2019	843,200
BID Depozitat e paguara nga ofertesit për tender	16,977,437
Kthimi i BID Depozitave ndaj Ofertesve të pasuksesshëm	(11,955,241)
Bartje e BID dep. në llogari të NSh-ve (nënshkrimi i kontratave)	(2,998,407)
Konfiskimet e Bid dep. nga llogaria e bid depozitave	(120,500)
Gjithsej bilanci i pranimeve gjatë vitit	1,903,289
Gjendja më 31 dhjetor 2019	2,746,489

Janë të hyra nga BID depozitat e ofertesve që kanë marrë pjesë në tender dhe për të cilët ende nuk ka përfunduar procesi i shitjes. Me përfundim të procesit të shitjes, bilanci bankar do të jetë zero, sepse me nënshkrimin e kontratave, këto mjete si BID depozita, si pjesë e vlerës së blerjes, transferohen në llogari të NSh-ve përkatëse, për të cilat janë shitur asetet. Këto të hyra gjenerohen në llogaritë bankare, të cilat AKP, më përpara i ka hapur për qëllime të mbarëvajtjes të aktiviteteve operacionale dhe procedurale. Llogaritë janë si më poshtë:

- Llogaritë e BID depozitave të ofertës të privatizimit;
- Llogaritë e BID depozitave të ofertës të likuidimit;

7. TË HYRA TJERA

PËRSHKRIMI	SHUMA
Gjendja më 1 janar 2019	7,263,974
Inkasimet ditore në para të gatshme nga aktiviteti për NShTregu	5,615
Inkasimet ditore në para të gatshme për NSh ABC Genci	29,874
Inkasimet ditore në para të gatshme për NSh Grand Hotel	42,534
Marrëveshje për shfrytëzimin e minierave të Mim Golesh	10,101
Gjithsej	88,124
Gjendja më 31 dhjetor 2019	7,352,098

KRAHASIMET ME VITET 2018 DHE 2017

Në krahasim me vitin 2018 kemi rënie të inkasimeve për shkak se në këtë vit janë alokuar mjetet nga llogaria bankare në bankën komerciale të NSh Sharrcem prej EUR 195,019; EUR 88,000 nga debitorët e NSh've si dhe 29,500 të hyra nga ndëshkimet e "Spin Off";

Mjetet e alokuara prej EUR 195,019 nuk janë të hyra por vetëm transferim i gjendjes në llogari bankare që AKP e administron. Ndërsa shuma prej EUR 88,000 janë mjete të transferuara gjatë shpërndarjes të mjeteve ndaj kreditorëve ku disa prej NSh've janë debitorë të këtyre NSh've.

Gjithashtu në krahasim me vitin 2017 kemi rënie të inkasimeve për shkak se në këtë kemi inkasuar gjithsej EUR 55,657 nga marrëveshja ndërmjet "MIM Golesh" dhe "Bectel" dhe 14,374 nga Debitorët e NSh've

vs 2018
-309,315
(77.83)%

vs 2017
-71,094
(44.65)%

Tabela në anën e majtë paraqet gjendjen e inkasimeve nga viti 2003, për vitin aktual si dhe gjendjen me 31 dhjetor 2019.

Sa përket të hyrave gjatë vitit 2019 në shumën totale prej EUR 88,124, të hyrat kanë të bëjnë si më poshtë:

- Inkasimet ditore** – para të gatshme në të mirë të llogarive të NSh-ve përkatëse kanë të bëjnë me mjetet që pranohen gjatë aktivitetit ditor për të hyrat si: bifet në kuadër të NSh, shitja e biletave, shërbimeve apo të tjera tek NSh të tilla si ABC Genci, NSh Grand Hotel si dhe NSh Tregu. Këto NSh janë në likuidim, llogaritë e të cilave i menaxhon dhe administron AKP;
- Marrëveshje për shfrytëzimin e minierave të Mim Golesh

Ndërsa nga viti 2003, të hyra tjera janë si më poshtë:

- Shitja e mallrave dhe shërbimeve;
- Dividenda dhe shitja e aksioneve;
- Transferimi i mjeteve nga llogaritë bankare të NSh-ve të cilat kanë qenë aktive dhe kanë pasur mjete në llogaritë e bankave komerciale;
- NSh-të e paraqitur si kreditor për pretendimet e saj (Debitorët e NSh-ve);

8. KAPITALI THEMELTAR I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Në përputhje me nenin 17 të Ligjit nr. 04/L-034, Agjencia ka hapur llogarinë bankare për kapitalin themeltar. Gjithsej vlera e kapitalit themeltar është EUR 10 milion, ndërsa shuma e transferuar nga Qeveria është EUR 1 milion. Pjesa e mbetur prej EUR 9 milion mund të kërkohet nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së në kohën dhe në shumën e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë.

Më poshtë janë të paraqitura detajet e kapitalit themeltar për të gjitha transaksionet nga viti 2003 deri në **datën raportuese**:

- **Të hyrat në llogarinë e kapitalit prej EUR 1,132,172**
 - Të hyra nga pagesa e kapitalit themeltar prej EUR 1,013,200. Pagesa është realizuar nga Qeveria e Kosovës;
 - Të hyrat nga interesi prej EUR 118,972. *Janë pjesë përbërëse e shënimit shpjegues nr. 4.*
- **Pagesat nga llogaria e kapitalit prej EUR 83,311**
 - Pagesat e vendimeve të Gjykatave prej EUR 83,303. *Janë pjesë përbërëse e shënimit shpjegues nr. 14.*
 - Shpenzimet bankare prej EUR 8. *Janë pjesë përbërëse e shënimit shpjegues nr. 16*
- **Gjendja bankare në fund të periudhës 1,048,861**

Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur asnjë transaksion në llogarinë e kapitalit themeltar.

SHPENZIMET/SHPËRNDARJA

9. 20% I PUNËTORËVE TË TRANSFERUARA NË BSPK

PËRSHKRIMI	VITI 2019	VITI 2018	VITI 2017	2003 31 dhjetor 2019	
Llogari të privatizimit	1,996,391	99,588	325,823	76,306,742	Për periudhën raportuese, shuma prej EUR 7,122,367 është shpërndarë nga 64 ndërmarrje Shoqërore dhe janë gjithsej 9,437 punëtorë që ka përfutur nga kjo shpërndarje. Ndërsa nga tërë procesi i shpërndarjes gjatë viteve 2003-2019 kanë përfutur gjithsej 48,456 punëtorë.
Llogari të likuidimit	4,215,808	4,242,559	2,814,843	21,192,079	
Llogari në mirëbesim për punëtorët e NSH've	910,168	2,628,333	6,143,071	35,851,330	
GJITHSEJ	7,122,367	6,970,480	9,283,737	133,350,151	

Vlerat e prezantuara në tabelën e paraqitur më lartë janë mjete që janë transferuar në llogari të BSPK për 20%-e punëtorëve përmes llogarive:

- Llogarive të privatizimit - 20% nga shitja përmes privatizimit të ndërmarrjeve të reja të ndodhura kohë më parë;
- Llogarive të likuidimit - 20% nga shitja e aseteve të mbetura përmes likuidimit;
- Llogarive të likuidimit – mjete të pranuar sipas marrëveshjeve për shpronësimin e aseteve nga Qeveria dhe institucionet relevante; dhe
- **Llogarive në mirëbesim për punëtorët e NSH've** – mjete të mbajtura në mirëbesim vetëm për rastet që ka ankesa gjyqësore për listat e shpërndarjes.

LLOGARITË NË MIRËBESIM PËR PUNËTORËT E NSH've janë llogari bankare që janë hapur në Bankën Qendrore të Kosovës dhe administrohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Këto llogari bankare për NSH-të përkatëse janë hapur për qëllim të mbajtjes të parave në mirëbesim në emër të punëtorëve vetëm për rastet kur ka ankesa kundrejt listave për shpërndarje. Pjesa e pa transferuar e 20%-it vetëm për rastet që ka ankesa mbahen në mirëbesim dhe shpërndahen nga këto llogari me aprovimin final të listave të punëtorëve nga Gjykata. Deri më 31 dhjetor 2019, gjendja e mjeteve në llogarit bankare në mirëbesim për punëtorët e NSH've është EUR 12,615,698. Me shqyrtimin e kërkesave të 20% nga Gjykata, do të bëhet shpërndarja e tyre.

10. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE (OSHP)

Raporti i pagesave nëpër vite ndaj Ofruesve të Shërbimeve Profesionale

1	2	3	4=1+2+3	5	6=4+5
ANEKS KONTRATA					
KONTRATA BAZË		ANEKS KONTRATA			
VITET	FIKSE	VARIABLE	FIKSE	Gjithsej Deloitte	Gjithsej
2012	1,228,009	-	-	1,228,009	1,228,009
2013	1,228,009	2,781,117	-	4,009,126	4,009,126
2014	491,204	3,277,988	-	3,769,192	3,769,192
2015	245,602	1,458,973	-	1,704,575	1,704,575
2016	1,731,916	1,566,112	415,000	3,713,028	3,713,028
2017	-	-	996,000	996,000	996,000
2018	-	-	581,000	581,000	581,000
2019	-	-	-	136,309	136,309
GIJTHSEJ	4,924,740	9,084,190	1,992,000	16,009,930	16,137,239

Raporti i pagesave sipas kontratave ndaj Ofruesve të Shërbimeve Profesionale

Kontraktori	Lloji i pagesave	Vlera e kontraktuar	Pagesa	% e pagesave
Deloitte	kontrata bazë - variable	13,003,564	9,084,190	70%
	Kontrata bazë fikse	4,924,740	4,924,740	100%
	Aneks kontrata fikse	1,992,000	1,992,000	100%
Curtis	Kontratas bazë fikse	2,499,000	136,309	5%
GIJTHSEJ		22,419,304	16,137,239	72%

Në tabelat në anën e majtë paraqiten pagesat e realizuara nga viti 2012 deri më 31 dhjetor 2019.

Pagesat variable – janë pagesa të realizuara për secilin vendim të aprovuara/refuzuara të kërkesave të kreditorëve ndaj NSH've.

Pagesat fikse janë pagesa ndaj OShP'së për kryerjen e shërbimeve sipas kushteve të kontraktuara. Pagesat fikse janë aplikuar në tri kontrata: kontratën bazë me “Deloitte” (pagesa çdo TM); aneks kontratën me “Deloitte” (pagesa mujore); dhe kontratës bazë me “Curtis” (pagesa mujore)

1. Pagesat ndaj Deloitte
Nga viti 2012 si ofrues i shërbimeve profesionale ka qenë i angazhuar “Deloitte Central Europe Limited” nëpërmjet kontratës bazë 11 korrik 2012 – 9 korrik 2016 dhe aneks kontratës 8 gusht 2016 – 7 gusht 2018. Kontrata bazë është EUR 19 milion (13+4) dhe aneks kontrata prej EUR 1.9 milion.

2. Pagesat ndaj Curtis
Me përfundimin e kontratës me “Deloitte”, është angazhuar kontraktori tjetër “Curtis, Mallet-Prevost, Colt & Mosle LLP, Grant Thornton Consulting Doo dhe Grant Thornton L.L.C”. Periudha e angazhimit është pesëvjeçare (5), nga 1 korrik 2019 deri me 30 qershor 2024 në vlerën EUR 2,499,000

9.1 Shënim lidhur me pagesat e Ofruesit të Shërbimeve Profesionale (OSH):

Në bazë të nenit 20 të Ligjit nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115, me Ligjin nr. 05/L-080 dhe me vendim të Bordit të Drejtorëve:

a) *Tarifa fikse e Autoritetit të Likuidimit paguhet përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin e caktimit të saktë të koston fikse proporcionalisht për secilën ndërmarrje shoqërore në likuidim, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompensohet nga llogaria bankare e ndërmarrjes në likuidim;*

b) *Tarifa variabile (për kërkesat e shqyrtuara) e Autoritetit të Likuidimit dhe koston tjera të paraqitura në koston 1.1 dhe 1.3 të nenit 40.1 të shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 paguhen nga fondet e ndërmarrjes në likuidim. Në rast se ende nuk ka fonde të mjaftueshme në llogarinë bankare të likuidimit, atëherë tarifa variabile paguhet përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin që do të ketë fonde të mjaftueshme në llogarinë e likuidimit, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompensohet nga llogaria e ndërmarrjes në likuidim.*

Po në bazë të këtij neni, sipas plotësimit/ndryshimit të Ligjit nr. 06/L-023, të aprovuar në muajin maj 2018, tani më specifikohet qartazi mënyrës e pagesave ndaj OShP-së dhe kostove të likuidimit.

9.2. GARANÇIONI BANKAR

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka pranuar sigurimin e ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës nga Konzorciumi “Curtis, Mallet-Prevost, Colt & Mosle LLP ,Grant Thornton Consulting Doo, Shkup dhe Grant Thornton L.L.C.; rr.Rexhep Mala, Prishtinë për “Angazhimi i Ofruesit të Shërbimeve Profesionale (OSHP) për procesin e likuidimit për të gjitha Ndërmarrjet Shoqërore/Asetet nën administrimin e AKP-së” (me numër të prokurimit :239-18-9399-2-1-1)

Detajet e garancionit bankar janë si vijon: data e garancionit është 26 Qershor 2019, shuma e garancionit 249,900.00, emri i bankës që ka lëshuar garancionin është Reiffeisen BANK, Prishtine Kosove.

11. MALLRA DHE SHËRBIME

PËRSHKRIMI	VITI 2019	VITI 2018	VITI 2017
Pagesat ndaj palëve të jashtme	1,562,728	1,954,997	2,209,017
Kompensimi i tarifës administrative	0.00	(13,115)	(14,168)
GJITHSEJ	1,562,728	1,941,882	2,194,849

Krahasimet me NSh Pallati	2019 vs	(379,154) (19.53)%	(632,121) (28.80)%
Krahasimet PA NSh Pallati	2019 vs	22,655 1.47%	(12,315) (0.78)%

PËRMBLEDHJE E PAGESAVE NDAJ PALËVE TË JASHTME 2019

	SHUMA
Ofruesit e Shërbimeve dhe pagat e punëtorëve (MIM Golesh dhe NSh Virxhinia)	1,369,962
Pagesa ndaj vlerësuesve të pronave lidhur me procesin e negociimit direkt	4,763
Shërb. Prof. -Angazhimi i përbaruesve/përfaqësime ligjore dhe ekspertizë ligjore	14,300
Qiraja e paguar nga NSh Tregu (për hapësirat e përbashkëta)	35,550
Furni. material higjienik, administrativ dhe bufesi për Grandin dhe ABC Genci	7,736
Pagesat për marrëveshjet e kontraktuara të filmave për ABC Genci në likuidim	8,731
Ngrohje qendrore (Termokos) për NSh Grand Hotel	68,129
Shp. të marketingut, mirëmbajtjes të uebsajtit, mirëmbajtje, rryma, taksa gjyqësore/kadastrale dhe tjera	8,566
Shpallje dhe Publikimet në gazeta vendore dhe ndërkombëtare për NSh-të	24,460
Dërgesa postare	5,596
Tatimet dhe Trustet Pensionale për OSh-të nga tarifa për NSh-të përkatëse	15,932
Kthimi i mjeteve nga Këshilli Gjyqësor për depo. e lëndës 1206-15 - Mim Golesh	(37,373)
Shpenzime të udhëtimit zyrtar jashtë vendit (përf. në Gjykatë në Mal të Zi)	9,876
Shpenzimet nga paraja e imët për Zyrat Regjionale	25,900
Provizione për ruajtjen e artikujve në Bankën Qendrore të Kosovës	600
GJITHSEJ	1,562,728

Në përgjithësi në këtë kategori përfshihen pagesat për: ofruesve e shërbimeve për NSh në Likuidim dhe Pagat e Punëtorëve – NSh në tranzicion; qiraja, shpenzime për reklamim, shërbime profesionale dhe mirëmbajtja dhe ruajtja e aseteve.

Zvogëlim i shpenzimeve në mallra dhe shërbime është kryesisht si rezultat i NSh Pallati i cili nga muaji shtator 2018 është nën kompetencën e komunës të Prishtinës. Gjithsesi, në anën e majtë të tabelës kemi krahasuar shpenzimet pa NSh Pallati. Shpenzimet e NSh Pallati për vitin 2018 kanë qenë prej EUR 401,809. Ndërsa për vitin 2017 kanë qenë prej EUR 619,806

1. KOMPENSIMI I TARIFËS ADMINISTRATIVE

Ka efektin zero në aspektin e kontabilitetit të fondeve në mirëbesim. Shembull në vitin 2018, shuma prej EUR 13,115 paraqitet si zbritje (minus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ndërsa në anën tjetër është paraqitur si shpenzim (plus) në kategorinë e shërbimeve publike, taksave gjyqësore etj. Këto shpenzime kanë ndodhur më parë nga llogaria e tarifës administrative të AKP-së për shpenzimet e NSh-ve përkatëse dhe pastaj kjo llogari kompensohet nga llogaritë e NSh-ve në likuidim dhe NSh-ve në tranzicion.

Gjatë vitit 2019 nuk është bërë kompensimi i llogarisë të tarifës administrative si rrjedhojë e mungesës së mjeteve bankare në këto NSh.

2. PAGESAT NDAJ PALË TË JASHTME

Sa i përket pagesave të realizuara nga fondet në mirëbesim ndaj palëve të jashtme, ato janë paraqitur në tabelën e dytë në anën e majtë. Këto pagesa janë realizuar nga llogaritë e NSh-ve në tranzicion, likuidim dhe tarifa administrative e Agjencisë.

10.2. PAGESAT NDAJ OFRUESVE TË SHËRBIMEVE DHE PAGAT E PUNËTORËVE PËR NSh NË TRANZICION

PËRMbledhje e pagesave të realizuara

PËRSHKRIMI	VITI 2019	VITI 2018	VITI 2017
Paga të punëtorëve	214,213	226,638	204,172
Ofrues të Shërbimeve si roje	448,325	574,033	645,111
Ofrues të Shërbimeve për shërbime tjera	707,424	834,532	951,292
Gjithsej	1,369,962	1,635,203	1,800,575
Krahasimet me NSh Pallati	2019 vs (265,241) (16.22)%	(430,613) (23.92)%	
Krahasimet PA NSh Pallati	2019 vs 73,292 5.65%	101,585 8%	

PËRMbledhje e numrit të OSh've të angazhuar

PËRSHKRIMI	VITI 2019	VITI 2018	VITI 2017
Paga të punëtorëve	63	64	47
Ofrues të Shërbimeve si roje	158	213	244
Ofrues të Shërbimeve për shërbime tjera	209	270	303
Gjithsej numri i OSh've dhe punëtorëve	430	547	594
Krahasimet me NSh Pallati	2019 vs (117) (21)%	(164) (28)%	
Krahasimet PA NSh Pallati	2019 vs (4) (1)%	(50) (10)%	

Angazhimi i ofruesve të shërbimeve bëhet në përputhje me procedurat të aprovuar nga Menaxhmenti i AKP-së. Përveç procedurave, për rastet e NSh-ve në likuidim, këto shpenzime janë të lejuara sipas kornizës buxhetore të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve. Gjithsesi, vlen të theksohet se përveç kornizës buxhetore të llojeve të shpenzimeve të lejuara, me aprovim të Bordit caktohet edhe kufiri maksimal i shumës së buxhetuar për shpenzim për 29 kode të planit kontabël të fondeve në mirëbesim. Sipas procedurës, për të angazhuar Ofrues të Shërbimeve për NSh përkatëse, përparësi kanë ish-punëtorët e atyre Ndërmarrjeve Shoqërore.

Sa i përket OSh-ve të angazhuar si roje në të gjitha NSh-të, nga viti 2016, si pjesë strategjike e Autoritetit të Likuidimit dhe Menaxhmentit të AKP-së është paraparë që ruajtja e aseteve të bëhet nëpërmjet angazhimit të OSh-ve dhe jo nëpërmjet operatorëve ekonomik. Ky veprim ka rezultuar me efekt pozitiv në kursimet e mëdha buxhetore për NSh-të përkatëse krahasuar me periudhat e mëhershme.

Po që se marrim për krahasim të dhënat pa NSh Pallati, vërehet se jemi përfaqësues në nivel të njëjtë sa i përket nivelit të shpenzimeve dhe angazhimit/numrit të OSh've.

Gjithsesi detaje janë paraqitur në faqen tjetër.

Lista sipas NSh've me shpenzime mbi EUR 10,000 të realizuara gjatë vitit 2019 për Ofruesit e Shërbimeve dhe Paga

	SHUMA 2019	SHUMA 2018	SHUMA 2017	2019 vs 2018		2019 vs 2017		Numri i Osh've			MIM Golesh nuk është paguar periudha e muajit shtator 2019.
				Shuma	%	Shuma	%	2019	2018	2017	
MIM Golesh	189,229	201,797	204,172	(12,568)	-6%	(14,943)	-7%	44	45	47	→
NSh Virxhinia	24,844	24,844	-	-	0%	24,844	100%	18	19	0	
Jugopetrol	30,188	12,947	30,881	17,241	133%	(693)	-2%	9	10	25	→
Tregu- likuidim	293,950	291,972	286,489	1,978	1%	7,461	3%	97	99	101	
Pallat- Likuidim	-	338,533	532,198	(338,533)	100%	(532,198)	-100%	0	113	114	
Hotel Grand	276,713	231,371	189,211	45,342	20%	87,502	46%	78	82	86	→
ABC Genci	64,485	71,541	84,592	(7,056)	-10%	(20,107)	-24%	14	15	19	
Morava Partesh	11,909	12,642	6,427	(733)	-6%	5,482	85%	4	4	4	
Zarije Bujic	11,778	12,736	10,797	(958)	-8%	981	9%	4	4	4	
Lola Shterpce	23,238	23,238	23,238	-	0%	-	0%	8	8	8	
FAM VITI	12,734	12,797	8,907	(63)	0%	3,827	43%	4	4	4	
Hotel Brezovica	11,619	12,587	10,651	(968)	-8%	968	9%	4	4	4	
Xim Strezovci	25,083	23,141	23,770	1,942	8%	1,313	6%	8	8	8	
Transkosova	11,411	12,361	10,208	(950)	-8%	1,203	12%	5	4	4	
Shpezëtaria	11,619	12,587	10,651	(968)	-8%	968	9%	4	4	4	
IMN Kosova	34,709	35,545	34,629	(836)	-2%	80	0%	12	10	10	
Rilindja shtyp.	41,967	44,908	56,707	(2,941)	-7%	(14,740)	-26%	17	17	20	→
Perparimi	37,187	38,677	6,909	(1,490)	-4%	30,278	438%	10	11	8	
Bankos	35,338	40,164	53,339	(4,826)	-12%	(18,001)	-34%	10	13	15	
Lavertari Blegtori	17,197	18,424	15,258	(1,227)	-7%	1,939	13%	5	5	5	
IGK Ballkan	27,612	27,586	25,046	26	0%	2,566	10%	9	9	8	
NSh Unimont	13,818	13,818	13,818	-	0%	-	0%	4	4	4	
Shar Drvoexport	11,619	11,289	-	330	3%	11,619	100%	4	5	0	
Sharrcem	10,672	864	340	9,808	1135%	10,332	3039%	3	1	2	→
Ina Trgovina	21,502	1,880	3,760	19,622	1044%	17,742	472%	13	2	2	→
RTP	10,265	-	-	10,265	100%	10,265	100%	2	0	0	→
NSh tjera	109,276	106,954	158,575	2,322	2%	(49,299)	-31%	40	47	88	→
TOTALI	1,369,962	1,635,203	1,800,575	(265,241)	-16%	(430,613)	-24%	430	547	594	
Pa NSh Pallati				73,292	6%	101,585	8%				

MIM Golesh nuk është paguar periudha e muajit shtator 2019.

Jugopetrol gjatë vitit 2018 angazhimi i Osh've ka filluar në mes të vitit fiskal.

Grand Hotel ka rritje të pagave.

Rilindja nga muaji korrik kanë qenë të angazhuar 15 OSh.

Sharrcem, angazhimi i Osh've për arbitrazhin ndërkombëtar lidhur me kontestin që të paguhen shuma prej EUR 9 milion si shtesë e çmimit. Shih II/a.

Ina Trgovina roje të angazhuar pas lirim të asetëve nga qiramarrësit.

RTP Osh të angazhuar për mbarevajtje të aktiviteve të NSh'së.

NSh tjera – janë një numër i konsiderueshëm i NSh've në cilat janë angazhuar OSh kryesisht 1 apo 2 dhe në disa rate 1 OSh për disa NSh.

Rrjedhimisht:
- Gjatë vitit 2019 janë angazhuar deri në 30 NSh.
- Gjatë vitit 2018 ishin të angazhuar në 30 NSh.
- Ndërsa për vitin 2017 kanë qenë 37 NSh.

10.2. SHPENZIMET E PARASË SË IMËT

PËRSHKRIMI	Avanset	Shpenzimet	Mjetet e kthyer
ZR e Pejës	7,100	5,347	1,753
ZR e Prishtinës	5,000	4,242	758
ZR e Gjilanit	5,000	4,139	861
ZR e Mitrovicës	4,000	2,752	1,248
ZR e Prizrenit	9,000	8,925	75
Për qëllime të privatizimit	2,300	495	1,805
GJITHSEJ – PARAJA E IMËT	32,400	25,900	6,500
**AVANS PËR UDHËTIME ZYRTARE	10,550	9,876	674
GJITHSEJ	42,950	35,776	7,174

Paraja e imët e dhënë në avans ka të bëjë me shpenzimet e vogla për Zyrat Rajonale për NSh-të përkatëse. Avanset tërhiqen nga llogaria e tarifës administrative në fillim të vitit dhe sipas kërkesave shtesë nga ZR-të. Këto shpenzime kryesisht kanë të bëjnë me shpenzime të vogla të tilla si taksa gjyqësore, taksa për certifikata të pronësisë, shpenzime të nevojshme të vogla për mirëmbajtjen e aseteve dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve të NSh-ve në likuidim.

**Paraja e imët e dhënë në avanset për udhëtime zyrtare kanë të bëjnë me shpenzimet jashtë vendit. Këto shpenzime janë për përfaqësime në Gjykata për mbrojtjen e aseteve që gjenden jashtë vendit. Të gjitha procedurat dhe zbatueshmëria e rregullave mbështetet sipas rregullave të Ministrisë së Financave për udhëtimet zyrtare jashtë vendit.

12. SHPENZIME KOMUNALE

PËRSHKRIMI	VITI 2019	VITI 2018	VITI 2017
Pagesat ndaj palëve të jashtme	231,239	409,970	731,328
Kompensimi i tarifës administrative	0.00	2,093	175
Gjithsej	231,239	412,063	731,503
Krahasimet me NSh Pallati	2019 vs (180,824) (43.88)%	(500,264) (68.39)%	
Krahasimet PA NSh Pallati	2019 vs (34,670) (13.04)%	(68,073) (22.74)%	

Kanë të bëjnë me pagesat e realizuara për shërbimet publike (rrymë, ujë, telefoni dhe shërbimet e telekomunikimit) për Ndërmarrjet Shoqërore në tranzicion dhe në Likuidim që kanë aktivitete të përditshme.

Zvogëlim i shpenzimeve komunale është kryesisht si rezultat i NSh Pallati i cili nga muaji shtator 2018 është nën kompetencën e komunës të Prishtinës. Gjithsesi, në anën e majtë të tabelës kemi krahasuar shpenzimet pa NSh Pallati. Shpenzimet e NSh Pallati për vitin 2018 kanë qenë prej EUR 146,154. Ndërsa për vitin 2017 kanë qenë prej EUR 432,191.

PËRMBLEDHJE E PAGESAVE NDAJ PALËVE TË JASHTME

PËRSHKRIMI	VITI 2019	VITI 2018	VITI 2017
Shpenzime për furnizim me ujë	8,425	23,392	82,233
Rrymë	130,694	268,063	512,891
Pastrimin e mbeturinave	86,733	111,044	125,280
Shërbimet e telekomunikimit	5,387	7,471	10,924
Gjithsej	231,239	409,970	731,328

1. KOMPENSIMI I TARIFËS ADMINISTRATIVE

Ka efektin zero në aspektin e kontabilitetit të fondeve në mirëbesim. Shuma prej EUR 2,093 paraqitet si shpenzim (plus) në kategorinë e komunalive ndërsa në anën tjetër është paraqitur si zbritje (minus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Këto shpenzime kanë ndodhur më parë nga llogaria e tarifës administrative të AKP-së për shpenzimet e NSh-ve përkatëse.

Gjatë vitit 2019 nuk është bërë kompensimi i llogarisë të tarifës administrative si rrjedhojë e mungesës së mjeteve bankare në këto NSh.

13. TATIMET

PËRSHKRIMI	VITI 2019	VITI 2018	VITI 2017
Pagesat ndaj palëve të jashtme	932,654	1,120,840	1,723,945
Kompensimi i tarifës administrative	0.00	1,485	(584)
Gjithsej	932,654	1,122,325	1,723,361
Krahasimet me NSh Pallati	2019 vs	(189,671) (16.90)%	(790,707) (45.88)%
Krahasimet PA NSh Pallati	2019 vs	48,422 5.48%	(501,670) (34.98)%

Kanë të bëjnë me pagesat e realizuara për shërbimet publike (rrymë, ujë, telefoni) për Ndërmarrjet Shoqërore në tranzicion dhe në Likuidim që kanë aktivitete të përditshme.

Zvogëlim të shpenzimeve të tatimeve është kryesisht si rezultat i NSh Pallati i cili nga muaji shtator 2018 është nën kompetencën e komunës të Prishtinës. Gjithsesi, në anën e majtë të tabelës kemi krahasuar shpenzimet pa NSh Pallati. Shpenzimet e NSh Pallati për vitin 2018 kanë qenë prej EUR 238,093. Ndërsa për vitin 2017 kanë qenë prej EUR 289,037.

PËRMBLEDHJE E PAGESAVE NDAJ PALËVE TË JASHTME

PËRSHKRIMI	VITI 2019	VITI 2018	VITI 2017
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	597,704	819,398	636,520
Tatimi nga të hyrat e realizuara/qiratë	92,684	75,891	224,398
Kontributet pensionale- Trusti	128,358	137,668	181,069
Tatimi në të ardhurat personale	45,569	49,874	71,332
Tatimi në Pronë – Komunave	68,339	38,009	610,626
Gjithsej	932,654	1,120,840	1,723,945

2. KOMPENSIMI I TARIFËS ADMINISTRATIVE

Ka efektin zero në aspektin e kontabilitetit të fondeve në mirëbesim. Shuma prej EUR 1,485 paraqitet si shpenzim (plus) në kategorinë e komunalive ndërsa në anën tjetër është paraqitur si zbritje (minus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Këto shpenzime kanë ndodhur më parë nga llogaria e tarifës administrative të AKP-së për shpenzimet e NSh-ve përkatëse.

Gjatë vitit 2019 nuk është bërë kompensimi i llogarisë të tarifës administrative si rrjedhojë e mungesës së mjeteve bankare në këto NSh.

14. VENDIMET E GJYKATAVE/PËRMBARUESVE

PËRSHKRIMI	VITI 2019	VITI 2018	VITI 2017
Pagesat ndaj palëve të jashtme	8,605	698,063	20,368
Kompensimi i tarifës administrative	0.00	9,648	13,037
Gjithsej	8,605	707,711	33,405
Krahasimet me NSh Pallati	2019 vs	(699,106) (98.78)%	(24,800) (74.24)%
Krahasimet PA NSh Pallati	2019 vs	(70,610) (89.14)%	(24,800) (74.24)%

Këto pagesa kryesisht kanë të bëjnë me rastet e mëposhtme: taksa gjyqësore dhe garancione në Gjykatë dhe vendime të Gjykatave dhe pagesa ndaj përmbaruesve.

Zvogëlim të shpenzimeve të vendimeve të gjykatave është si rezultat i NSh Pallati i cili nga muaji shtator 2018 është nën kompetencën e komunës të Prishtinës. Gjithsesi, në anën e majtë të tabelës kemi krahasuar shpenzimet pa NSh Pallati.

*Shpenzimet e NSh Pallati për vitin 2018 kanë qenë prej EUR 628,496. Shuma prej EUR 628,496 është ekzekutuar nga përmbaruesi privat.

**Gjatë vitit 2018, gjithashtu është ekzekutuar vendimi i gjykatës nr. 892-2010 dhe mjetet i kanë kaluar palës me të cilin AKP ka qenë në kontest gjyqësor për çështje të privatizimit.

PËRMBLEDHJE E PAGESAVE NDAJ PALËVE TË JASHTME

PËRSHKRIMI	VITI 2019	VITI 2018	VITI 2017
Taksa Gjyqësore	9,156	8,530	21,870
Ekspertizat për Gjykatë	7,265	350	-
*Ekzekutimi i pagesave nga përmbaruesi privat për NSh Pallati	-	628,496	-
**Ekzekutimi i pagesës ndaj palës me vendim të Gjykatës	-	60,687	-
Kthim nga Gjykata të depozitës dhe taksave për Gjykatë	(7,816)	-	(1,502)
Gjithsej	8,605	698,063	20,368

3. KOMPENSIMI I TARIFËS ADMINISTRATIVE

Ka efektin zero në aspektin e kontabilitetit të fondeve në mirëbesim. Shuma prej EUR 9,648 paraqitet si shpenzim (plus) në kategorinë e vendimeve dhe taksave të Gjykatave ndërsa në anën tjetër është paraqitur si zbritje (minus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Këto shpenzime kanë ndodhur më parë nga llogaria e tarifës administrative të AKP-së për shpenzimet e NSh-ve përkatëse.

Gjatë vitit 2019 nuk është bërë kompensimi i llogarisë të tarifës administrative si rrjedhojë e mungesës të gjendjes bankare të NSh've.

15. TRANSFERIMI I MJETEVE 5% PËR MBULIMIN E AKTIVITETEVE TË AKP-së**MJETET E TRANSERUAR NË MINISTRI TË FINANCAVE**

PËRSHKRIMI	PËR BUXHETIN	SHUMA
Transfer gjatë vitit 2011	2011	1,800,000
Transfer me 28 Maj 2012	2012	8,200,000
Transfer me 28 Dhjetor 2012	2013	8,048,000
Transfer shtesë me 18 Nëntor 2014	2014	2,300,000
Transfer shtesë me 15 Janar 2015	2015	5,500,000
Transfer shtesë me 15 Janar 2016	2016	6,300,000
Transfer shtesë me 20 Janar 2017	2017	6,100,000
Transferet shtesë	2018	6,493,706
Transferet shtesë	2019	1,036,241
Gjithsej		45,777,947

RAPORT I TË HYRAVE TË DEDIKUARA PËR VITIN 2019

PËRSHKRIMI	SHUMA
Gjendja më 1 janar 2019	44,713,969
Konfiskimet e BID depozitave gjatë vitit 2019	90,500
Alokimi i mjeteve nga llog. tarifës për pjesë. në tender	305,863
5% e vlerës të shitjeve të aseteve përmes likuidimit	1,357,694
Gjithsej të hyrat e AKP'së për vitin 2019	1,754,057
Gjendja më 31 dhjetor 2019	46,468,026

1. Mjete të transferuara në Ministri të Financave

Tabela në anën e majtë nuk paraqet bilancin e të hyrave të dedikuara të realizuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, por paraqet shumat e transferuara nga llogaria e tarifës administrative të AKP-së prej EUR 43,977,947 si dhe fondit rezervë prej EUR 1,800,000. Mjetet janë transferuar në Ministri të Financave për buxhetet vjetore të AKP'së. Për buxhetin 2019 është transferuar shuma prej EUR 1,036,241 si mjete shtesë për të mbuluar buxheti e të hyrave të dedikuara prej EUR 2,000,000, që AKP-ja ka paraparë në projektionet buxhetore, pasi që nga mos shpenzimi i buxhetit të vitit 2018 në vlerën prej EUR 963,759, janë bartur për të shpenzuar në buxhetin e vitit 2019.

2. Raport i të hyrave të dedikuara për vitin 2019

Janë të gjitha mjetet e inkasuara në llogari të tarifës administrative nga konfiskimet e BID Depozitave, tarifa për pjesëmarrje në tender dhe 5% e shitje të kontratave të nënshkruara.

Për të parë se sa janë të hyrat në total vetëm për vitin 2019 të konfiskimit të BID Depozitave dhe tarifës për pjesëmarrje në tender ju lutem ndërlidhuni me shënimin shpjegues nr. 5

Ndërsa totali i të hyrave të dedikuara për vitin 2019 nga 5% të shitjeve të aseteve është EUR **1,649,344.21 dhe atë**

- 1,508,243.28 (30,164,865.54*5%); nga shitja e aseteve përmes likuidimi; dhe
- 141,100.93 (2,822,018.*5%) nga negociimit direkt

Gjithashtu në ndërlidhje me këtë çështje, ju lutem referojuni shënimit shpjegues nr. 2.

16. SHPENZIME TJERA

PËRSHKRIMI	VITI 2019	VITI 2018	VITI 2017
Pagesat	18,563	37,762	32,960
Kompensimi i tarifës administrative	0.00	(112)	1,326
Gjithsej	18,563	37,650	34,286
Krahasimet me totalët	2019 vs	(19,087) (50.70)%	(15,723) (45.86)%
Krahasimet PA NSh Pallati	2019 vs	(13,768) (42.58)%	(10,228) (35.52)%

PËRMBLEDHJE E PAGESAVE

PËRSHKRIMI	SHUMA
Shp. nga paraaja e imët në avans për shpenzime të vogla	14,228
Shpenzime bankare/tarifa për transaksion	4,335
Gjendja më 31 dhjetor 2019	18,563

Këto shpenzime përfshijnë avanset për udhëtime zyrtare të Zyrtarëve Ligjor dhe Zyrtarëve të Rastit për NSh-të në likuidim (përfaqësime gjyqësore jashtë territorit të Kosovës) dhe pagesat e tarifave për transaksionet dalëse nga llogarit bankare të fonde në mirëbesim që i aplikon BQK.

Gjithashtu, avanse për udhëtime zyrtare jashtë vendit janë paraqitur në kategorinë mallra dhe shërbime tek shënimi shpjegues nr. 10

Zvogëlim të shpenzimeve të tatimeve është kryesisht si rezultat i NSh Pallati i cili nga muaji shtator 2018 është nën kompetencën e komunës të Prishtinës. Gjithashtu edhe po që se për krahasim më të drejtë nuk trajtojmë shpenzimet e NSh Pallati, kemi zvogëlim të shpenzimeve. Në anën e majtë të tabelës kemi krahasuar shpenzimet pa NSh Pallati. Shpenzimet e NSh Pallati për vitin 2018 kanë qenë prej EUR 5,319. Ndërsa për vitin 2017 kanë qenë prej EUR 5,495

2. KOMPENSIMI I TARIFËS ADMINISTRATIVE

Ka efektin zero në aspektin e kontabilitetit të fondeve në mirëbesim. Shuma prej EUR 112 paraqitet si zbritje (minus) në kategorinë e shpenzimeve tjera ndërsa në anën tjetër është paraqitur si shpenzim (plus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Është fjala për korrigjimin e një transaksioni bankar që më pastaj llogaria bankare e NSh është kompensuar. Këto shpenzime kanë ndodhur më parë nga llogaria e tarifës administrative të AKP-së për shpenzimet e NSh-ve përkatëse.

Gjatë vitit 2019 nuk është bërë kompensimi i llogarisë të tarifës administrative si rrjedhojë e mungesës të gjendjes bankare të NSh-ve.

17. PAGESAT NDAJ KREDITORËVE TË NSH-ve NË LIKUIDIM**RAPORTI I PAGESAVE NDAJ KREDITORËVE TË NSH've**

PËRSHKRIMI	VITI 2019	VITI 2018	VITI 2017	TOTALET
Paga punëtorëve	1,075,637	863,375	4,427,879	12,469,910
ATK-ja	-	898,425	1,188,392	5,739,374
Trusti	83,686	195,920	661,326	2,561,405
Tatimi në pronë	5,175	44,721	320,698	1,335,243
Komunalit	-	293,218	159,893	1,174,241
Kreditor të tjerë	4,320	180,468	1,347,668	4,342,657
Gjithsej	1,168,818	2,476,127	8,105,856	27,622,830

SHUMA E RAPORTET E APROVUARA DHE GIENDJA E TYRE E PAGESAVE

VITI	SHUMA	PAGESA	Diferenca
2010	21,853	21,853	-
2011	23,289	23,289	-
2016	17,414,433	17,376,572	37,861
2017	6,821,550	6,770,238	51,312
2018	2,339,526	2,283,753	55,773
2019	3,906,238	1,147,125	2,759,113
Gjithsej	30,526,889	27,622,830	2,904,059

1. RAPORTI I PAGESAVE NDAJ KREDITORËVE TË NSH've

Tabela në anën e majtë paraqet bilancin e pagesave për tre vitet e fundit si dhe totalin e realizuar nga viti 2011 deri me 31 dhjetor 2019.

2. SHUMA E RAPORTEVE TË APROVUARA DHE GIENDJA E TYRE E PAGESAVE

Tabela në anën e majtë paraqet shumën e raporteve për shpërndarje të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve nga viti 2010 deri më 31 dhjetor 2019.

Shumat e papaguara për raportet e viteve 2016-2018 janë kryesisht rezultat i mungesës i të dhënave të sakta për llogarit bankare. Për këto raste deri me tani nuk është arritur nga Autoriteti i Likuidimit dhe Zyrtarët e Rastit në gjetjen e kontakteve të tyre në mënyrë që të ju mundësohen pagesat.

Ndërsa nëntor dhe dhjetor 2019, janë aprovuar për tre NSH raporte të shpërndarjes dhe vetëm NSH IGK Ballkan është arritur të ekzekutohet për pagesë në përfundim të vitit 2019:

- IGK Ballkan në shumën prej EUR 1,556,779 (paguar 1,147,125 dhe obligimi i mbetur –mungesa e llogarive bankare prej EUR 409,361 dhe tarife bankare 293);
 - Qyqavica në shumën prej EUR 1,697,912,
 - Kosovaplast në shumën prej EUR 651,547 dhe
- Për NSH Qyqavica dhe Kosovaplast janë proceduar në fillim të vitit 2020

Lidhur me diferencën totale prej EUR 2,904,059 -Për secilin pagesë të shumës të aprovuar ndaj kreditorit hiqet shuma e transaksionit bankar prej 0.30 apo 1.30 (mbi EUR 10,000) dhe gjendja reale e obligimeve në total është raportuar tek llogaritë e pagueshme meqenëse nga totali i shumës janë ndaluar tarifat bankare dhe raste tjera që janë shpallorur në shënimin nr. 23.2.

INFORMATË

SHUMA		Komente
192,357		Në vitin 2015, ATK-ja me kërkesën e saj ka rezervuar mjetet prej EUR 192,357 për NSh në likuidim “Jugoterm”.
6,893		Në vitin 2016, shuma prej EUR 6,893 të dedikuara për tatimin në pronë të kreditorit të Komunës të Skenderaj janë tërhequr nga ATK-ja si rezultat i vendosjes të “Barrës tatimore”. Tërheqja është bërë nga sistemi i Thesarit të Ministrisë së Financave. Kemi kërkuar që këto mjete të kthehen në llogari të AKP-së. Në fund të vitit 2018, kemi marrë premtimin se këto mjete do të kthehen mirëpo ende ATK-ja nuk i ka kthyer këto mjete me arsyetimin se këto duhet të ndjekin procedurat e tyre të brendshme dhe të cilat marrin kohë.
976		Për arsye të emrit dhe mbiemrit të njëjtë të dy kreditorëve, gjatë realizimit të pagesës në vlerë prej EUR 976.20, një kreditor ka përfituar më shumë për NSh “Trasing”. Kreditori është njoftuar që t’i kthej mjetet dhe njëkohësisht janë marrë masat ligjore për rastin në fjalë.
3,194		Në Mars të vitit 2015, BQK-ja ka ekzekutuar urdhrin e përmbaruesit privat në shumën 3,194 për NSh në likuidim “Malishgani Klinë”. AKP-ja ka marrë të gjitha hapat ligjor dhe ka kërkuar kthimin e mjeteve. Të gjitha institucionet relevante janë njoftuar për rastin në fjalë
2,460		Në fund të dhjetorit 2017, të hyrat prej EUR 2,460 për NSh Grand për shfrytëzimin e sallës nga AKP-ja, gjatë ekzekutimit të pagesës janë konfiskuar nga ATK-ja. Kjo si rezultat i marrëveshjes në mes të ATK-së dhe Thesarit, nëpërmjet të cilës, përmes sistemit automatikisht ekzekutohen pagesat në të mirë të ATK-së;
24,309		Gjithashtu, në vitin 2017 jemi njoftuar se, ATK-ja ka konfiskuar mjetet prej EUR 24,309 që është dashur të paguaj institucioni i Kosovës për shfrytëzimin me qira të asetit të NSh Mekanizimi. Mjetet janë konfiskuar në vitin 2016. Mënyra e konfiskimit të mjeteve është ngjashëm si në rastin e sipër shënuar më lartë.
620,866		Në vitin 2017 ATK-ja me kërkesën e saj ka rezervuar mjetet prej EUR 620,866 për NSh në likuidim “IDGJ Tobacco”.
6,341		Në vitin 2019 ATK-ja me kërkesën e saj ka rezervuar mjetet prej EUR 6,341 për NSh në likuidim “Pasuria Bujqësore Ferizaj”.
35,618		Në vitin 2019 ATK-ja me kërkesën e saj ka rezervuar mjetet prej EUR 35,618 për NSh në likuidim “Liria Bardhosh”.

Mjetet e rezervuar në BQK janë si rezultat i vendosjes së barrës tatimore mbi asetet e NSh’ve. AKP ka nënshkruar një “Marrëveshje të Mirëkuptimit” me ATK për trajtimin e barrës tatimore, por për rastin në fjalë është vendosur që të trajtohet deri në vendimin e Dhomës të Gjykatës Supreme të Kosovës.

18. FONDET TRANSFERUAR BUXHETIT TË KOSOVËS

VITI	Fondet Tepricë	Fondet e mbetura	Fondet e përkohshme	TOTALI
2012	28,934,282	-	-	28,934,282
2015	61,310,629	-	-	61,310,629
2017	-	325,664	-	325,664
2018	-	42,226,452	43,920,006	86,146,458
2019	-	2,208,220	147,793,750	150,001,970
Gjithsej	90,244,911	44,760,336	191,713,756	326,719,003

Fondet e transferuara në buxhetin e Kosovës janë:

1. Fondet Tepricë sipas nenit 19.3.3 të Ligjit bazik nr. 04/L-034;
2. Fondet e mbetura sipas nenit 4, paragrafi 3.2.6 të Ligjit nr. 06/L-023 për plotësim dhe ndryshim; dhe
3. Fondet e përkohshme sipas nenit 4, paragrafi 3.2.7 të Ligjit nr. 06/L-023 për plotësim dhe ndryshim të Ligjit 04/L-034 ka hyrë në fuqi në muajin maj 2018.

Nëpërmjet tabelës në anën e majtë, pasqyrohen llojet e fondeve të transferuara Buxhetit të Kosovës nga viti 2012 deri më 31 dhjetor 2019.

LLOGARITË E ARKËTUESHME

PËRSHKRIMI	VITI 2019	VITI 2018	VITI 2017
Ndëshkimet me Spin-Off Speciale	31,033,785	31,033,785	29,893,285
Nga shitja e asetëve	23,853,484	15,382,399	18,095,297
Nga shpronësimi i asetëve të NSh-ve	324,156	4,837,468	-
Të hyra nga qiraja	14,209,976	13,965,071	13,802,490
Gjithsej	69,421,401	65,218,723	61,791,072

TË SHPALOSURA

Ndëshkimet financiare të shpalosura në shënimin shpjegues nr. 19
Llogaritë e arkëtueshme nga shitjet e asetëve në shënimin shpjegues nr. 20
Llogaritë e arkëtueshme nga shpronësimi i asetëve në shënimin shpjegues nr. 21
Llogaritë e arkëtueshme nga të hyrat e qirasë në shënimin shpjegues nr. 22

Llogaritë e arkëtueshme janë obligimet e papaguara nga palët e treta ndaj Agjencisë për rastet si më poshtë:

- pjesët e papaguara nga valët e privatizimit/likuidimit dhe shitjeve përmes negocimit direkt;
- ndëshkimet financiare për valët e “spin off-ve special”;
- Shpronësimi i asetëve; dhe
- qiratë apo të hyra të tjera nga asetet e NSh-ve.

Të gjitha këto të dhëna janë të paraqitura nga Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje, Zyrat Regjionale përmes Departamentit të Koordinimit të Rajonal dhe Departamenti i Shitjes dhe Njësia për Negocim Direkt.

Ashtu siç është paraqitur edhe në fillim të shënimeve shpjeguese, sa i përket llogarive të arkëtueshme janë paraqitur vetëm si shpalosje në këto pasqyra, pasi që pasqyrat financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë përgatitur në pajtim me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik) e bazuar në para të gatshme.

19. NDËSHKIMET NDAJ NSh-ve ME SPIN-OFF SPECIAL

PËRSHKRIMI	VITI 2019	VITI 2018	VITI 2017
Grand Hotel	8,822,315	8,822,315	8,822,315
IDGJ Tobacco	0.00	0.00	29,500
Xim Strezovc	7,298,171	7,298,171	7,298,171
MIIM Golesh	8,447,812	8,447,812	8,447,812
Agrokosova Holding	3,579,998	3,579,998	3,579,998
Llamkos	1,715,489	1,715,489	1,715,489
Famipa Prizren	1,170,000	1,170,000	0.00
Gjithsej	31,033,785	31,033,785	29,893,285

Janë ndëshkimet në vlerë monetare ndaj blerësve për zotimet e dhëna për disa Ndërmarrje të Reja, që përveç çmimit të ofertës, ofertuesit kanë dorëzuar dhe ofertat lidhur me investimet për këto Ndërmarrje.

Shitjet janë realizuar edhe me kushte të tilla si: vazhdimi i operimit të aktivitetit të NSh-ve, me investimet e zotuara dhe numrin e punëtorëve. Këto raste kanë qenë “Shitjet me Kushte të Veçanta” dhe shitjet me “Spin Off Special”. Deri më tani, ndëshkimet financiare e aplikuar për blerësit të cilët nuk i kanë përmbushur zotimet për NSh-të e paraqitur sipas tabelës në anën e majtë

Për vitin 2019 nuk janë aplikuar ndëshkime lidhur me procesin e shitjes dhe apo ndëshkime tjera të rasteve në fjalë. Është gjendja e njëjtë nga viti 2018.

20. LLOGARITË E ARKËTUESHME NGA SHITJA E ASETEVE

PËRSHKRIMI	2019	2018	2017
Gjendja më 1 janar	15,382,399	18,095,297	5,818,388
Pagesat e realizuara të LL/A të viteve paraprake	(2,052,561)	(13,277,524)	(3,801,660)
Anulim/tërheqja nga shitjet të tenderuar LL/A	(608,847)	(1,739,081)	(1,399,594)
Llogari të arkëtueshme gjatë vitit	11,132,493	12,303,707	17,478,163
Gjithsej ndryshimet në vit	8,471,085	(2,712,898)	12,276,909
Gjendja më 31 dhjetor	23,853,484	15,382,399	18,095,297

Llogaritë e arkëtueshme përmes valëve të privatizimit dhe shitjes përmes negocimit direkt janë llogari që **potencialisht mund të inkasohen**, meqenëse për këto raste nuk është përfunduar ende procesi i nënshkrimit të kontratave.

Ashtu siç është thënë edhe me lartë, llogaritë e arkëtueshme në këtë rast paraqiten vetëm si shpalosje e informacioneve në pasqyrat financiare dhe mundësitë e inkasimit të tyre në të ardhmen.

Përveç rasteve të pezulluara - aprovimin nga Bordi, rastet që nuk realizojnë pagesat ju konfiskohet BID depoziti. Pjesa e konfiskimit të BID depozitave është trajtuar në shënimin shpjegues nr. 5.

Ndryshimet kundrejt vitit 2018

Kundrejt vitit 2018, ndryshimet janë kryesisht rritjet e llogarive të arkëtueshme në tremujorin e fundit të valës 51-53 në shumën totale prej EUR 7,933,063. Sipas kushteve të tenderit, afati i tyre i pagesave është më së largu deri në muajin mars 2020.

Ndërsa sa i përket llogarive të arkëtueshme **të vitit 2018**, pjesën më të madhe kryesisht e përbën vlera prej EUR 9,441,768 për Ndërmarrjen e Re “Sharrcem” Hani i Elezit. Bordi i Drejtoresve i AKP-se në mbledhjen e 23 nëntor 2018 ka vendosur (BD- 110/14) që vlera e mos përmbushjes së zotimeve për investime kapitale prej 9,441,768, bazuar në raportin e auditorit të pavarur të llogaritë si çmim i blerjes së aksioneve e cila është e parapare me kontratën e shitjes.

Lista detaje e të gjitha llogarive të arkëtueshme është prezentuar në faqen tjetër

PËRMbledhje – Përshkrimi i llogarive të Arkëtueshme të Bartura nga viti 2018 dhe ato në vitin 2019:

Periudha	Shuma	Përshkrimi	Statusi
BARTURA NGA VITET PARAPRAKE	321,111	Privatizim Vala 37 për Agrokosova Offices	Masë të përkohshme
	223,223	Privatizim Vala 43 për Punëtoria Iliria	Masë të përkohshme
	72,800	Likuidim 20 për asetin e NSh Lavërtari Blegtori	Masë të përkohshme
	70,777	Likuidimi 29 për Nsh Rekreators, njësia 34	Masë të përkohshme
	1,800,000	Likuidimi 35 për Nsh Gërmia, njësia 43	Masë të përkohshme
	112,456	Likuidimi 35 për Nsh Zetatrans, njësia 47	Masë të përkohshme
	478,325	Likuidimi 35 për Nsh Lavertari Blegtori, njësia 55	Masë të përkohshme
	9,441,768	Për Ndërmarrjen e Re “Sharrem” Hani i Elezit, Bordi i Drejtoresve i AKP-se në mbledhjen e 23 nëntor 2018 ka vendosur (BD- 110/14) që vlera e mos përbushjes së zotimeve për investime kapitale prej 9,441,768, bazuar në raportin e auditorit të pavarur të llogaritet si çmim i blerjes së aksioneve e cila është e parapare me kontratën e shitjes.	
	7,937	382-2 – asetet për shitjet me negociim direkt	Afati për pagese është një vjet
	4,560	382-16 – asetet për shitjet me negociim direkt	Afati për pagese është një vjet
	13,731	382-4 – asetet për shitjet me negociim direkt	Afati për pagese është një vjet
	5,558	382-3 – asetet për shitjet me negociim direkt	Afati për pagese është një vjet
	7,545	0601/5 – asetet për shitjet me negociim direkt	Afati për pagese është një vjet
	161,200	Likuidimi 42 për Nsh Lux, njësia 6	Pezullim
	19,890	Likuidimi 37 për Nsh Agromorava, njësia 7	Masë të përkohshme
2019	531,550	Likuidimi 45 Njësia nr. 75 - NSH Lavërtaria-Blegtoria - Tokë bujqësore në Trepetincë 4	Masë të përkohshme
	425,425	Likuidimi 47 Njësia nr. 114-NSH Lavërtaria-Blegtoria - Tokë bujqësore në Petrovë 1	Masë të përkohshme
	388,888	Likuidimi 49 Njësia nr. 101-Visoko Commerce Shitorja nr. 2	Masë të përkohshme
	163,000	Likuidimi 51 Njësia nr. 05 - IMK Toka në Shtime (Lot A)	Pezullim
	1,555,778	Likuidimi 51 Njësia nr. 71 - Auto Moto Lipjan	Pezullim
	111,001	Njësia nr.21: NSH Univerzal Lokali nr.4	Pezullim
	3,898	309/8 – asetet për shitjet me negociim direkt	Afati për pagese është një vjet
	7,933,063	Për valët e privatizimit 51-53 gjatë muajit tetor-dhjetor 2019	Valët e privatizimit
	23,853,484	GJITHSEJ	

21. LLOGARITË E ARKËTUESHME NGA SHPRONËSIMI I ASETETE

Llogaritë e arkëtueshme lidhur me shpronësimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore janë paraqitur vetëm për rastet kur AKP dhe institucionet tjera relevante kanë lidhur marrëveshje në të cilën përfshihen afatet kohore dhe shumat për pagesë. Gjithsesi, janë një numër i konsiderueshëm i aseteve që janë shpronësuar por për shumicën prej tyre ende nuk dihet vlera e vlerësuar e shpronësimit dhe rrjedha e pagesave. Rrjedhimisht, paraqiten vetëm rastet kur ka marrëveshje nëpërmjet të cilave institucionet relevante zotohen që brenda një periudhe afatmesme të paguhen shumat e shpronësimit. Zakonisht, sipas marrëveshjeve, vlerat e paraqitura më poshtë nuk janë vlera totale të shpronësimit por kostot dhe shumat e të përlogaritura, të cilat janë më se të nevojshme në zbatim të ligjit dhe mbyllje të procesit të likuidimit. Çdo shumë shtesë e pa parashikuar që mund të rrjedhë në të ardhmen duhet paguar nga institucioni relevant por jo mbi shumën e vlerësuar e shpronësimit.

Përshkrim i marrëveshjes	Institucioni	Këstet	Afati për pagesë	Shuma	PAGESAT 2019	Obligimi	L/A e vitit 2018
1. Nsh Germia - Sipas marrëveshjes, pagesa vetëm për 20% e punëtoreve nga vlera e shpronësuar	Komuna e Prishtinës	1 2 3	tetor 2019 shkurt 2020 shkurt 2021	587,316 293,658 293,658	587,316 293,658 -	- - 293,658	-
2. Nsh IMN Kosova - Sipas marrëveshjes, pagesa për 20% e punëtoreve nga vlera e shpronësuar, pagesa ndaj kreditorëve dhe tarifa administrative. Pritet vendimi final për shpronësim nga ana e Qeverisë	Komuna e Prishtinës	1 2 3	dhjetor 2018 shtator 2019 dhjetor 2019	2,515,845 1,160,811 1,160,811	2,515,845 1,160,811 1,160,811	- - -	-
3. Nsh Auto Prishtina – Sipas marrëveshjes - 20% i shumës totale të shpronësimit.	Komuna e Prishtinës	1	Pa afat	179,996	179,996	-	-
4. Nsh Silloga - Sipas marrëveshjes, pagesa vetëm për 20% e punëtoreve nga vlera e shpronësuar	Komuna e Prishtinës	1	2019	30,498	-	30,498	-
5. Bujqësia Sipas marrëveshjes, është paguar 20% e shumës për shpronësimin e asetit për ndërtimin e fabrikës të ujit në "Shkabaj".	KUR Prishtina	1	Pa afat	257,171	257,171	-	-
6. Bujqësia Sipas marrëveshjes në total shumat për pagesë është EUR 133.662.10 dhe e cila është 20% e vlerës totale të shpronësimit. Pagesa prej EUR 26,455 është e fundit, meqenëse shumat prej EUR 107,207 është paguar në vitin 2018. Shpronësimi ka të bëjë në lidhje me stadiumin në Komunën e Obiliqit.	Komuna e Obiliqit	1	Pa afat	26,455	26,455	-	-
				6,506,219	6,182,063	324,156	
				GJITHSEJ			

* Rastet e paraqitura pa afat janë vetëm pasqyrim i gjendjes të pagesa të pranuar gjatë vitit 2019

22. LLOGARITË E ARKËTUESHME PËR QIRATË DHE TË HYRAT TË TJERA

1	2	3	4=2-3	5=1+4	TOTALI		
					2019		
VITI	31 dhjetor 2018	Rritjet viti aktual	Zvogëlimet vitet paraprake	Bilanci	31 dhjetor 2019	PADITË	
						2018	2019
							krahasimi %
ZR Prishtina	11,429,237	386,970	(191,450)	195,520	11,624,757	9,829,067	10,617,971
ZR Pejë	113,952	15,774	(9,977)	5,797	119,749	101,842	107,438
ZR Mitrovicë	947,044	57,474	(9,309)	48,165	995,209	889,014	969,736
ZR Gjilan	1,410,412	114,627	(107,979)	6,648	1,417,060	1,399,010	1,407,186
ZR Prizren	64,426	3,006	(14,231)	(11,225)	53,201	58,884	51,879
Gjithsej	13,965,071	577,851	(332,946)	244,905	14,209,976	12,277,817	13,154,210
							6.66%

Shpjegim lidhur me tabelën më lartë:

Kolonat 2 dhe 3 paraqesin rritjet dhe zvogëlimet e llogarive të arkëtueshme përgjatë vitit 2019.

Kolona 2 - Sa i përket rritjeve prej EUR 577,851 kjo shumë përbëhet kryesisht nga rritjet e obligimeve në vitin 2019. Nga kjo shumë e rritjes duhet theksuar se si rrjedhojë e identifikimit të obligimeve të viteve paraprake janë rreth EUR 65 mijë shtesë si korrigjime në libra:

Kolona 3 - Sa i përket kolonës 3, zvogëlimet nënkuptojnë pagesat e pranuar apo rastet që mund të humbin gjatë kontestit gjyqësor. Nga shuma prej EUR 332,946, rreth 300 mijë euro janë inkasime ndërsa raste të humbura në Gjykatë janë EUR rreth 32 mijë euro.

Gjithsesi në faqen tjetër janë përshkruar disa NSh nëpër regjione që kryesisht kanë ndikuar në uljet dhe ngritjet e llogarive të arkëtueshme përgjatë vitit 2019.

Shpalosje e rasteve që përbëjnë afër 80% e llogarive të bartura nga viti 2018

- **8,708,328** - faturimi ndaj Kosova Petrol për asetet e NSh Jugopetrol dhe Ina Trgovina. Faturimi është për periudhën shkurt 2000 - 30 prill 2016 (fatura e parë e lëshuar në vitin 2014) Rasti është në procedurë gjyqësore;
- **702,861** - faturimi "Al Petrol" për shfrytëzimin e pompave të benzinës të INA Trgovina. Ndaj "AL – Petrol" çështja është në procedurë gjyqësore, në shkallën e parë ka fituar AKP;
- **712,069** - faturimi ndaj "Industria e Naftës INA D.D. Zagreb" për shfrytëzimin e pompave të benzinës të NSh INA Trgovina;
- **669,029** - faturimi ndaj NPTSH Sharr Betelingsungs për të cilët është ngritur padi por që ende nuk ka përfunduar procesi gjyqësor;
- **319,600** - faturimi ndaj Komuna e Mitrovices, Organizata BAC, Biblioteka nder komunale, Oda Ekonomike e Kosovës, OJQ 7 Arte. Faturimi është sipas llogaritjes nga 1 mars 2011 deri më 31 dhjetor 2019. Rasti është në procedurë gjyqësore;

Listim i shkurtër i NSH've që kanë pasur impakt të lartë të ndryshimeve në nivel të regjioneve

Ndryshimet	NSh	ZR	Komente
(10,000)	KB Pirana	Prizren	Rasti edhe pse ka qenë në përbarim por pas ankesës të palës Gjykata ka anuluar vendimin dhe si rrjedhojë këto mjete të prezantuara në llogari të arkëtueshme fshihen nga librat
2,121	Farmakos	Prizren	Rritje e llogarive të arkëtueshme si rezultat i borxhit të mbetur në fund të vitit. Në muajin janar 2020 ky borxh është paguar
(3,349)	Unimont	Prizren	Korrigjim i llogarive të arkëtueshme nga viti paraprak.
(11,638.43)	Kualiteti	Gjilan	Shlyerje, refuzimi i kërkesë padisë me aktgjykim të formës se prerë në shumën prej EUR 12,500
(5,579.75)	GJ096	Gjilan	Inkasim i mjeteve nga përbarimi i një pjese të borxhit të viteve paraprake të identifikuar gjatë vitit 2019 përmes njoftimit/dorëzimit të lëndës nga Gjykata
(3,960.00)	Jometalet KAOLINI	Gjilan	Shlyerje, refuzohet kërkesë padia për kompensim të borxhit.
(32,609.98)	Tregtia	Gjilan	Kryesisht inkasimi i mjeteve nga rasti në favor të NSH pas vendimit të Gjykatës. Gjykata ka vendos në favor të AKP'së dhe shuma prej EUR 42,676.96 e borxhit të vjetër është inkasuar në llogarinë e NSH.
61,296.65	Morava e Binqes	Gjilan	Korrigjim i llogarive të arkëtueshme për vitet paraprake pas identifikimit të borxhit nga lëndët sipas njoftimit të Gjykatës. Lënda për ekzekutim është përcjellur tek përbaruesi privat.
(6,583.52)	Agrodukagjini	Peja	Shuma prej 7,000 Euro e paraqitur në vitin 2018 si LLA iu është referuar Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës, ku rasti është dërguar në përbarim, mirëpo pala ka ushtruar ankesën në shkallën tjetër dhe me vendim të gjykatës është anuluar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore. Rrjedhimisht shuma prej EUR 7,000 fshirë nga LLA. Bashkangjitur Aktvendimi i Gjykatës Supreme
(2,511.06)	17 Nentori	Peja	Inkasim i borxhit, pala ka përmbush të gjithë obligimin – Skender Berisha
6,370.00	Koop. Gurakoc	Peja	Rritje e borxhit qiramarrësi Conex, rasti dërguar tek përbaruesi
1,285.27	Tregjet	Peja	Rritje e borxhit mos pagesë e qirasë
4,256.00	Tregjet	Peja	Rritje e borxhit për mos pagesë e qirasë dhe raste të reja të Aktgjykimve në favor të NSH-së
42,407.75	Jugobanka	Mitrovica	Është një rritje nga raportimi i vitit të kaluar, kryesisht të rritja e padisë se Jugobankes kundër Komunës për objektin e Bankosit i cili vijon të përlojaritet në baza mujore deri në vendimin e Gjykatës
(9,309.83)	K.B. Drenica	Mitrovica	Arsyeja e zvogëlimit është te pagesat e kryera te qirave vjetore për toka bujqësore, disa kontrata te qirasë janë pasive pasi nuk janë vazhduar dhe disa raste janë me pagesa si rezultat i përbarimeve
2,505.10	Cycavica	Mitrovica	Është korrigjim nga raportimi i viteve te kaluar dhe në të njëjtën kohë rritje e II/A
1,575.80	Produkti	Mitrovica	Është korrigjim nga raportimi i viteve te kaluar dhe për këto rate janë ngritur padi
9,920.88	Lux	Mitrovica	Janë obligime që janë rritur për (41,900.90) periudhë 2019 marrë parasysh 7 padi të iniciuara dhe një korrigjim për (3,150.00) periudhën 2018.
(10,745)	Jugopetroll	Prishtina	Zvogëlimi i llogarive të arkëtueshme nga viti paraprak është kryesisht si rezultat i realizimi i pagesave
(42,193)	Grand Hotel	Prishtina	Zvogëlimi i llogarive të arkëtueshme nga viti paraprak është kryesisht si rezultat i realizimi i pagesave
(4,720)	Shpezëtaria	Prishtina	Zvogëlimi i llogarive të arkëtueshme nga viti paraprak është kryesisht si rezultat i pagesës në janar 2019
(4,317)	Kosovarja	Prishtina	Korrigjim i II/A të viteve paraprake – Islam Imeri borxhi i raportuar prej EUR 3,204 i raportuar në vitin 2018 ka qenë i gabuar. Sipas raportit të qirasë të inkasuar, Islam Imeri ka bërë pagesë në vitin 2018

Shënimet Shpjeguese- Llogaritë e arkëtueshme

(8,973)	Marketing Export	Prishtina	Zvogëlim i II/A si rezultat i inkasimit të mjeteve prej EUR 10,000 përmes procedurës përbarimore për qiramarrësin Idriz Zejnullahu
(4,645)	Urata	Prishtina	Zvogëlim i II/A si rezultat i inkasimit të mjeteve të muajit dhjetor 2018 paguar në muajin janar 2019
(110,807)	Tregu	Prishtina	Zvogëlim i Llogarive të arkëtueshme si rezultat i inkasimit më të madh të borxheve përmes Përbaruesit privat dhe lëndëve gjyqësore.
120,252	Ina Trgovina	Prishtina	Rritje e II/A gjate vitit 2019 si rezultat i rritjes te obligimeve nga qiramarrësi edhe ne këtë vit "Industria e Naftës INA D.D. Zagreb" me te cilin jemi ne kontest
109,656	ABC Genci	Prishtina	Rritje e II/A gjate vitit 2019 si rezultat i rritjes te obligimeve edhe ne këtë vit nga qiramarrësi "A&A Sh.P.K." dhe "3 friends".
39,421	Rilindja Shtyp.	Prishtina	Rritje e II/A gjate vitit 2019 si rezultat i rritjes te obligimeve edhe ne këtë vit nga qiramarrësi "Media Tribuna".
27,648	Auto Prishtina	Prishtina	Rritje e II/A gjate vitit 2019 si rezultat i rritjes te obligimeve edhe ne këtë vit nga qiramarrësi me te cilin jemi ne kontest
20,264	Gërmia	Prishtina	Rritje e II/A gjate vitit 2019 si rezultat i rritjes te obligimeve edhe ne këtë vit nga qiramarrësi "Blue Market" dhe "Viva Fresh"
9,351	Bujqësia	Prishtina	Rritje e II/A gjate vitit 2019 si rezultat i rritjes te obligimeve edhe ne këtë vit nga qiramarrësi "Data Project elektronik"
6,989	Mekanizimi	Prishtina	Rritje e II/A gjate vitit 2019 si rezultat i rritjes te obligimeve te qirasë për muajin dhjetor 2019 qiramarrësi "ATK"
7,225	Mulliri	Prishtina	Rritje e II/A gjate vitit 2019 si rezultat i rritjes te obligimeve edhe ne këtë vit nga qiramarrësi "Fazli Gashi"
7,738	Centro Tekstil	Prishtina	Rritje e II/A gjate vitit 2019 si rezultat i rritjes te obligimeve këtë vit nga qiramarrësi "Rinor Krasniqi"
7,414	Jedinstvo	Prishtina	Rritje e II/A gjate vitit 2019 si rezultat i rritjes te obligimeve këtë vit nga qiramarrësi "VV.S.H.Sh.p.k."
4,478	KHT Kosova	Prishtina	Rritje e II/A gjate vitit 2019 si rezultat i rritjes te obligimeve këtë vit nga qiramarrësi "Sokol Viti"
8,008	Visoko Komerc	Prishtina	Rritje e II/A gjate vitit 2019 si rezultat i rritjes te obligimeve këtë vit nga qiramarrësi "Sadri Avdiu"

LLOGARITË E PAGUESHME DHE DETYRIMET KONTIGJENTE

23. LLOGARITË E PAGUESHME

PËRSHKRIMI	VITI 2019	VITI 2018	VITI 2017
Ofruesi i Shërbimeve Profesionale	-	-	-
Obligimet ndaj kërkesave kreditore	2,897,005	159,585	304,950
Mallra dhe Shërbime	203,403	163,924	72,043
Gjithsej	3,100,408	323,509	376,993

Obligimet e papaguara janë të paraqitura në tri shtylla:

- Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoriteti i Likuidimit);
- Mallrat dhe Shërbimet; dhe
- Obligimet ndaj Kërkesave të Kreditorëve;

23.1. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE

Faturat	Shuma
Fatura për muajin shtator	45,436
Fatura për muajin tetor	45,436
Fatura për muajin nëntor	45,436
Pagesat 2019	(136,309)
Obligimi	0.00

Obligime ndaj Ofruesit të Shërbimeve Profesionale nuk ka për shkak se janë ekzekutuar të gjitha kërkesat/faturat e dorëzuara për me shërbimet gjatë vitit 2019 dhe fatura e muajit dhjetor përcillet.

Me përfundimin e kontratës me “Deloitte”, është angazhuar kontraktori tjetër “Curtis, Mallet-Prevost, Colt & Mosle LLP ,Grant Thornton Consulting Doo dhe Grant Thornton L.L.C”. Periudha e angazhimit është pesëvjeçare, nga 1 korrik 2019 deri me 30 qershor 2024.

Sa i përket kontraktimit të parë “Deloitte” të gjitha janë përfunduar në vitin 2018.

Lidhur me faturën e muajit dhjetor 2019 - Neni 16.1 i Kushteve të Veçanta të Kontratës parasheh që faturat duhet të lëshohen nga OSHP me rastin e dorëzimit të raportit mujor për muajin paraprak. Pagesat mujore bëhen pas aprovimit të raportit mujor nga Komiteti Drejtues i Likuidimit brenda 30 ditëve kalendarike duke filluar nga dita kur lëshohet fatura dhe protokollohet ne AKP. OSHP ka dorëzuar faturën dhe raportin mujor për dhjetor 2019 me 10 janar 2020.

Lidhur me OSHP, referojuni edhe shënimit shpjegues nr. 10

23.2. OBLIGIMET NDAJ KREDITORËVE TË NSH'VE

Përshkrimi	Shuma
Obligimet më 1 janar 2019	159,585
Shuma e paguar gjatë vitit 2019	(18,585)
Shuma e paguar gjatë vitit 2019 - Letnica	(3,108)
Shuma e aprovuara të shpërndarjes 2019	3,906,238
Pagesat nga shumat e aprovuara të shpërndarjes 2019	(1,147,125)
Obligimi më 31 dhjetor 2019	2,897,005

Lidhur me pagesat e Nsh Letnica

****Shumat e paguara gjatë vitit 2019 për Nsh Letnica është për shkak se raporti i shpërndarjes është ndalur sepse se ish-punëtorët e kësaj Nsh'je gjatë shpërndarjes të 20% të punëtorëve nga BSPK-ja mjetet e pranuar më shumë, disa punëtor nuk ishin kthyer. Pas trajtimit të kësaj çështje edhe njëherë dhe me kërkesë të Bordit të Drejtorëve është bërë shpërndarja e mjeteve në dhjetor 2019.**

Pagesat për raportet e vitit 2019

Raportet e shpërndarjes janë aprovuar në fund të muajit dhjetor 2019 dhe vetëm për Nsh IGK Ballkan është arritur të bëhet shpërndarja, pasi që është sjellur kërkesa nga AL dhe Zyra Regjonale e Prizrenit. Gjendja e obligimeve të këtyre raporteve është si më poshtë:

- IGK Ballkan në shumën prej EUR 1,556,779 (paguar 1,147,417 dhe obligimi i mbetur –mungesa e llogarive bankare prej EUR 409,361);
- Qyqavica në shumën prej EUR 1,697,912;
- Kosovaplast në shumën prej EUR 651,547; dhe

Për Nsh Qyqavica dhe Kosovaplast janë proceduar në fillim të vitit 2020.

Ashtu siç është përmendur edhe në shënimin shpjegues nr. 17, obligimet e papaguar janë pagesat e parealizuara ndaj kreditorëve të Nsh-ve sipas vendimit për shpërndarje të Bordit të Drejtorëve. Kryesisht shumat e papaguara të raporteve të viteve paraprake janë për rastet të cilat ka pasur mungesë të informacioneve të llogarive bankare.

Obligimi real ndaj kreditorëve sipas datës 31 dhjetor 2019 është EUR 2,896,698, meqenëse nga shumat e aprovuara minusohen tarifat bankare dhe për vitin 2019 janë rreth EUR 307..

Ndërsa në vitet paraprake tarifë bankare e minusuar janë rreth EUR 3,741 si dhe raste të tjera prej EUR 3,311 që kërkojnë korrigjim (një pagesë e dyfishtë prej EUR -976.50 dhe EUR 4,287.78 që duhet korrigjuar nga raporti i shpërndarjes). Këto shuma janë të minusuar nga e cila rrjedh dhe gjendja fillestare prej EUR 159,585.

23.3. MALLRA DHE SHËRBIME**RRJEDHA E NDRYSHIMEVE NGA VITI 2018**

Përshkrimi	Shuma	Renditja
Obligimet më 1 janar 2019	163,924	1
Pagesat e realizuara gjatë vitit 2019	(161,088)	2
Obligimet e bartura nga vitet paraprake	2,836	3=1-2
Obligimet për vitin 2019	200,567	4

Obligimi më 31 dhjetor 2019 203,403 5=3+4**PËRSHKRIMI I DETYRIMEVE TË VITIT 2019**

Përshkrimi	Shuma
Kontributet pensional të OSh & punët e NSh – dhjetor 2019	20,450
Tatime; TVSh, tatim në fitim dhe të ardhura personale	145,080
Shërbime komunale (rrymë, ujë dhe mbeturina) për NSh'të	19,080
Qiraja për hapësirën e përbashkët – NSh Tregu	3,450
Shpenzime për ngrohje qendrore të NSh Grandi	9,508
Ofrues shërbimesh për muajin dhjetor 2019	450
Shërbime përbarimore dhe ekspertiza	607
Shpenzime të telefonisë fikse dhe internet për NSh'të	196
Shpenzime të distribuimit të filmave – ABC Genci	1,746
Obligimi më 31 dhjetor 2019	200,567

Kryesisht paraqiten shpenzimet për ofruesit e shërbimeve të cilët angazhohen për NSh-të përkatëse, shërbimet për ruajtjen e aseteve, shpalljet në gazeta për shitjen e aseteve përmes likuidimit, shpalljet lidhur me njoftimet për kërkesat e kreditorëve, qiraja, shërbimet publike dhe të tjera.

Obligimet e bartura nga vitet paraprake

Janë dy fatura në shumën totale prej EUR 2,836 për shërbimet e avokaturës në Republikën e Bosnjës dhe Hercegovinës lidhur me përfaqësimin në procesin gjyqësor për pronën e NSh "Industria e Mishit". Pagesat janë ndalur dhe nuk janë ekzekutuar sepse gjatë vitit 2018 për arsye se shërbimet e kontraktuara me avokatin në fjalë kishin përfunduar.

Ndërsa obligimet e papaguara të vitit 2019 që kanë mbetur pa u ekzekutuar sipas datës të transaksioneve më 31 dhjetor 2019 dhe do të bëhen gjatë vitit fiskal 2020. Gjendja e pagesave të obligimeve të vitit 2019 është EUR 128 mijë sipas datës të transaksioneve deri më 23 janar 2020.

24. DETYRIMET KONTIGJENTE**RAPORTI PËRMBLEDHËS I DETYRIMEVE KONTIGJENTE**

PËRSHKRIMI	VITI 2019	VITI 2018	VITI 2017
Gjendja fillestare me 1 janar	7,693,927	5,432,014	471,437
Konteste të reja	975,761	7,267,306	4,972,234
Kosto shtesë për kontes. paraprahe	1,020	-	-
Të bartura nga llog. e pagueshme	-	323	-
Raste të fituara nga AKP	-	(4,945,129)	-
Raste të humbura	(8,300)	(60,587)	(11,657)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	8,662,408	7,693,927	5,432,014
Mundësia			
Ullët	8,229,396	7,253,635	5,432,014
Mesëm	-	-	-
Lartë	433,012	440,292	-

NDRYSHIMET KUNDREJT VITIT 2018**1. Kontesteve të reja të ndodhura gjatë vitit 2019 janë si më poshtë:**

- EUR 975,526 – Sipas padisë SCC-11-0158. paditës është Konzorciumi për Rindërtimin e Kosovës, me kërkesën që të obligohet Agjencia që paditësit në emër të investimeve në objektin "Motel Besiana" t'i paguaj shumën prej 789,619 euro dhe në emër të fitimit të humbur për periudhën kohore janar 2011- dhjetor 2012 shumën prej 184,000 euro, apo totalin prej 973,619.

- EUR 235 - Aktgjykim C-IV-15-5448, për shpenzime të procedurës dhe kompensimin e taksave gjyqësore dhe përfaqësimit prej EUR 235.20 ka aprovuar padinë e paditësit dhe e ka obliguar Agjencinë që të lidhë kontratën e shitjes për njësinë nr. 26 Marketing Export - Shitorja në Ferizaj. Kjo lëndë është duke u shqyrtuar në Kolegjin e Apelit sipas ankesës së Agjencisë.

2. Rastet e humbura

Sipas aktgjykimit C-III-17-0076 – AKP është obliguar që të paguar shumën prej EUR 8,300 si pasojë e shkëputjes të një anshme të kontratës për shërbimet e auditimit. Shërbimet kanë qenë të kontraktuara nga ish-AKPM dhe kjo ka qenë si detyrim kontingjent nga vitet e kaluara dhe në vitin 2018 është paraqitur me rrezikshmëri të lartë. Është paguar në vitin 2019 nga AKP.

Përveç rasteve të reja dhe ato të humbura është paraqitur kosto shtesë prej EUR 1,020 për rastin Aktgjykimi nr. SCC-10-00214, me pretendimin se AKP-ja detyrohet për pagesën e 35,400 NSh Magjistralia Peje. Këto janë shpenzime shtesë të procedurës. Gjithashtu ky rast është cilësuar me rrezikshmëri të lartë.

LISTA DETAJE E TË GJITHA RASTEVE TË DETYRIMEVE KONTIGJENTE

NATYRA	ARSYEJA PËR DETYRIME	PERIUDHA	MUNDËSIA	Vlera
Kontratë	Sipas Urdhrit Përmbaues P. nr. 397/2015, kompensim në shumë prej 2.640.00 Euro	Bartur nga v. 2017	e lartë	2,640
Kontratë	Sipas Aktgjykimit SCC-09-0135, shpenzime procedurale, në shumë prej 1,500 Euro	Bartur nga v. 2017	e lartë	1,500
Kontratë	Sipas Aktgjykimit SCC-08-0095 - Padia për humbjen e fitimit, kompensimit në shumë prej 14,478,50 si dhe avokatin në shumë prej 365,04 Euro.	Bartur nga v. 2017	e lartë	14,844
Kompensim	Aktgjykimi SCC-10-00214, AKP-ja detyrohet për pagesën e 35,400. NSh Magjistralia Peje	Bartur nga v. 2017	e lartë	36,420
Kompensim	Aktgjykimi SCC-06-0348, NSh Ratko Mitrovicë	Bartur nga v. 2017	e lartë	122,994
Kompensim	Aktgjykimi SCC-10-0091, AKP-ja detyrohet për pagesën e 113.794	Bartur nga v. 2017	e lartë	113,794
Kompensim	Aktgjykimi Cnr.190/2007 NSh Auto Prishtina	Bartur nga v. 2017	e lartë	35,725
Kompensim	Aktgjykimi Cnr.185/2009. për NSh Ujmiri në likuidim	Bartur nga v. 2017	e lartë	70,000
Kompensim	aktgjykim AC-II-12-0006 për NSh Agrokultura	Bartur nga v. 2017	e lartë	2,296
Kompensim	Sipas aktgjykimit AC-I-17-0257, agjencia është e obliguar t'i paguaj shpenzimet procedurale	Bartur nga v. 2017	e lartë	203.00
Kompensim	Sipas Aktgjykimit C-II-14-0118, kompensimi i të ardhurave personale	Bartur nga v. 2017	e lartë	26,247
Kompensim	Sipas aktgjykimit C-II-17-0069, AKP-ja është e obliguar t'i paguaj shpenzimet e përfaqësuesit të ankuesit.	Bartur nga v. 2017	e lartë	655
Kompensim	Paditësi përmes padis se tij C-III-15-1026, pretendon që AKP-ja, ne emër te kompensimit për shfrytëzimin e lokalit afarist.	2018	E ultë	174,891
Kompensim	Paditësi përmes padis se tij C-I-17-0033, pretendon që AKP-ja, ne emër te	2018	E ultë	2,985,945

NATYRA	ARSYEJA PËR DETYRIME	PERIUDHA	MUNDËSIA	Vlera
	kompensimit për pronën.			
Kompensim	Paditësi përmes padis se tij C-II-13-0325, pretendon që AKP-ja, ne emër te kompensimit për pronën.	2018	E ultë	84,000
Kompensim	Paditësi përmes padis se tij C-III-17-0211, pretendon që AKP-ja, ne emër te borxhit për mospagesën e shërbimeve.	2018	E ultë	41,828
Kompensim	Paditësi përmes padis se tij C-I-16-0005, pretendon që AKP-ja, ne emër dëmit material dhe jo-materiale.	2018	E ultë	280,000
Kompensim	Paditësi përmes padis se tij C-I-16-0016, pretendon që AKP-ja, ne emër te kompensimit te pagave të papaguara.	2018	E ultë	33,000
Kompensim	Paditësi përmes padis se tij C-II-16-0662, pretendon që AKP-ja, ne emër te kompensimit te paguaj të pa paguara.	2018	E ultë	2,100
Kompensim	Paditësi përmes padis se tij SCC-11-0158, pretendon që AKP-ja, ne emër te kompensimit të pronës.	2018	E ultë	975,526
Kompensim	Paditësi përmes padis se tij C-III-16-0125, pretendon që AKP-ja, ne emër te kompensimit të dëmit material dhe jo-material.	2018	E ultë	150,000
Kompensim	Paditësi përmes padis se tij C-IV-12-0020, pretendon që AKP-ja të bëjë, kthimin e depozitës.	2018	E ultë	7,100
Kompensim	Paditësi përmes padis se tij C-I-12-0055, pretendon që AKP-ja, ne emër te mospërbushjes se kontratës.	2018	E ultë	138,126
Kompensim	Paditësi përmes padis se tij C-II-17-0623, pretendon që AKP-ja, ne emër te kompensimit te pagave te pa paguara.	2018	E ultë	6,300
Kompensim	Aktgjykimi SCC-05-0010, AKP-ja detyrohet për pagesën e 1,200.00	2018	E lartë	1,200
Kompensim	Aktgjykimi C-IV-14-3940, AKP-ja, detyrohet që paditësit t'ia kthej depozitën.	2018	E lartë	2,000
Kompensim	Aktgjykimi C-II-14-0118, AKP-ja detyrohet për pagesë e pagave te pa paguara.	2018	E ultë	26,247
Kompensim	Aktgjykimi C-IV-14-3627, AKP-ja detyrohet për t'i kthyer paditësit depozitën dhe shpenzimet e procedurës.	2018	E lartë	2,494
Kompensim	Paditësi përmes padis se tij C-III-17-0013, pretendon që AKP-ja, ne emër te mospërbushjes se kontratës.	2018	E ultë	2,331,089
Fatura	Fatura të gazetës të papaguara që më parë janë ndalur për shkak të tejkalimit të vlerës të kontratës, por që blerësi i ri i kompanisë nuk ka shprehur interesin	2018	E ultë	323

NATYRA	ARSYEJA PËR DETYRIME	PERIUDHA	MUNDËSIA	Vlera
	që të pranojë këto pagesa. Këto obligime në pasqyrat financiare 2017 kanë qenë të prezantuara si obligime por që kalojnë në detyrime kontingjente.			
Fatura	Faturë e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 2011-2012. Këto obligime në pasqyrat financiare 2017 kanë qenë të prezantuara si obligime por që kalojnë në detyrime kontingjente.	2018	E ultë	17,160
Kompensim	Aktgjykim C-IV-15-5448, për shpenzime të procedurës	2019	E ultë	235
Kompensim	Paditësi përmes padis se tij SCC-11-0158, pretendon që AKP-ja, ne emër te kompensimit dhe të hyrave tjera	2019	E ultë	975,526

PAGESAT E REALIZUARA NGA TARIFA ADMINISTRATIVE

Sipas vendimit të Bordit të Drejtorëve të vitit 2012, në rast se nuk ka fonde të mjaftueshme në llogarinë bankare të likuidimit dhe NSh-ve tjera, atëherë pagesat realizohen përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin që do të ketë fonde të mjaftueshme në llogarinë e likuidimit, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompensohet nga llogaria e ndërmarrjes në likuidim. Gjithashtu, pagesat nga llogaria e tarifës administrative dhe kompensimi i kësaj llogarie nga NSh-të në likuidim është në pajtueshmëri dhe me nenin 20 të Ligjit nr. 06/L -023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080.

Gjendja bankare e llogarisë së tarifës administrative më 1 janar 2019		SHUMA
Shuma e transferuar shtesë për buxhetin e vitit 2019 <i>[shënimin shpjegues nr. 15]</i>	-	(1,036,241)
Gjithsej mjetet e paguara ndaj OShP'së sipas kontratës me OShP <i>[shënimin shpjegues nr. 10]</i>	-	(136,309)
Shpenzime për dërgesa postare - <i>[shënimin shpjegues nr. 11]</i>	-	(5,596)
Bilanci i pagesave për Ofruesit e Shërbimeve <i>[shënimin shpjegues nr. 11.1]</i>	-	(124,697)
Provizione për ruajtjen e artikujve në Bankën Qendrore të Kosovës <i>[shënimin shpjegues nr. 11]</i>	-	(600)
Shpalle në gazeta vendore dhe ndërkombëtare <i>[shënimin shpjegues nr. 11]</i>	-	(24,030)
Rryma, taksa gjyqë/ tjera <i>[shënimin shpjegues nr. 11]</i>	-	(4,560)
Tatimet/Trustet Pensionale për OSh-të nga tarifa për NSh-të <i>[shënimin shpjegues nr. 11]</i>	-	(15,932)
Shpenzime bankare <i>[shënimin shpjegues nr. 16]</i>	-	(573)
Shpenzimet nga paraja e imët nga Zyret Regjionale <i>[shënimin shpjegues nr. 11]</i>	-	(25,900)
Shpenzimet nga avansi për udhëtim zyrtar jashtë venditë <i>[shënimin shpjegues nr. 11]</i>	-	(9,876)
Shërbime profesionale-Angazhimi i përbaruesve/përfaqësime ligjore dhe ekspertizë ligjore	-	(215)
Pagesa ndaj vlerësuesve të pronave lidhur me procesin e negocimit direkt	-	(1,172)
Rimbursimi i mjeteve nga llogaritë e NSh-ve që janë paguar nga tarifa administrative	+	1,021
Të hyrat për Agjencinë Kosovare të Privatizimit – <i>[shënimin shpjegues nr. 15.1]</i>	+	1,754,058
Rimbursimi i mjeteve nga llogaritë e NSh-ve për koston fikse të OShP-së	+	155,250
Gjendja bankare e llogarisë së tarifës administrative më 31 Dhjetor 2019		667,075

TRANSFERET BRENDË LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM NË BQK DHE GJENDJA NË BANKAT KOMERCIALE

TRANSFERET BRENDË LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

Janë transaksione bankare ndërmjet llogarive bankare të fondeve në mirëbesim në BQK. Shkurtimisht janë paraqitur si më poshtë:

1. Bartjen e BID depozitave nga llogaritë e BID depozitave të privatizimit dhe likuidimit për në llogaritë përkatëse të NSh-ve në likuidim. *Këto raste trajtohen dhe janë të paraqitur në shënimin nr. 6.* Gjithsej shuma e transferuar prej EUR **2,998,407**;
2. Kompensimi i llogarisë të tarifës administrative nga llogaritë e NSh-ve përkatëse në vlerën prej EUR **155,250**; Këto mjete janë kompensuar nga pagesat e realizuar ndër-vite të kostos fikse dhe variabile me OShP-në;
3. Kompensimi i llogarisë të tarifës administrative nga llogaritë e NSh-ve përkatëse në vlerën prej EUR **1,021**; Këto mjete janë kompensuar nga pagesat e realizuar për shpenzimet e NSh-ve të cilat nuk kanë pasur mjeteve për ekzekutim të pagesave;
4. Të hyrat e realizuara transferuara për tarifën administrative prej EUR **1,754,058** nga **5%** i tarifës administrative, konfiskimi i BID depozitave si dhe tarifa për pjesëmarrje në tenderë. *Këto raste trajtohen dhe janë të paraqitur në shënimin nr. 15;*

5. Transferimin e shumave të pa shpërndara si pjesë e 20% për në llogarinë në mirëbesim për punëtorët e NSh-ve. **Gjatë periudhës raportuese**, gjithsej shuma e transferuar për punëtorët në llogari që mbahet në mirëbesim nga AKP është EUR **1,404,105**. Këto mjete do të shpërndahen pas shqyrtimit të ankesave nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme.

LLOGARITË BANKARE TË TJERA NË BANKAT KOMERCIALE

Është vetëm një llogari bankare në të cilën ka mjete bankare që AKP-ja mbanë në Procredit Bank:

1. Gradacioni bankar për MIM Golesh në shumën prej EUR 64,466.50 për licencën sipas rregullores të Komisionit për Miniera dhe Minerale të Kosovës.

GJENDJA E FONDEVE TË LIKUIDIMIT TË NSh-ve

Gjendja e të hyrave dhe pagesave në llogaritë bankare të NSh've në likuidim si më poshtë:

Gjithsej të hyrat prej EUR	662,110,449
Gjithsej Shpenzimet/shpërndarja prej EUR	423,403,924
Gjendja e llogarive bankare	238,706,525

RAPORTI I TË HYRAVE NË LLOGARITË BANKARE TË NSh've NË LIKUIDIM

NR.	LLOJI I TË ARDHURAVE	PËRSHKRIMI I TË HYRAVE	VLERA
1	Shitje e aseteve	i1 - Shitje gjatë likuidimit	156,781,077
2	Shitje e aseteve	i3 - Depozita të transferuara nga llogaria e depozitës së tenderëve	14,071,462
3	Shitje e aseteve	i1a - Shitjet e banesave	268,096
4	Shitje e aseteve	Të ardhurat e Likuidimit nga SHPRONESIMI I ASETEVE	1,637,933
5	Qiraja	i12 - Të ardhura nga qiraja	24,086,128
6	Interesi	i2 - Interesi i fituar	8,388,625
7	Të ardhura tjera	i4 - TVSH hyrëse	532,714
8	Të ardhura tjera	i8 - Transferimi i depozitave të parave të gatshme	23,029
9	Të ardhura tjera	i13 - Të ardhura tjera	773,065
10	Të ardhura tjera	i9 - Transferim nga llogaritë bankare të NSh-ve	863,110
11	Të ardhura tjera	i10 - Pranimet nga debitorët e NSh-ve	121,528
12	Nga shitja të Nder. Reja	i6 - Transferimi i 75% nga shitjet me privatizim	443,675,114
13	Nga shitja të Nder. Reja	i7 - Transferimi i parave të NSh-ve në mirëbesim	10,888,568
GJITHSEJ TË HYRAT NË LLOGARITË BANKARE TË NSh-vë NË LIKUIDIM			622,110,449

RAPORTI I TË PAGESAVE/SHPËRNDARJESË NGA LLOGARTË BANKARE TË NSH’ve në LIKUIDIM

NR	SIPAS LIGJIT NR. 04/L-034	PËRSHKRIMI I SHPENZIMEVE (plani kontabël detajet e shpenzimeve të kategorizuar sipas renditjes të mëposhtme janë në faqen tjetër)	VLERA
1	Rreg. për punëtorët	Mjetet që u takojnë punëtorëve (20%) nga shitjet me likuidim	27,856,340
2	neni 21 i AKP-së i Ligjit nr. 04/L-034	Tarifa administrative e Agjencisë (5% e shitjeve të likuidimit dhe interesit në llogaritë bankare)	8,448,820
3	40.1.1	Kostot e Shitjes ose Përndryshe Realizimi i pronës ose asetëve si dhe shpenzimet e likuidimit	1,207,673
4	40.1.3.1	Shpenzimet Gjyqësore	113,772
4	Ekzekutim nga përmbaruesi privat në kundërshtim me nenin 10 të shtojcës të Ligjit		631,690
5	40.1.3.2	Shpenzimet e Administratorit, Autoritetit të Likuidimit dhe Këshilltarëve tjerë	15,655,359
6	40.1.3.3	Shpenzimet për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pronës dhe asetëve	2,984,151
7	40.1.3.4	Shpenzimet për vazhdimin e operacioneve të Ndërmarrjes	8,387,943
8	40.1.3.4	Shpenzimet të likuidimit: Pagesa e tatimeve (Tatimi i të Ardhurave Personale, Tatimi i Pronës, TVSH etj.)	4,276,342
9	40.1.4	Kreditorët e siguruar për ato raste që janë realizuar nga sigurimi i atyre asetëve	48,652
10	40.1.6.1	Kreditorët e pagave për 3 muaj pagat bruto dhe pensioni	2,535,481
11	40.1.6.2	Kreditorët: pagesat për pushim nga puna të papaguara në fillim të Likuidimit	3,718,334
12	40.1.7	Kreditorët e pasiguruar	20,803,968
13	40.1.8	Kreditorët - Pronarët, aksionarët, themeluesit, pjesëmarrësit ose partnerët në NSH	516,395
14	Shih shënimin nr. 18	Fondet Tepricë, Fondet e Mbetura dhe Fondet e përkohshme transferuar Buxhetit të Kosovës	326,719,004
GJITHSEJ PAGESAT NGA LLOGARITË BANKARE TË NSH-ve NË LIKUIDIM			423,403,924

RENDITJA	PËRSHKRIMI	VLERA
1	e2 - Transferim tek punëtorët (BSPK)	21,192,079
	e3 - Transferim tek llogaritë në mirëbesim për punëtorët	6,664,261
2	e4 - Tarifa administrative e agjencisë (5% e shitjeve me likuidim)	8,076,837
	e4a - Tarifa Administrative e Agjencisë (5% e interesit në llogarinë bankare të likuidimit)	371,982
3	e1 - Shpenzimet bankare	27,418
	e6 - Shpenzime për reklamim	722,528
	e7 - Kostoja e shitjes për likuidim të aseteve	60,539
	e8 - Gjëra për zyrë, shpenzime të vogla zyre dhe posta	275,359
	e9 - Magazininim, transportim i dokumenteve të NSh-ve	8,967
4	e11 - Shpenzimet e imta të MBYLLURA - Shpenzime aktuale për kosto të vogla likuidimi	112,862
	e14 - Shpenzime për gjykatë	113,772
5	e14a - ekzekutimi i pagesave nga përmbaruesi	631,690
	e16 - Ofrues Profesional të Shërbimeve (Autoriteti i Likuidimit)	15,655,359
6	e21 - Shërbime për mirëmbajtje të aseteve	43,458
	e22 - Shërbime për mbrojtje të pronës dhe aseteve	2,940,694
7	e17 - Ofrues të shërbimeve (pagesa bruto)	1,504,397
	e18 - Ofrues të shërbimeve (pagesa neto)	3,626,813
	e25 - Qiraja e paguar (bruto)	194,669
	e26 - Qiraja e paguar (neto pas tatimit mbi qiranë)	35,736
	e20 - Shërbime profesionale	226,556
	e27 - Mallra	156,634
	e29 - Shërbime	628,485
	e30 - Ujë	160,120
	e31 - Rrymë	1,320,446
	e32 - Mbeturina	456,860
8	e33 - Telekomunikacion (Internet, telefon)	37,856
	e24 - Udhëtime zyrtare	39,372
	e19 - Tatimi në të ardhura personale për Ofrues të Shërbimeve	643,462
	e34 - Tatimi që mbahet mbi qiranë e paguar	2,995
	e35 - Tatimi i paguar për qiranë e pranuar	88,249
9	e36 - Tatimi komunal në pronë	696,688

9	e38 - Tatimi i korporatës	360,852
	e39 - TVSH paguar ATK-së	2,484,096
	e41 - Kreditore të siguruar	48,652
10	e43 - Pagat (neto) kreditore preferencialë 3 paga	2,224,060
	e44 - Tatimi në ardhurat personale (kreditore preferencialë 3 paga)	63,914
	e45 - Kontribute për pension (për kreditore preferencialë 3 paga)	247,507
	e46 - Pagesa për ndërprerje të punësimit (neto) kreditore preferencialë	3,248,133
11	e47 - Tatimi në të ardhura personale (pagesa për ndërprerje të punës kreditore preferencialë)	122,688
	e48 - Kontributi për pension (për pagesë të ndërprerjes së punës për kreditore preferencialë)	347,513
	e49 - Pagat (neto) kreditore të pasiguruar	6,997,645
	e50 - Tatimi në të ardhura personale (pagat e kreditoreve të pasiguruar)	818,268
	e51 - Kontribute për pension kreditore të pasiguruar	1,965,665
12	e52 - Kreditore të pasiguruar - Huazimet	135,755
	e53 - Avanset e pranuar në para të gatshme nga NSh-të - kreditore të pasiguruar	200,586
	e54 - Furnizues vendor kreditore të pasiguruar	2,616,735
	e55 - Furnizues ndërkombëtarë kreditore të pasiguruar	28,680
	e56 - Tatimi në pronë - kreditore të pasiguruar	1,335,243
	e57 - Tatimi mbi qiranë kreditore të pasiguruar	65,715
	e58 - Tatimi i korporatës kreditore të pasiguruar	504,614
	e59 - TVSH kreditore të pasiguruar	3,934,267
	e60 - Tatimi i paragjykuar kreditore të pasiguruar	230,627
	e61 - Rryma kreditore të pasiguruar	677,852
13	e62 - Ujë kreditore të pasiguruar	263,194
	e63 - Mbeturina kreditore të pasiguruar	180,007
	e64 - Telekomunikim dhe Internet kreditore të pasiguruar	51,117
	e65 - Kreditore tjerë të pasiguruar	797,997
	e66 - Kërkesa të pronarëve, aksionarëve, themeluesve, pjesëmarrësve, partnerëve në NSh	516,395
14	e0 - Fondet Tepricë për Qeverinë e Kosovës - neni 19.3.3 i Ligjit të AKP-së	90,244,911
	Fondet e përkohsme transferuar Buxhetit të Kosovës	44,760,336
	e67 - Fondet e mbetura për Qeverinë e Kosovës	191,713,757

LLOJET E LLOGARIVE BANKARE

1. **LLOGARITË E PRIVATIZIMIT** - Përdoren për të mbajtur të ardhurat e privatizimit/shitjes sipas nenit 8 deri në nënshkrimin e kontratave të shitjes. Pas nënshkrimit të kontratave të shitjes, bëhen këto veprime: pagesat për 20%-in e punëtorëve; transferimi i tarifës administrative (5% e shitjes) në llogarinë e dedikuar të Agjencisë për të ardhurat nga tarifa administrative. Prej kësaj llogarie transferohen tarifat në llogarinë bankare sipas nenit 64 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; dhe 75% e çmimit të shitjes transferohen në llogarinë e likuidimit.

2. **LLOGARITË E NSh-ve NË TRANZICION** - Mban paratë e NSh-ve në mirëbesim në rastet kur Agjencia vendos që NSh-ja nuk ka resurse për të mbajtur këto para ose kur rrethanat nuk e lejojnë për të vepruar ndryshe për shkak të specifikave të NSh-ve (rasti i statuteve të pa përcaktuara të NSh-ve e të ngjashme).

3. **LLOGARITË E LIKUIDIMIT** - Përdoren për NSh-të pasi që kanë hyrë në likuidim. Të gjitha llogaritë bankare e NSh-ve mbyllen dhe gjendja e tyre bankare transferohet në këto llogari.

4. **LLOGARIT E KOMERCIALIZIMIT** - Mban shumat e qirave të mbledhura gjatë procesit të komercializimit të NSh-ve, pra të kontratave të nënshkruara para privatizimit të NSh-ve dhe ato kontrata të koncesionit ose dhënies me qira që nënshkruhen pas themelimit të Agjencia Kosovare të Privatizimit. Pas përfundimit të kontratës së komercializimit bëhen këto

veprime: transferimi i tarifës administrative (5% e qirave të paguara gjatë komercializimit) në llogarinë e dedikuar të Agjencisë për të ardhurat nga tarifa administrative. Prej kësaj llogarie transferohen tarifat në llogarinë bankare sipas nenit 64 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; dhe 95% e të ardhurave nga komercializimi transferohen në llogarinë e likuidimit, nëse nuk parashihet ndryshe.

5. **LLOGARITË E PARAVE NË MIRËBESIM PËR PUNËTORËT** - Mban paratë në mirëbesim në emër të punëtorëve që janë transferuar nga llogaritë e privatizimit dhe likuidimit. Këto para janë pjesa e mbetur e 20%-it që iu takon punëtorëve në rastet kur më parë është bërë shpërndarja e parakohshme e 20% e të ardhurave nga shitjet sipas nenit 8 dhe 20% e të ardhurave nga shitja sipas nenit 9 të ligjit të Agjencisë.

6. **DEPOZITAT NGA TENDERËT E PRIVATIZIMIT** - Përdoren për mbajtjen e depozitave të paguara nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjet sipas nenit 8 të ligjit mbi AKP-në. Kjo është një llogari e përkohshme prej ku Agjencia ia kthen depozitin e ofertës ofertuesit jo fitues (të pasuksesshëm). Depoziti i ofertuesit të suksesshëm transferohet në llogarinë e mirëbesimit të hapur në veçanti për Ndërmarrjen e Re që shitet.

7. **TARIFAT PËR TENDERËT E PRIVATIZIMIT** - Përdoret për mbajtjen e tarifës së pakthyeshme për dorëzimin e ofertës nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjet sipas nenit 8 të ligjit. Këto para llogariten si të ardhura të dedikuara të Agjencisë.

8. **DEPOZITAT NGA TENDERËT E LIKUIDIMIT** - Përdoret për shitjet sipas nenit 9 për mbajtjen e depozitave të paguar nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjen e pasurive të NSH-ve që janë në likuidim. Kjo është një llogari bankare e përkohshme prej ku Agjencia ia kthen depozitën ofertuesit të pasuksesshëm. Depozita e ofertuesit të suksesshëm transferohet në llogarinë e mirëbesimit të hapur në veçanti për NSH në likuidim.

9. **TARIFAT PËR TENDERËT E LIKUIDIMIT** - Përdoret për mbajtjen e tarifës së pakthyeshme për dorëzimin e ofertës nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjet sipas nenit 9 të ligjit. Këto para llogariten si të ardhura të dedikuara të Agjencisë.

10. **DEPOZITAT E KOMISIONIT TË RISHIKIMIT TË LIKUIDIMIT** - Ka mbajtur depozitat e paguara nga parashtruesit për ankesat në procesin e likuidimit të dorëzuara në ish-Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave. Pas kthimit të depozitave siç parashihet në nenin 24.4 të ligjit të Agjencisë, kjo llogari do të mbyllet.

11. **LLOGARIA E KAPITALIT THEMELTAR** - Mban pagesën në kapital nga Buxheti i Kosovës mbi themelimin e Agjencisë

12. **LLOGARIA E FONDIT REZERVË TË AKP-SË** - Para se të hyjë në fuqi ligji i ri për 5% e tarifës administrative është mbajtur për të përdorur të ardhurat vetanake të AKP-së për depozitat e konfiskuara nga shitjet e privatizimit, likuidimit, transferimin e

tarifave për shitjet përmes privatizimit dhe likuidimit, interesin e fituar në llogaritë e depozitave dhe tarifave për pjesëmarrjen në tenderët e shitjes përmes privatizimit apo likuidimit.

13. **LLOGARIA E DONATORIT** - Mban paratë e donatorëve në rastet kur donatorët kërkojnë që paratë e tyre të kanalizohen përmes llogarive bankare të Agjencisë.

14. **LLOGARIA E TARIFËS ADMINISTRATIVE** - Në këtë llogari transferohet tarifa administrative e Agjencisë. Në periudha të ndryshme, Agjencia transferon gjendjen në këtë llogari bankare në llogarinë e specifikuar nga Ministria e Financave për të mbajtur të ardhurat e dedikuara nga tarifat administrative të Agjencisë.

15. **LLOGARIA E DEPOZITAVE KOHOR** - Janë llogaritë bankare të depozitave kohor në të cilat transferohet mjetet për afatizim për periudha të ndryshme (deri në një vjet). Nëse ka norma të interesit pozitive që oferton BQK-ja, atëherë sipas marrëveshjes AKP afatizon këto mjete në Bankën Qendrore të Kosovës.

16. **LLOGARIA E SHPRONËSIMEVE** – llogari për qëllim të administrimit dhe operimit me pagesa e shpronësimeve nga institucionet relevante. Të gjitha institucionet kanë mundësi që pagesën ta përfundojnë menjëherë pa ndjekur procedurat e Thesarit për regjistrimin si furnitorë të NSH-ve. Mjetet që pranohen në këtë llogari, nga AKP-ja transferohen në llogaritë përkatëse të NSH-ve, prej nga është shpronësuar aset.

PLANI I VEPRIMIT PËR ADRESIMIN E REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

PËR RAPORTIN E AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË VITIT 2019 PËR FONDET NË MIRËBESIM

Raporti është për periudhën deri më 30 shtator 2019 sipas rregullores së punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit që entitetet e audituara të raportojnë dy herë në vit përmes raporteve periodike mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dala nga raportet e auditimit të ZKA-së. Raportimi i radhës bëhet me 15 mars të vitit pasues.

Nr.	Komponent ë e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin të rekomandimit	Statusi i rekomandimit (i zbatuar, pjesërisht i zbatuar ose i pa zbatuar)	Sfidat e hasura në zbatimin e rekomandimit
B1.	Të hyrat nga qiratë	Realizimi i të hyrave nga qiratë me kontratë të skaduar: Në një rast kemi vërejtur që objekti i dhënë me qira nga AKP është shfrytëzuar nga qiramarrësi edhe pas skadimit të kontratës dhe AKP nuk e kishte bërë vazhdimin apo ripërtëritjen e saj. Kontrata kishte skaduar në vitin 2014, ndërsa qiraja arkëtohet duke u bazuar në kontratën fillestare.	Kryesuesi i Bordit: Duhet të siguroj ripërtëritjen e kontratave me qëllim që shfrytëzimi i aseteve të NSH-ve të bëhet komfor kontratave valide dhe në bazë të rregullores së brendshme për qiratë.	Nënshkrimi i kontratës me zyrtarët përgjegjës, në të kundërt largimi i shfrytëzuesit aktual nga prona shoqërore	I pazbatuar	Me datë 08.07.2019, Kryesuesi i AL-së NSH Rilindja-Shtypshkronja, i ka dërguar një kërkesë përfaqësuesve të RTV 21, për nënshkrimin e kontratës së qirasë (Akoma nuk është nënshkruar kontrata). Megjithatë, AKP-ja deri në fund të vitit kur është edhe afati për adresimin e këtij rekomandimi, do t'i ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm, në mënyrë që ky rekomandim të zbatohet.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
www.pak-ks.org